

Mile Varoshlieski, *inxh. dipl. gjeod.*

**GJEODEZIA DHE
BAZAMENTET GJEODEZIKE**

libër për vitin II të profesionit ndërtimtari-gjeodezi
profili teknik i gjeodezisë

Shkup, 2012

Botues: MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Rr. Mito Haxhivasilev Jasmin, pn. Shkup

Recensentë: Dr. Lazo Dimov, inxh. dipl. gjeod.
Mr. Vanço Stojanovski, inxh. dipl. gjeod.
Viktor Sokolovski, inxh. dipl. gjeod.

Përpunimi i fotografive: Mile Varoshlieski, inxh. dipl. gjeod.
Vasil Mishkovski, inxh. gjeod.
Aleksandar Postolovski, inxh. gjeod.

Kopertinën: Mile Varoshlieski, inxh. dipl. gjeod.

Përkthyes: Arjeta Çajlani

Redaksia profesionale: Prof. dr. Rahim Imeri
Prof. dr. Hamit Mehmeti

Lektore: Arjeta Çajlani

Shtypi: Graficki centar Shpk, Shkup

Me vendim të Ministrit të arsimit dhe shkencës së Republikës së Maqedonisë, nr. 22-4310/1, të datës 28.07.2010 lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP - Каталогизација во пУбликација
Национална dhe Универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

528 (075.3)

ВАРОШЛИЕСКИ, Миле

Геодезија dhe геодетски подлоги: Учебник за II година за градежно-геодетска струка: профил геодетски техничар / Миле Варошлиески. - 2. изд.-Скопје: Министерство за образование dhe наука на Република Македонија, 2010. - 359 стр.: илУстр.; 24 см

Библиографија: стр. 157. - Содржи и: Прилози

ISBN 978-608-226-260-4

COB1SS.MK-FO 84270858

P Ë R M B A J T J A

1. Nocione të përgjithshme.....	1
1.1. Zhvillimi historik i gjeodezisë.....	1
2. Koordinatat dhe sistemet koordinative.....	6
2.1. Koordinatat kënddrejta dhe sistemi kënddrejtë koordinativ.....	7
2.1.1. Definicioni dhe llogaritja e këndeve të drejta	9
3. Matjet standarde	16
3.1. Njësitë themelore të gjatësisë	16
3.2. Njësitë themelore të sipërfaqes	18
3.3. Njësitë themelore të këndeve	18
3.4. Shndërrimi i vlerave të këndeve nga njëra njësi matëse në tjetrën	20
3.4.1. Shndërrimi i njësive këndore nga ndarja seksagezimale në centizimale dhe e kundërta	20
3.4.2. Shndërrimi i njësive këndore nga ndarja qendërzore ose seksagezimale në radianë dhe e kundërta.....	22
4. Veglat gjeodezike.....	23
4.1. Veglat për matjen e gjatësive	23
4.1.1. Përshkrimi dhe përdorimi i mjeteve	23
4.1.2. Lavjerrësi, shenja dhe trekëmbëshi.....	24
4.1.3. Shiriti i fushës dhe i dorës.....	26
4.2. Veglat për matjen e këndeve.....	28
4.2.1. Stativi	28
4.2.2. Markat dhe prizmat vizure	29
4.3. Veglat për matjen e ndryshimeve në gjatësi.....	30
4.3.1. Hatulla niveluese	30
4.3.2. Papuçet nivelizuese.....	33
5. Teoria e gabimeve.....	34
5.1. Matjet	34
5.2. Kushtet dhe saktësia e matjeve.....	35
5.3. Gabime në rezultatet e madhësive të matura.....	36
5.3.1. Llojet e gabimeve në rezultatet e madhësive të matura	37
5.3.1.1. Gabimet e rastit.....	38
5.3.1.2. Gabimet sistematike	40
5.4. Vlerësimi i saktësisë së rezultateve nga matjet	45
5.4.1. Gabim i pjesërishëm.....	45

5.4.2. Gabim i gjasës.....	46
5.4.3. Gabim i mesëm katror	47
5.4.4. Gabim relativ	50
5.4.5. Gabime të kufizuara (lëshimet e lejuara)	52
5.5. Gabim i mesëm i funksionit të madhësive të matura	54
5.5.1. Gabim i mesëm i funksionit me një madhësi të matur.....	54
5.5.2. Gabim i mesëm i funksionit shuma e dy madhësive të matura... 56	
5.5.3. Gabim i mesëm i funksionit shuma e më tepër madhësive të matura	58
5.6. Barazimi i rezultateve nga matjet direkte	59
5.6.1. Nevoja dhe qëllimi i barazimit të rezultateve nga matjet	59
5.6.2 Barazimi i rezultateve nga matjet direkte me saktësi të barabartë	61
5.6.3. Barazimi i rezultateve nga matjet direkte me saktësi të ndryshme	71
6. Matje të gjatësive	84
6.1. Matje të gjatësive me shirit	84
6.1.1. Profil i gjatësisë së terrenit	85
6.1.2. Matje e gjatësive	86
6.1.3. Procesverbali për matjen e gjatësive.....	90
6.1.4. Përmirësimet gjatë matjes së gjatësive	91
7. Instrumente gjeodezike	98
7.1. Teodoliti dhe pjesët e tij përbërëse	98
7.1.1. Matja e këndeve.....	98
7.1.2. Përshkrimi i teodolitit	100
7.2. Vidat pozicionuese	102
7.3. Libela	102
7.3.1. Libela gypore	102
7.3.2. Ndjeshmëria e libelës.....	106
7.3.3. Libela qendërzuese (sferike).....	108
7.3.4. Torzat e pozicionuara	108
7.3.5. Përtacia e libelës	110
7.3.6. Vështrimi i fluskës së libelës	111
7.4. Dylbitë.....	114
7.4.1. Penjëzori.....	115
7.4.2. Paralaksa e penjëzorit.....	116
7.4.3. Thjerrëza okulare	119

7.4.4. Karakteristikat e dylbisë.....	119
7.5. Limba	122
7.6. Alkidada.....	123
7.7. Mjete për lexim	125
7.7.1. Noniusi.....	126
7.7.2. Mikroskop me shenjë	129
7.7.3. Mikroskop me shkallë nga vijëzat	131
7.7.4. Mikroskop me nonius	134
7.7.5. Mikroskop me mikrometër optik.....	134
7.8. Vijëzimi.....	145
7.9. Rektifikimi i teodolitit.....	147
7.10. Gabimet gjatë matjes së këndeve	158
7.10.1. Ekscentriciteti i boshtit alkidad	159
7.10.2. Ekscentriciteti i rrafshit të vizurës.....	162
7.11. Qendërzim i teodolitit	165
7.11.1. Qendërzim me lavjerrës të thjeshtë.....	165
7.11.2. Qendërzim me lavjerrës të ngurtë	166
7.11.3. Qendërzim me lavjerrës optik.....	168
8. Matja e këndeve horizontale	172
8.1. Metoda e thjeshtë.....	173
8.2. Metoda gyruze.....	174
8.3. Gabime gjatë matjeve	180
8.3.1. Gabime në kushtet e punës.....	180
8.3.2. Gabime personale të operatorit.....	181
9. Matje e këndeve vertikale	183
9.1. Këndi vertikal dhe distanca zenite	183
9.2. Instrumente për matjen e këndeve vertikale (distancat zenite)	185
9.3. Kushtet e instrumenteve me libelë	193
9.3.1. Teodolitet me libelë të thjeshtë gypore	193
9.3.2. Teodolitet me libelë revizore	196
9.3.3. Teodolite pa libelë të dylbisë.....	198
9.4. Teodolite me kompensatorë	201
9.4.1. Kompensator me lëng tek instrumentet nga firma Wild T1 – A	202
9.4.2. Kompensator me lëng tek instrumentet nga firma Kern.....	204
9.4.3. Kompensator me spirale tek instrumentet nga firma Zeiss nga Jena	206

9.5. Matjet e këndeve vertikale.....	209
9.5.1. Metoda e thjeshtë për matje të këndeve vertikale.....	209
9.5.2. Metoda gyryse për matjen e këndeve vertikale	210
10. Rrjeta poligonike	213
10.1. Nocionet kryesore	213
10.2. Klasifikimi i rrjetës poligonike	215
10.3. Projekti dhe rikognoscimi i rrjetës poligonike.....	216
10.4. Llojet dhe tipat e gjurmëve për pikat poligonike	221
10.5. Gropimi (vendosja) e gjurmëve.....	224
10.6. Numrat e pikave poligonike.....	227
10.7. Përshkrimi i vendpozitës së pikave poligonike.....	228
10.8. Matja në rrjetën poligonike.....	229
10.8.1. Matja të skajeve poligonike	229
10.8.2. Largmatësit autoreduktiv.....	235
10.8.3. Mënyra fazore e matjes së gjatësive	237
10.8.4. Matja e këndeve në rrjetën poligonike.....	243
10.8.5. Burimi i gabimeve.....	244
10.8.6. Lëshimet e lejuara	248
10.9. Elaborati i rrjetës poligonike.....	249
10.9.1. Skicë e rrjetës poligonike	249
10.9.2. Plani për llogaritjen e rrjetës poligonike	251
10.9.3. Regjistri	252
10.9.4. Regjistri i përgjithshëm.....	253
11. Rrjeta niveluese	254
11.1. Ana niveluese, fibra dhe rrjeta.....	255
11.2. Zbulimi i rrjetës nivelizuese.....	256
11.3. Shenja - reperi.....	257
11.4. Stabilizimi i reperave nivelizues	259
11.5. Numërimi i reperave	260
11.6. Përshkrimi dhe pozita e reperave.....	260
11.7. Metoda për përcaktimin e ndryshimeve në lartësi.....	260
11.7.1. Nivelizuesi gjeometrik	261
11.7.2. Ndarja e nivelizuesit gjeometrik.....	263
11.7.3. Nivelizuesi i përgjithshëm.....	263
11.7.4. Matjet e ndryshimeve në lartësi të nivelizuesit e përgjithshëm.....	265
11.8. Instrumentet nivelizuese	269
11.8.1. Instrumente nivelizuese me libelë	269

Gjeodezia dhe bazamentet gjeodezike

11.8.2. Nivelues me horizontim automatik të vizurës	281
11.8.3. Niveluesit elektronik.....	286
11.9. Procedura e nivelimit te niveluesi teknik.....	287
11.9.1. Lidhja e nivelizuesit me reper	289
11.9.2. Vazhdim i nivelizuesit	290
11.9.3. Ndërprerja e punës	292
11.10. Burimet e gabimeve gjatë nivelizimit.....	293
11.10.1. Ndikimi i lakimit të Tokës.....	293
11.10.2. Ndikimi i johorizontimit të vizurës.....	296
11.10.3. Ndikimi i jovertikalizimit të hatullës	297
11.10.4. Ndikimi i lakimit të hatullës.....	299
11.10.5. Gabimet për shkak të rrethanave kohore	299
12. Letrat gjeodezike	301
13. Planet gjeodezike.....	303
13.1. Procedura e përpunimit të planeve	303
13.1.1. Përmbajtja e planeve.....	303
13.1.2. Materiale për përpunimin e planeve gjeodezike	304
13.2. Ndarja e letrave detale	309
13.2.1. Ndarja e seksioneve trigonometrike	309
13.2.2. Ndarja e letrave në plan me shkallë 1: 5000	311
13.2.3 Ndarja e letrave detale me shkallë 1: 2500.....	312
13.2.4. Ndarja e letrave detale me shkallë 1: 2000.....	313
13.2.5. Ndarja e letrave detale me shkallë 1: 1000.....	314
13.2.6. Ndarja e letrave detale me shkallë 1: 500.....	315
13.3. Çelësi topografik.....	317
13.3.1. Llojet e shenjave topografike	317
13.3.2. Llojet e shenjave kushtëzuese	318
13.3.3. Përdorimi i çelësit topografik.....	320
13.4. Rrjeta koordinative.....	322
13.4.1. Dedikimi dhe dukja e rrjetës koordinative.....	322
13.4.2. Përpunimi i rrjetës koordinative.....	326
13.4.3. Kontrolli i përpunimit të rrjetës koordinative	336
13.4.4. Futja e pikave gjeodezike	337
13.4.5. Kontrolli i gjendjes së pikave gjeodezike të planit.....	340
13.4.6. Vijëza i rrjetës koordinative, pikave gjeodezike dhe çregjistrimet e tjera	341
14. Sistemi për pozicionim global (GPS)	344
14.1. Kryesore për GPS	344

Gjeodezia dhe bazamentet gjeodezike

14.2. Kush është fajtori për ekzistimin e GPS?	344
14.3. Komponentët e sistemit	346
14.4. Ardhmëria e GPS.....	348
14.5. Parimi punës	349
14.5.1. Matjet e kodeve	350
14.5.2. Matjet fazore.....	352
14.6. Foto galeria.....	353
Literatura	357
Shtojcat.....	359

1. NOCIONET E PËRGJITHSHME

Gjeodezia është shkencë e cila merret me paramasën e tokës, me qëllim të përgatitjes së bazamenteve gjeodezike (*planeve ose hartave gjeodezike*) për rajon të veçantë, për territorin e një vendi, kontinentit ose të gjithë globit të Tokës. Bazamentet gjeodezike përpunohen në bazë të të dhënave të mbledhura në terren me instrumente dhe metoda të ndryshme të punës.

Në gjeodezi maten madhësi *këndore* dhe *lineare*, kurse me përpunimin e tyre të mëtejshëm vihen te të dhëna të ndryshme siç janë koordinatat kënddrejta dhe lartësitë mbidetare të pikave.

1.1. ZHVILLIMI HISTORIK I GJEODEZISË

Për fillim të gjeodezisë llogaritet zhvillimi i gjeometrisë që nga koha e popujve antikë. Sistemet e para ujore në *Mesopotami*, si dhe rregullimi i lumit Nil me siguri ishin bërë në bazë të disa njohurive për matjet, kurse në kohën e tashme për matjet e tilla nuk ekziston asnjë lloj dokumente të shkruara. Me derdhjen e lumit Nil ishte vërsuar e gjithë rrethina duke lënë shtresë frytdhënëse, e cila ka siguruar rendiment të mirë për prodhimet që do të mbillen. Por, para se të fillohet mbjellja, ishte e nevojshme përsëri të shënohen kufijtë e përmbytur të pronësive të përshtatshme të pronarëve tatimor. Përkufizimi ka mundur të realizohet vetëm me ndihmën e gjeometrisë. Nga ato shkaqe në Egjipt është zhvilluar gjeometria si shkencë e nevojshme praktike.

Megjithatë, gjeodezia është zhvilluar si gjeometri praktike, përkatësisht për shkak të nevojave praktike nga studimi i tokës.

Fjala gjeodezi rrjedh nga fjala greke (*geos* - tokë) dhe (*dezi* - ndarje), që në përkthim do të thotë ndarje e tokës.

Deri te paraqitja e *Pitagorës* është llogaritur se Toka ka formë të pllakës së rrafshët e cila është e rrethuar me dete dhe oqeanë. Me vëzh-

gimin e anijeve si humben në horizont Pitagora ka supozuar se Toka ka formë të topit, që më vonë e ka vërtetuar edhe *Aristoteli*.

Me njohurinë se Toka ka formën e topit një numër i madh shkencëtarësh filluan t'i përcaktojnë dimensionet e saj.

Gjeodeti i njohur nga Aleksandria, *Eratosten* ka vërejtur se në periudhën e verës në *Asuan*, dielli shihet në pus, kurse në *Aleksandri*, e cila ndodhet në veri nga *Asuani*, këtë dukuri nuk e ka vërejtur. Kjo do të thotë se atëherë në *Asuan* dielli ishte në zenit (fig 1.1.). Me ndihmën e mjeteve shumë primitive (*skafijan*) e ka matur këndin φ në *Aleksandri* ndërmjet drejtimit të diellit dhe zenitit. Këndi φ ishte $1/50$ nga rrethi i plotë, që e ka përcaktuar dhe distancën ndërmjet ato dy ndërtesa që ishte $S = 5000$ *stade* (*stade*- njësia për matjen e gjatësisë për të cilën sot nuk dihet asnjë e dhënë), si dhe vëllimin e Tokës që ishte 250000 *stade*.




Fig 1.1. Topi si formë e mundshme e Tokës.

Deri në shekullin e XVII është llogaritur se Toka ka formën e topit. *Isak Njutni* i pari ka konstatuar se Toka nuk ka formë të Topit, por duke shfrytëzuar teorinë e tërheqjes së trupave, ka supozuar se Toka ka formën e elipsoidit rrotullues (fig. 1.2.). Elipsoidi rrotullues është trup i cili ndodh me rrotullimin e elipsës rreth boshtit të vet të vogël.




Fig. 1.2. *Elipsoidi si formë e mundshme e Tokës.*

Duke ardhur deri te njohuria se Toka ka formë të elipsoide rrotuluese, akademia e shkencave franceze dërgon dy ekspedita, njëra sa ma afër ekuatorit, në Peru, kurse e dyta sa më afër polit të veriut në Llaplandi. Në bazë të matjeve është vërtetuar se në një shkallë të gjerësisë gjeografike në afërsi të polit përshtatet gjatësia më e madhe e harkut të meridianit sesa të ekuatorit. Me këto të dhëna është vërtetuar se Toka është e shtypur në polet, kurse e zgjatur në Ekuator. Me atë është shkencërisht e vërtetuar teoria e Njutnit për formën e Tokës.




Fig. 1.3 *Sipërfaqja e nivelizuar.*

Në atë kohë gjatësitë e harqeve janë matur në më shumë shtete, në gjerësi të ndryshme gjeografike dhe në bazë të vlerave të matura është dashur të gjenden vlerat më të sakta për dimensionet e Tokës. Me fjalë të tjera, është paraqitur problem me barazimin e rezultateve të matjeve të bëra.




Fig. 1.4. Gjeoidi.

Gausi në vitin 1809 ka vendosur teorinë themelore për barazimin e matjeve të bëra me kusht që mbledhja e katrorit në përmirësimin e vlerave të matura të jetë minimale. Teoria e barazimit të cilën e ka definuar *Gausi* ende zbatohet gjatë përpunimit matematikor të rezultateve të madhësive të matura në gjeodezi.

Duke njohur hipotezën për krijimin e Tokës mund të përfundojmë se me rrotullimin rreth boshtit të Tokës në rrotullim, në çdo pikë e cila ndodhet në Tokë veprojnë dy fuqi, edhe atë: *fuqia centripetale*, e cila pikën e tërheq kah qendra e Tokës, dhe *fuqia centrifugale* e cila pikën e largon nga boshti i rrotullimit. Fuqia centrifugale e poleve është e barabartë me zero, kurse zmadhohet duke shkuar kah ekuatori ku vlera e tij është më e madhe. Nën ndikimin e fuqisë centrifugale dhe centripetale sipërfaqja e masës së lëngët homogjene zë ashtu pozitë tillë e cila është normale në secilën pikë të drejtimit me rezultanten e tyre, kurse ajo është sipërfaqja e nivelizuar (fig. 1.3.). Me kalimin e kohës, pjesa periferike e masës së nxehtë të lëngët gradualisht është ftohur, ka ardhur deri te erupSIONET vullkanike dhe tërmete me çka është formuar korja e Tokës. Ana e saj e jashtme quhet sipërfaqe fizike e Tokës (**SFT**).

Trashësia e kores së Tokës nuk është çdo kund e njëjtë dhe nuk është çdo kund me dendësi të njëjtë. Prandaj Toka ka formë të **gjeidit** (fig 1.4), e cila sipërfaqe duket si ndalesë e sipërfaqes së elipsoidit. Sipërfaqet e tyre përafërsisht mbulohen. Nga këtu mund të përfundojmë se gjeoidi ka formë të elipsoidit jo të rregullt dhe nuk mund ta definojmë

në mënyrë matematikore. Kur sipërfaqja e deteve dhe oqeanëve të qeta do të ishte nënshtruar nën tokë, do të ishte fituar gjeoidi.




Fig. 1.5. *Elipsoidi rrotullues*

Shkaku se gjeoidi është trup me formë jo të rregullt gjeometrik, gjatë përpunimit të të dhënave në gjeodezi, ai zëvendësohet me trup të rregullt gjeometrik, i cili nga forma më së shumti i përshtatet, e ai është *elipsoidi rrotullues*.

Boshti i vogël i elipsoidit b mbulohet me boshtin e rrotullimit të Tokës, kurse boshti i madh a shtrihet në rrafshin e ekuatorit (fig. 1.5.). Për zgjedhjen e detyrave gjeodezike është e nevojshme të dihen format dhe dimensionet e Tokës, përkatësisht dimensionet e elipsoidit rrotullues.

Në bazë të matjeve, për çdo territor mund të caktohet elipsoidi rrotullues për të cilin territor më së miri do të përshtatet me gjeoidin. Elipsoidi i këtillë rrotullues quhet *elipsoid referent*. Në bazë të asaj që është përmendur më lart ekziston vetëm *një elipsoid i përgjithshëm* (i cili ende nuk është i caktuar), kurse ka *më shumë elipsoide referente*. Me përcaktimin e dimensioneve të elipsoidit referent janë marrë më shumë shkencëtarë në kohë të ndryshme dhe për territore të ndryshme. Në më shumë vende në Evropë, si dhe te në përdoret *elipsoidi i Beselit* me karakteristikat e mëposhtme:

- gjysmëbosht i madh $a = 6\,377\,397,155$ m
- gjysmëbosht i vogël $b = 6\,356\,078,963$ m
- shtypja $f = \frac{a-b}{a} = 1:299,15281$.

2. KOORDINATAT DHE SISTEMET KOORDINATIVE

Pozita e pikave mbi elipsoid përcaktohen me *gjerësi gjeografike* φ dhe *gjatësi gjeografike* λ (fig. 2.1.). Ato janë *Madhësi këndore* me ndihmën e të cilave caktohet pozita e pikave të sipërfaqes Tokësore në krahasim me ekuatorit, përkatësisht meridianin fillestar.




Fig. 2.1. Koordinata gjeografike

Koordinatat gjeografike (φ , λ) sipas mënyrës së përcaktimit mund të jenë *astronomike* dhe *gjeodezike*.

Gjerësia gjeografike (φ) është kënd i cili e mbulon vertikalen, përkatësisht normalen në pikën e dhënë me rrafshin e ekuatorit, të matur në rrafshin e meridianit. Gjerësitë gjeografike kanë vlerë nga 0° deri në 90° në veri dhe jug nga ekuatori, gjatë të cilës vlerat veriore llogariten pozitive, kurse ato jugore negative.

Gjatësia gjeografike (λ) paraqet këndin i cili e përfshin rrafshina e meridianit fillestar (të Grinuiçit) me rrafshin e vertikales, përkatësisht normalja në pikën e dhënë, të matur në rrafshin e ekuatorit. Gjatësitë gjeografike llogariten nga 0° deri në 180° në anën lindore dhe perëndimore të meridianit fillestar, gjatë të cilës ana lindore ka vlera pozitive, kurse ana perëndimore ka vlera negative.

Koordinatat astronomike gjeografike i referohen vertikales, kurse koordinatat gjeodezike gjeografike i referohen normales në pikën e përshtatshme të elipsoidit (fig. 2.2.).




Fig. 2.2. Normalja dhe vertikalja në pikën e dhënë

Vertikalja (V) përfaqëson drejtim në të cilin vepron forca e nxitimit të Tokës. Ajo është normale e sipërfaqes të nivelit zero me të cilin është definuar *gjeoidi Tokësor*.

Normalja (N) në pikën e dhënë të elipsoidit paraqet drejtim normal në rrafshin e elipsoidit në atë pikë. Të gjitha normalet e prejnë boshtin e vogël të elipsoidit.

2.1. KOORDINATAT KËNDDREJTA DHE SISTEMI KËNDDREJTË KOORDINATIV

Paraqitja e sipërfaqes së Tokës nga elipsoidi rrotullues i bazave gjeodezike bëhet me procedurë të quajtur *rifotografim*. Me atë rast, pikat e elipsoidit, si sipërfaqe e dyfishtë e lakuar, së pari rifotografohen në ndonjë sipërfaqe thjeshtë të lakuar (kon, cilindër) (fig. 2.3.), kurse pastaj sipërfaqen e njëjtë e zhvillojmë në rrafsh.

Për vendin tonë rifotografimi i pikave nga elipsoidi në rrafsh është bërë sipas projeksionit Gaus-krigerit, i cili është proporcionalë, i tërthortë cilindrik me fotografim të pjesëve të sipërfaqes së Tokës së cilindrave eliptik, edhe atë: në zonat nga 3° të gjatësisë gjeografike (fig. 2.4.).

Secila zonë fiton numrin e vet, duke filluar nga meridiani i Grinuçit kah lindja, ashtu që shteti ynë gjendet në zonën e 7-të, me cilindër prekës në meridianin e mesëm, e cila gjatësi gjeografike është 21° në lindje nga meridiani fillestar.




Fig. 2.3. Fotografimi i elipsoidit në hapësirën cilindrike të projekcionit Gaus-kriger.




Fig. 2.4 Zonat në projekcionin Gaus-kriger

Me atë definohet sistemi koordinativ drejtkëndor për fotografim të territorit të vendit tonë në rrafsh. Projeksjoni i meridianit të 21-të, t gjatësisë lindore gjeografike, paraqet boshtin X, me drejtim pozitiv kah veriu, ndërsa projeksjoni i ekuatorit është adoptuar si boshti Y, me drejtim pozitiv kah lindja. Boshtet X dhe Y prehen në fillimin koordinativ (pika O) dhe e ndajnë hapësirën në katër katrorë (fig. 2.5.).




Fig. 2.5. Sistemi koordinativ drejtkëndor në projekcionin Gaus-kriger.

Në sistemin e tillë koordinativ të definuar për vendin tonë, koordinatat e boshtit X kanë vlera pozitive, ndërsa koordinatat e boshtit Y kanë vlera negative. Me qëllim që të mënjanohej vlerat negative të boshtit Y, në koordinatën fillestare është dhënë vlera prej 500000,00 m (propozimi i Baumgerit). Te vlera e boshtit Y, për çdo pikë duhet të mbetet numri i sistemit koordinativ, kështu që për të gjitha pikat në vendin tonë para vlerave Y koordinatave mbetet numri 7, sepse i takon sistemit koordinativ të 7-të. Kështu, për shembull: koordinatat për një pikë gjeodezike janë 722 (Y = 7589123, 48; X = 4647908, 57).

2.1.1. Definicioni dhe llogaritja e këndeve të kahëzuara

Këndi i kahëzuar ν_A^B nga pika A deri te pika B (lexohet „ni” nga A në B) definohet si kënd i cili zë kahjen e cila është paralele me boshtin X në pikën A, me kahje e definuar me pikat A dhe B (fig. 2.6.) në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës (drejtim pozitiv). Le të jepen koordinatat e pikave A (Y_A, X_A) dhe B (Y_B, X_B). Në atë rast kërkohet këndi i kahëzuar ν_A^B dhe gjatësia e brinjës \overline{AB} (fig. 2.7.).




Fig. 2.6. Këndi i kahëzuar

Në sistemin koordinativ kënddrejtë (YOX), gjatësia \overline{AB} është hipotenuza e trekëndëshit kënddrejtë ΔABC (fig. 2.7.), ndërsa katetet paraqesin ndryshime koordinative të pikave A dhe B të cilat i llogariten si vijon:




Fig. 2.7. Ndryshimet e koordinatave dhe këndi i kahëzuar.

$$\Delta Y_A^B = Y_B - Y_A \quad \text{dhe} \quad (2.1.)$$

$$\Delta X_A^B = X_B - X_A. \quad (2.2.)$$

Sasia e kasetës së shtrirë dhe të kundërt në trekëndëshin ΔABC (fig. 2.6.) paraqet tangjenten e këndit të kahëzuar dhe llogaritet si:

$$\operatorname{tg} v_A^B = \frac{Y_B - Y_A}{X_B - X_A} = \frac{\Delta Y_A^B}{\Delta X_A^B}. \quad (2.3.)$$

Vlera e llogaritur në këtë mënyrë e këndit të kahëzuar duhet të kontrollohet, të bëhet kontroll i llogaritjes (fig. 2.8.) me ndihmën e relacionit si vijon:

$$\operatorname{tg}(v_A^B + 45^\circ) = \frac{\Delta X_A^B + \Delta Y_A^B}{\Delta X_A^B - \Delta Y_A^B}. \quad (2.4.)$$

Për vlerën e gjatësisë së kërkuar ndërmjet pikave A dhe B ekzistojnë më shumë relacione të cilat do t'i cekim, edhe atë: kur e llogarisim gjatësinë me ndihmën e këndit të kahëzuar dhe ndryshimet koordinative. Nga trekëndëshi kënddrejtë ΔABC (fig. 2.7.) kemi:




Fig. 2.8. Kontrollimi për këndin e kahëzuar.

$$\sin v_A^B = \frac{\Delta Y_A^B}{D_{A,B}} \Rightarrow D_{A,B} = \frac{\Delta Y_A^B}{\sin v_A^B}, \quad (2.5.)$$

$$\cos v_A^B = \frac{\Delta X_A^B}{D_{A,B}} \Rightarrow D_{A,B} = \frac{\Delta X_A^B}{\cos v_A^B}, \quad (2.6.)$$

si edhe

$$D_{A,B} = \sqrt{(Y_B - Y_A)^2 + (X_B - X_A)^2},$$

$$D_{A,B} = \sqrt{(\Delta Y_A^B)^2 + (\Delta X_A^B)^2}. \quad (2.7.)$$

Nga definicioni për këndin e kahëzuar del se vlera e tij gjendet në kufijtë nga 0° deri në 360° ($0^\circ \leq v \leq 360^\circ$), ose në varësi nga pozicioni i gjatësisë në sistemin koordinativ. Gjatë kësaj mund të përfundohet se këndi i kahëzuar mund të jetë në katër katrorë, që llogaritja e tij do të varet nga ajo se në cilin katror gjendet gjatësia \overline{AB} . Katrori i këndit të kahëzuar definohet me parashenjat e ndryshimeve koordinative. ΔY dhe ΔX . Llogaritja e këndeve të kahëzuara, përputhje me parashenjat e ndryshimeve koordinative, mund të shihet në tabelën 2.1

Gjatë llogaritjes së këndit të kahëzuar mund të shihet se ai përbëhet nga dy pjesë (fig. 2.9.) pjesa e parë është këndi ω i fituar në bazë

të herësit $\Delta Y / \Delta X$, kurse pjesa e dytë nga vlera e rrumbullakuar (0° , 90° , 180° dhe 270°) e cila shtohet në këndin ω në varësi të katrorit.

Tabela 2.1.

katrori	I	II	III	IV
ndryshimet koordinative	($0^\circ-90^\circ$)	($90^\circ-180^\circ$)	($180^\circ-270^\circ$)	($270^\circ-360^\circ$)
$\Delta Y = Y_B - Y_A$	+	+	-	-
$\Delta X = X_B - X_A$	+	-	-	+
v	ω	$\omega + 90^\circ$	$\omega + 180^\circ$	$\omega + 270^\circ$




Fig. 2.9. Këndi i kahëzuar i paraqitur në të gjithë katrorët.

Llogaritje e këndit të kahëzuar dhe gjatësinë ndërmjet dy pikave në katrorë të ndryshëm do ta tregojmë me disa shembuj.

Shembulli 2.1 Llogariteni këndin e kahëzuar v_{360}^8 dhe gjatësinë ndërmjet pikëve $\hat{A}360(58074.12; 85403.57)$ dhe $\circ 8(58204.36; 85414.62)$

Zgjidhje:

$$\Delta Y = Y_{360} - Y_8 = 130.24$$

$$\Delta X = X_{360} - X_8 = 11.05$$

$$\operatorname{tg} \omega = \frac{\Delta Y}{\Delta X} \Rightarrow \omega = \operatorname{arctg} 11.786425$$

$$v_{360}^8 = \omega = 85^\circ 09' 02''$$

$$\left. \begin{array}{l} \Delta Y > 0 \\ \Delta X > 0 \end{array} \right\} \Rightarrow \left\{ \begin{array}{l} I \text{ katror} \\ 0^\circ < v < 90^\circ \end{array} \right.$$

$$\omega = 85^\circ 09' 02''$$

Kontrollimi i këndit të kahëzuar :

$$\operatorname{tg}(\omega + 45^\circ) = \frac{\Delta X + \Delta Y}{\Delta X - \Delta Y} \qquad \omega + 45^\circ = \operatorname{arctg} -1.185418$$

$$\omega = 130^\circ 09' 02'' - 45^\circ \qquad \nu_{360}^8 = \omega = 85^\circ 09' 02''$$

$$D_{360-8} = \sqrt{\Delta Y^2 + \Delta X^2} = 130,71m$$

Kontrollimi i gjatësisë :

$$D = \frac{\Delta Y}{\sin \nu_{360}^8} = \frac{\Delta X}{\cos \nu_{360}^8} = 130,71m .$$

Shembulli 2.2: Llogariteni këndin e kahëzuar ν_8^9 dhe gjatësinë ndërmjet pikave $\odot 8$ (58204.36; 85414.62) dhe $\odot 9$ (58402.50; 85398.49)

Zgjidhje:

$$\begin{aligned} \Delta Y &= Y_9 - Y_8 = 198.14 & \left. \begin{array}{l} \Delta Y > 0 \\ \Delta X < 0 \end{array} \right\} & \Rightarrow \left\{ \begin{array}{l} \text{II katror} \\ 90^\circ < \nu < 180^\circ \end{array} \right. \\ \Delta X &= X_9 - X_8 = -16.13 \end{aligned}$$

$$\operatorname{ctg} \omega = \frac{|\Delta Y|}{|\Delta X|} \Rightarrow \omega = \operatorname{arctg} 12.285803 \quad \omega = 4^\circ 39' 12''$$

$$\nu_8^9 = \omega + 90 = 94^\circ 39' 12'' .$$

Kontrollimi i këndit të kahëzuar:

$$\operatorname{tg}(\omega + 45^\circ) = \frac{\Delta X + \Delta Y}{\Delta X - \Delta Y} \qquad \omega + 45^\circ = \operatorname{arctg} -0.849442$$

$$\omega = 139^\circ 39' 12'' - 45^\circ \qquad \nu_8^9 = \omega = 94^\circ 39' 12''$$

$$D_{8-9} = \sqrt{\Delta Y^2 + \Delta X^2} = 198,80m$$

Kontrollimi i gjatësisë:

$$D = \frac{\Delta Y}{\sin \nu_8^9} = \frac{\Delta X}{\cos \nu_8^9} = 198,80m .$$

Shembulli 2.3. Llogariteni këndin e kahëzuar ν_{65}^{64} dhe gjatësinë ndërmjet pikëve $\odot 65$ (59791.48; 85587.31) dhe $\odot 64$ (59696.03; 85510.48).

Zgjidhje:

$$\begin{aligned} \Delta Y &= Y_{65} - Y_{64} = -95.45 & \Delta Y < 0 \\ \Delta X &= X_{65} - X_{64} = -76.83 & \Delta X < 0 \end{aligned} \Rightarrow \begin{cases} \text{III katror} \\ 180^\circ < \nu < 270^\circ \end{cases}$$

$$\operatorname{tg} \omega = \frac{\Delta Y}{\Delta X} \Rightarrow \omega = \operatorname{arctg} 1.242353 \quad \omega = 51^\circ 10' 07''$$

$$\nu_{65}^{64} = \omega + 180^\circ = 231^\circ 10' 07''$$

Kontrollimi i këndit të kahëzuar:

$$\operatorname{tg}(\omega + 45^\circ) = \frac{\Delta X + \Delta Y}{\Delta X - \Delta Y} \quad \omega + 45^\circ = \operatorname{arctg} -1.185418$$

$$\omega = 130^\circ 09' 02'' - 45^\circ \quad \nu_{360}^8 = \omega = 85^\circ 09' 02''$$

$$D_{360-8} = \sqrt{\Delta Y^2 + \Delta X^2} = 122,53m$$

Kontrollimi i gjatësisë:

$$D = \frac{\Delta Y}{\sin \nu_{65}^{64}} = \frac{\Delta X}{\cos \nu_{65}^{64}} = 122,53m.$$

Shembulli 2.4. Llogariteni këndin e kahëzuar ν_{66}^{37} dhe gjatësinë ndërmjet pikave \odot_{66} (60060.53, 85016.03) dhe \odot_{37} (59930.85, 85134.36).

Zgjidhje:

$$\begin{aligned} \Delta Y &= Y_{66} - Y_{37} = -129.68 & \Delta Y < 0 \\ \Delta X &= X_{66} - X_{37} = 118.33 & \Delta X > 0 \end{aligned} \Rightarrow \begin{cases} \text{IV katror} \\ 180^\circ < \nu < 270^\circ \end{cases}$$

$$\operatorname{ctg} \omega = \frac{|\Delta Y|}{|\Delta X|} \Rightarrow \omega = \operatorname{arcctg} 1.095918 \quad \omega = 42^\circ 22' 47''$$

$$\nu_8^9 = \omega + 90 = 94^\circ 39' 12''$$

Kontrollimi i këndit të kahëzuar:

$$\operatorname{tg}(\omega + 45^\circ) = \frac{\Delta X + \Delta Y}{\Delta X - \Delta Y} \quad \omega + 45^\circ = \operatorname{arctg} -2.620272$$

$$\omega = 357^\circ 22' 47'' - 45^\circ \quad \nu_{66}^{37} = \omega = 312^\circ 22' 47''$$

$$D_{360-8} = \sqrt{\Delta Y^2 + \Delta X^2} = 175,55m$$

Kontrollimi i gjatësisë:

$$D = \frac{\Delta Y}{\sin \nu_{66}^{37}} = \frac{\Delta X}{\cos \nu_{66}^{37}} = 175,55m .$$

3. STANDARDET PËR MATJE

Në procedurën e matjeve gjeodezike bëhet matje e dy madhësive: *gjatësitë* dhe *këndet*. Matja e gjatësisë bën pjesë në grupin e *matjeve lineare*, ndërsa matjet e këndeve bëjnë pjesë në grupin e *matjeve këndore*.

3.1. NJËSITË THEMELORE PËR GJATËSI

Deri në fund të shekullit XVIII- të në botë nuk ekzistonin njësi për shprehjen e vlerave të gjatësive dhe shpesh herë si njësi janë përdorur pjesë nga trupi i njeriut, siç janë: gishti i madh, shputa, bërryli, ose vlera tjera siç janë: *toaz*, *jard*, *arshin* etj. Secili shtet ka pasur njësi për matjen e gjatësisë, por edhe disa qytete më të mëdha në ato shtete kanë pasur vlerat matëse të gjatësisë siç janë: *fat parisien fat*, *fat vjenez*, *fat prusian* etj.

Pas fundi të Revolucionit francez, kah fundi i shekullit XVIII-të, është zbatuar sistem i veçantë i njësive matëse, me të cilat përcaktohen vlerat e madhësive lineare. Si njësi themelore është zbatuar metri i cili paraqet pjesën e dyzet milionët të meridianit.

Denkerku nga Barcelona ka bërë vizore metali të mprehur në skajet me gjatësi prej një metër, gjerësi prej 25 mm dhe trashësi prej 4 mm. Vizorja e tillë quhet *vizore arkive* dhe ruhet në Byronë ndërkombëtare për matje dhe peshore në Serv, në afërsi të Parisit. Byroja ndërkombëtare për matje dhe peshore kishte dhënë urdhër të gjitha vendet, të cilat ishin nënshkruese të Konventës për Metër, t'iu bëhet nga një prototip i metrit nga legura në platinit (90%) dhe iridiumit (10%). Legura e këtillë ka cilësi që mos t'i ndryshojë dimensionet e tij gjatë kohës dhe me ndryshimet e kohës. Prototipat e metrit janë përpunuar si lloj i shufrave me gjatësi prej 102 cm dhe me prerje tërthore të treguar si në fig. 3.1.




Fig. 3.1. Prerje gjatësore dhe tërthore e metrit prototip.

Nëpër gjatësinë e boshtit të shufrës, në vijën e saj neutrale dhe të lëmuar I-II dhe nga distanca e tyre prej 0, 2 mm, janë gdhendur vizatime paralele me të cilin mendim definohet boshti i metrit prototip.

Në skajet e shufrës, në distancën mes tyre prej 0, 5 mm, janë shkaktuar tri vijëza tërthore me trashësi prej 8 mm. Gjatësia e metrit prototip definohet me distancë ndërmjet vijës së vogël të mesme, me matje nga boshti i shufrës në temperaturë prej 0° C.

Gjatësia e të gjithave vizoreve të përpunuar prototipa janë krahasuar ndërmjet tyre edhe me gjatësinë e metrit arkiv.

Gabimet në gjatësitë janë më të vogla se 0.2 μm . Prototipi me numër 6, i cili e ka pasur vlerën më të afërt me metrin arkiv, është shpallur si prototip ndërkombëtar dhe ka marrë shenjën *M*. Me fitim e prototipit ndërkombëtar, definicioni për metrin thotë: Distanca ndërmjet vijave të mesme tërthore të prototipit ndërkombëtar, i matur nga boshti i shufrës në temperaturë prej 0°C, paraqet një metër.

Nxjerrja e njësive nga metri janë:

a) njësitë më të vogla të metrit janë:

- decimetër 1dm = 0, 1m;
- centimetër 1cm = 0,01m;
- milimetër 1mm = 0,001m;

b) Njësitë më të mëdha të metrit janë

- dekametër 1dkm = 10 m;
- hektometër 1hm = 100 m;
- kilometër 1km = 1000 m.

3.2. NJËSITË THEMELORE PËR SIPËRFAQE

Njësitë matëse për sipërfaqe janë njësi të nxjerra nga njësitë e metrit për gjatësi. Njësia për sipërfaqe në sistemin e metrit të njësive matëse është metri katror (m^2).

Njësi më të vogla se metri katror janë:

- decimetër katror $1dm^2 = 0,01m^2$;
- centimetër katror $1cm^2 = 0,0001 m^2$;
- milimetër katror $1mm^2 = 0,000001 m^2$.

Njësitë më të mëdha se metri katror janë:

- ar ($1 a$) = $100 m^2$;
- hektar ($1 ha$) = $100 a = 10000 m^2$;
- kilometër katror ($1 km^2$) = $1000000 m^2$.

3.3. NJËSITË THEMELORE PËR KËNDE

Për matjen e këndeve shfrytëzohen njësi të cilat paraqesin pjesë të përshtatshme nga harku rrethor siç janë:

- radiani (njësi harku)
- shkalla (ndarje vjetër)
- gon ose gradus (ndarje e re)

Në pajtim me Sistemin ndërkombëtar të njësive të peshores dhe matjes (SI), njësia themelore për matje të këndeve në rrafsh është radiani ($1rad = \frac{1m}{1m} = 1$). Radiani është kënd i qendror ρ gjatësia e harkut të të cilit është e barabartë me gjatësinë e rrezes (fig. 3.2.).




Fig. 3.2. Radiani.

Për kënd konstant α , raporti i harkut dhe rrezja përkatëse mbeten të pandryshuara (fig. 3.3.).

$$\frac{l_1}{R_1} = \frac{l_2}{R_2} = \frac{l_3}{R_3} = \dots = \frac{l_n}{R_n} = \text{const} = \alpha.$$




Fig. 3.3. Këndi konstant.

Për njësi matëse për matjen e këndeve në SI është marrë një radian, ose kënd për të cilin raportet mes harkut dhe rrezeve është i barabartë me njësinë ($l : R = 1 = \rho$).

Te ne më shumë përdoret ndarja e vjetër (segzagezimale) tek e cila njësia themelore për matjen e këndeve është një shkallë. *Shkalla* është kënd i qendror i cili i përgjigjet pjesës së treqind e gjashtëdhjetë nga vëllimi i rrethit të plotë ($1^\circ = 60'$, $1' = 60''$).

Në shumë vende në botë shfrytëzohet ndarja (centizimale) ose ndarja graduse. Në të njësia themelore për matjen e këndeve është *gradusi* ose *goni*. Gradusi është kënd i qendror i cili përgjigjet pjesës së katërqindët nga vëllimi i rrethit të plotë ($1^{\text{gr}} = 100^{\text{c}}$, $1^{\text{c}} = 100^{\text{cc}}$).

Ndarja graduese është e përshtatur në sistemin e numrit dekad dhe është shumë e përshtatshme për përdorimin e makinat llogaritëse, i cili nuk është rast te ndarja segzagezimale. Nga 100 njësitë e njësive më të vogla matëse, vetë makinat llogaritëse (për njësinë) e rrit numrin matës të njësisë së mëparshme matëse. Vlerën këndore të 46 graduseve, 25 minutave graduse dhe 88 sekondave graduse mund ta shënojmë si:

$$46^{\text{gr}} 25 88 \text{ ose } 46^{\text{gr}} 25^{\text{c}} 88^{\text{cc}} \text{ ose } 46,^{\text{gr}} 2588$$

Meqë vëllimi i rrethit është $2R\pi$, ndërsa rrezja është R , në një vijë të plotë rrethore (këndi qendror prej 360° ose 400^{gr}) përgjigjet barazimi:

$$\frac{2R\pi}{R} = 2\pi \text{ radiane} = 2\rho\pi = 360^\circ = 400^{gr}. \quad (3.1.)$$

Meqë vlera e π është 3, 14159265359....., nga barazimi (3.1) mund të llogaritet vlera e radianit në shkallë:

$$\rho^\circ = \frac{360^\circ}{2\pi} = \frac{180}{\pi} = 57,295780$$

$$\rho' = \rho^\circ \cdot 60 = 3438'$$

$$\rho'' = \rho' \cdot 60 = 206265'',$$

ose në graduse:

$$\rho^{gr} = \frac{400^{gr}}{2\pi} = \frac{200^{gr}}{\pi} = 63,661977$$

$$\rho^c = \rho^{gr} 100 = 6366,20$$

$$\rho^{cc} = \rho^c 100 = 636620^{cc}.$$

3.4. KTHIMI I VLERAVE TË KËNDEVE NGA NJËRA NJËSI MATËSE NË TJETËR NJËSI MATËSE

Shumë herë është e nevojshme ndarja këndore nga njëra njësi matëse në tjetër njësi. Për shembull, këndet janë matur me ndarje centizimale, kurse për përpunimin e mëtutjeshëm të matjes nevojitet ndarje segzagezimale.

3.4.1. Kthimi i njësive këndore nga ndarja segzagezimale në centizimale dhe e kundërta

Për llogaritjen e disa njësive këndore në të tjera i shfrytëzojmë barazimet e radhës:

$$360^\circ = 400^{gr} \qquad 90^\circ = 100^{gr} \qquad (3.2.)$$

$$\begin{array}{ll}
 1^{\circ} = \frac{10}{9} \cdot 1^{gr} & 1^{gr} = \frac{9}{10} \cdot 1^{\circ} \\
 1' = 1^{\circ}85185 & 1^c = 32'',4 \\
 1'' = 3^{cc}08642 & 1^{cc} = 0'',324.
 \end{array} \quad (3.3.)$$

Procedurën për llogaritje do ta tregojmë me dy shembuj konkret.

Shembulli 3.1: Këndi $\alpha = 149^{\circ}56'28''$, të shprehet në njësi centizimale.

Zgjidhje:

$$\begin{array}{l}
 \alpha = 149^{\circ}56'28'' \\
 28'' : 60 = 0',467 \\
 56',467 : 60 = 0^{\circ},94111 \\
 \alpha^{\circ} = 149^{\circ},94111 \\
 \alpha^{gr} = \frac{10}{9} \cdot 149^{\circ},94111 = 166^{gr},60123 \\
 \alpha^{gr} = 166^{gr}60^c12^{cc} = 166^{gr},6012.
 \end{array}$$

Shembulli 3.2: Këndi $\alpha = 175^{\circ}96'76''$, të shprehet në njësi segzagezimale.

Zgjidhje:

$$\begin{array}{l}
 \alpha = 175^{gr}96^c76^{cc} \\
 \alpha = 175^{gr},9676 \\
 \alpha^{\circ} = \frac{9}{10} \cdot 175^{gr},9676 = 158^{\circ},37084 \\
 0,37084 \times 60 = 22',2505 \\
 0,2505 \times 60 = 15'' \\
 \alpha^{\circ} = 175^{\circ}22'15''.
 \end{array}$$

3.4.2. Shndërrimi i njësive këndore nga ato segzagezimale ose centizimale në radiane ose e kundërta

Vlerat këndore mund të shprehen në radiane nëse njësitë e tyre janë shprehur në njësi segzagezimale ose centizimale të ndarjes. Për llogaritjen e tillë i shfrytëzojmë barazimet e radhës:

$$\alpha = \frac{\alpha^{\circ}}{\rho^{\circ}} = \frac{\alpha'}{\rho'} = \frac{\alpha''}{\rho''} - \text{për shkallë, ose}$$

$$\alpha = \frac{\alpha^{gr}}{\rho^{gr}} = \frac{\alpha^c}{\rho^c} = \frac{\alpha^{cc}}{\rho^{cc}} - \text{për rreze.}$$

Procedurën për llogaritjen do ta shpjegojmë me shembujt në vijim.

Shembulli 3.3: Këndin $\alpha = 34^{\circ}15'26''$, shpreheni në radiane.

Zgjidhje:

$$\alpha = 34^{\circ}15'26''$$

$$26'' : 60 = 0.433$$

$$15',433 : 60 = 0,25722$$

$$\alpha = 34^{\circ},25722$$

$$\alpha_{rad} = \frac{34^{\circ},25722}{57^{\circ},29578} = 0,597901.$$

Shembulli 3.4: Këndin $\alpha = 26^{gr} 67^c 89^{cc}$, shpreheni në radiane.

$$\alpha^{gr} = 26^{gr} 67^c 89^{cc} = 26^{gr},6789$$

$$\alpha_{rad} = \frac{26^{gr},6789}{63^{gr},66198} = 0.419071.$$

4. VEGLAT GJEODEZIKE

Gjeodezia është shkencë e cila merret me studimin e tokës me qëllim të përpunimit të bazamenteve gjeodezike (plane ose karta) për territor të veçantë, për territorin e një vendi, kontinentin ose për tërë globin Tokësor.

Në gjeodezi maten madhësi këndore dhe lineare, kurse me përpunimin e tyre të mëtutjeshëm arrihet deri te të dhëna të ndryshme siç janë koordinatat kënddrejta dhe lartësitë mbidetare në pikat të cilat i shfrytëzojmë për përpunimin e bazamenteve gjeodezike. Bazamentet gjeodezike përpunohen në bazë të të dhënave të mbledhura në terren me instrumente të ndryshme dhe metoda të ndryshme të punës.

Në varësi prej saktësisë me të cilën duhet të përpunohet bazamenti gjeodezik zbatohen metoda të përshtatshme për matje. Si mjet themelor për matje shërbehen vegla të ndryshme gjeodezike të cilat shfrytëzohen në gjeodezi, kurse zgjidhen në varësi nga madhësitë të cilat maten. Përveç mjeteve gjeodezike, shfrytëzohen edhe mjete të tjera gjeodezike të cilat shërbejnë për punën me veglat. Cilat instrumente dhe vegla gjeodezike do të përdoren, varet nga metoda e matjes, si dhe nga saktësia të cilën duam ta arrimë në procesin e matjes.

Veglat gjeodezike janë shumë të llojllojshme dhe janë të domosdoshme në procesin e matjes së cilat bëhen në sipërfaqen fizike të Tokës.

4.1. EGLAT PËR MATJEN E GJATËSIVE

4.1.1. Përshkrimi dhe shfrytëzimi i veglave

Në veglat për matje direkte të gjatësive bëjnë pjesë: lavjerrës, shenja, trekëmbësh, shiriti i fushës, shiriti i dorës, numërues i thumbave dhe hallka.

4.1.2 Lavjerrës, shenja dhe trekëmbëshi

Për vendosjen e shenjës në pozicionin vertikal si dhe për qendërzimin e instrumentit ose në përgjithësi për materializimin e drejtimit vertikal shfrytëzohet *lavjerrësi*.

Lavjerrësi është trup metal me peshë prej 100 deri në 200 gr me formë të rrotulluesit (çiagrës) (fig. 4.1.) Pjesa e poshtme e lavjerrësit është me formë koni, ndërsa pjesa e sipërme është në formë të cilindrit. Në pjesën e sipërme të lavjerrësit ka vrimë nëpërmjet të cilës është tërhequr peri me trashësi prej 1 deri 2 mm dhe gjatësi prej 1 deri 2 m. Peri mund të jetë pe i thjesht ose i thurur.




Fig 4.1. *Lavjerrësi, shenja, trekëmbëshi.*

Për sinjalizim e pikave dhe ruajtjen e tyre në terren shfrytëzohen *shenja*.

Shenja është vegël e cila shfrytëzohet për sinjalizimin e pikave në terren. Ajo bëhet me shkopinj prej druri në formë cilindrike, me gjatësi prej 2 deri 4 m dhe diametër 2 deri 4 cm, ose me mbështjellëse metalike e mprehur në majë në formë të konit. Për ruajtje më të lehtë në terren, shenjat janë të lyera në mënyrë reciproke me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë (të yndyrshme). Gjatësia e fushave të kuqe dhe të bardha shpeshherë është prej 20 deri 50 cm. Druri prej të cilit bëhet shenja, duhet të jetë i drejtë dhe i qëndrueshëm nga lagështisë. Përveç shenjave prej druri shfrytëzohen edhe shenja prej metali me diametër 1-2 cm.

Në terren me shtresa të forta (asfalt, beton, gurë) dhe në pikat që janë të stabilizuara me shënime prej guri, nuk është e mundur që të

tejkalohe shenja. Prandaj, në terren të tillë për vendosjen e shenjës në pozitë vertikale shfrytëzohet trekëmbësh prej metali me gjatësi prej 1m. Trekëmbëshi në pjesën e sipërme ka unazë prej metali me diametër më të madh se diametri i shenjës që ajo të mund të tërhiqet përmes unazës.

Për përforcimin e shenjës në unazë shfrytëzohet kaçavida e përshatshme.

Shenja mund të vihet në pozitë vertikale në dy mënyrat e ardhshme:

A) Me vendosjen e shenjës në terren

Shenjën e vendosim në terren dhe nga ajo mënjanohe mi 3-4 m. Pastaj me perin e lavjerrësit (i cili lirshëm është i varur) kontrollohet nëse shenja me të është paralele. Nëse shenja nuk është vertikale, rregullohet me uljen dhe njëkohësisht shtypjen në shtresë (në terren). Kur e kemi sjellë shenjën në pozitë paralele me lavjerrësin, duke shikuar nga vendi 1 (fig. 4.2.), zhvendosemi në vendin 2, për afërsisht nën kënd prej 90° në raport me vendin 1. Në pozicionin 2 në mënyrë të njëjtë sillet shenja që të jetë paralele me lavjerrësin. Me atë shenja është sjellë në pozicionin vertikal.




Fig. 4.2. Sjellja e shenjës në pozicionin vertikal.

B) Me vendosjen e shenjës në trekëmbësh metalik

Në shtresë të vogël shenja vendoset në trekëmbësh dhe sillet në pozicion vertikal në mënyrë të njëjtë si në rasti A. Nëse shenja nuk është paralele me lavjerrësin, e njëjta vendoset me zgjerim ose ngushtim të këmbëve nga trekëmbëshi deri kur t'i sjellim në pozicion paralel: lavjerrësin dhe shenjën. Në vendet e banuara në vend të lavjerrësit, si mjet ndi-

hmës për tërheqjen e vertikales, mund të shfrytëzohen tehet e ndërtesave të larta.

4.1.3. Shiriti i fushës dhe shiriti i dorës

Gjatësitë maten me ndihmën e *shiritit të fushës* dhe *shiritit të dorës*.

Shiriti i fushës (fig. 4.3) përpunohet nga çeliku dhe shpesh herë është me gjatësi prej 20, 25, 30 dhe 50 m, gjerësi 2-2, 5 cm, trashësi 0, 2-0, 3 mm. Skajet e shiritit përfundojnë me unaza të metalta të cilat shërbejnë për shtrëngimin e shiritit gjatë punës. Gjatë gjatësisë së plotë të tij shiriti është i ndarë në metra dhe decimetra. Ndarjet janë nga të dy anët dhe mund të jenë në kahje të njëjtë ose në dy kahje. Vijëza fillestare (zeroja) dhe e fundit të ndarjes janë të shënuara në fillim dhe në fund të shiritit prej çeliku.



Fig. 4.3. *Shiriti i fushës*.

Për shkak të mbrojtjes, shiriti i fushës pas fundit të matjes çdoherë pastrohet nga papastërtia, pastaj lyhet me vaj dhe mbështillet në kornizë (makare) metalike.

Për matjen e gjatësive më të shkurta, shiriti i fushës është jo praktik, prandaj gjatësitë e shkurta maten me shiritat dore.

Gjatësia e shiritit të dorës shpesh herë është 20, 30 dhe 50 m, kurse gjerësia është 1 cm (fig. 4.4). Ky shirit është i ndarë në metra, decimetra dhe centimetra. Me vlera numerike të shiritit janë të nënvizuara metrat dhe decimetrat, kurse në të parin decimetër edhe centimetrat. Centimetrat e të parit decimetër mund të jenë të ndara edhe në milimetra. Ndarja e shiritit të dorës mund të jetë e nënvizuar nga njëra ose nga të dy anët, por edhe të dy ndarjet janë në të njëjtin drejtim. Në mirëmbajtjen

e shiritit të dorës duhet kushtuar më shumë kujdes, sepse lehtë mund të dëmtohet.




Fig. 4.4. *Shiriti i dorës.*

Në procesin e matjes nëse gjatësia është më me gjatë se një metër, në fundin e shiritit të mëparshëm lidhet shiriti i tjetër dhe kështu me radhë. Prandaj është e nevojshme që të shënohen skajet e shiritit. Për etiketimin e fundit të shiritit shfrytëzohen numërorët (fig. 4.5.). Ata janë të përpunuar nga thupra hekuri me gjatësi prej 30 cm dhe diametër prej 4-6 mm. Numërorët në njërin skaj janë të mprehtë, kurse në skajin tjetër janë në formë të unazës që të mund të njëjtit të radhiten në hallkë. Një komplet të numërorëve përbëhet prej 10 thumbave dhe 2 hallkave. Thumbat-numërorë e kanë fituar emrin e tyre sipas asaj se shërbejnë për numërimin e gjithë shiritave.




Fig. 4.5. *Numërorët e thumbave dhe hallkat për thumba.*

4.2. VEGLAT PËR MATJEN E KËNDEVE

4.2.1. STATIVI

Instrumenti duhet të jetë mbi pikën e lartësisë nga e cila lehtë mund të bëhen matjet, ashtu që personi i cili i bën matjet (operatori) qëndron në pozitë të drejtë ose në pozitë pak të përkulur. Lartësia e instrumentit arrihet me ndihmën e stativit (fig. 4.6.).




Fig. 4.6. Stativi dhe koka e stativit.

Stativi ka tri këmbë prej druri të cilat përfundojnë me mbështjellës metalik të mprehur me të cilët më lehtë forcohen në terren.

Gjatësia e këmbëve mund të jetë me gjatësi fikse ose gjatësia e ndryshoreve në to gjenden vidat me të cilat mund të vendosen në gjatësinë e duhur.

Stativet me gjatësi fikse të këmbëve kanë gjatësi prej 1,5 deri në 2,0 m, ndërsa stativet me gjatësi të ndryshoreve kanë gjatësi prej 1,0 deri në 3,0 m.

Në skajin e sipërm të këmbët, me ndihmën e vidave të caktuara forcohen për kokën e stativit. Koka e stativit është e përpunuar nga metali me sipërfaqe të sheshtë të sipërme në të cilën vendoset instrumenti.

Në mesin e kokës së stativit, stativi është me hapje të drejtë rrethore me diametër prej 3 deri 5 cm nëpërmjet të cilit kalon vida qendrore, e cila e lidh instrumentin me stativin.

Në pjesën e poshtme nga vida qendrore, gjendet grepi tek i cili vendoset peri i lavjerrësit për qendërzim të instrumentit (sjellja e qendrës së limbës në vertikalen e pikës).

4.2.2. Pullat vizure dhe prizmat

Kur maten drejtimet horizontale dhe largësitë zenite (këndet vertikale) të pikave të cilat bëhet vijëzimi vendosen pulla vizuale të cilat shërbejnë për vijëzim preciz të sinjalit. Pullat vizuale shpesh herë shkojnë në kombinim me prizma të cilat prapë shërbejnë si mjete gjeodezike për matjen e gjatësive.

Gjatë matjes së gjatësive me ndihmën matësve në largësi elektrooptike në largësi të pikës e cila vijëzohet vendoset prizmi i cili shërben që rrezja e cila është emituar nga instrumenti refuzohet nga prizmi dhe kthehet prapë në instrument. Prizmat janë të përbërë nga sisteme komplekse nga pasqyra qelqi dhe prizma të cilat i përthyejnë rrezet të cilat arrijnë deri te prizmat dhe gjatë asaj e ndryshojnë kahjen e lëvizjes duke mbajtur llogari që pas thyerjes karakteristikat fizike të rrezes mbeten të pandryshuara. Ekzistojnë shumë lloje të prizmave, por në fig. 4.7. janë paraqitur vetëm prizmat e prodhuesit Leica Geo-systems.

Prizmat në pikat e synuara vendosen në këmbë me lloj të përcaktuar të përshtatësit të cilët përforcohen në stative ose në lavjerrës të ngurtë të cilat në vete kanë qendërzore e cila shërben për sjelljen e prizmit në pozicion vertikal.




Fig. 4.7. Llojet e pullave vizure dhe prizmat (llojet e Leica-s)

4.3. VEGLAT PËR MATJEN E NDRYSHIMEVE NË LARTËSI

Gjatë nivelizimit, përveç instrumenteve, shfrytëzohet edhe vegla të tjera ndihmëse (hatulla, papuçe, etj.)

4.3.1 Hatullat nivelmane

Në nivelmanin gjeometrik ndryshimet e lartësive përcaktohen në bazë të leximeve të bëra të ndarjes së hatullave gjatë vijëzimit horizontal.

Hatullat nivelmane, të dedikuar për kryerjen e nivelmanit teknik me përcaktim të zmadhuar, nivelomani teknik dhe nivelomani detal, përpunohen nga druri, por më rrallë nga alumini. Gjatësia e hatullës është 3-4 m, me prerje kënddrejtë, me gjerësi prej 8-10 cm. Hatullat mund të përpunohen nga një pjesë, ose me një ose dy mbulesa. Skajet e hatullave janë të lidhura, për shkak të mbrojtjes së hatullës nga dëmtimet. Ndarja e hatullës fillon nga sipërfaqja e rrafshët të lidhjes dhe shkon pandërprerë gjer te maja e hatullës. Centimetrat e ndarjes janë të shënuara me ngjyrë kuq-bardhë ose bardhë-zi. Çdo centimetër është shënuar me numra (fig. 4.8 dhe 4.9).

Ndarja e hatullës lexohet me ndihmën e vijëzës të mesme dhe ashtu lexohen decimetrat, numërohen centimetrat, ndërsa në brendësinë e

centimetrit nga syri përcaktohen milimetrat. Ngase gjatë nivelimit mbahen çifte të hatullave, kryesore është që të merren hatulla me ndarje e cila është e bërë në mënyrë të njëjtë dhe me ngjyrë të njëjtë. Me atë do të arrihet efekt më i madh gjatë nivelimit dhe do të zvogëlohet mundësia për paraqitjen e gabimeve gjatë leximit të ndarjes së hatullës.

$$\lim_{n \rightarrow \infty} L = \lim_{n \rightarrow \infty} \frac{[l]}{n} = \lim_{n \rightarrow \infty} \left(A - \frac{[\varepsilon]}{n} \right) = A - \lim_{n \rightarrow \infty} \frac{[\varepsilon]}{n} = A. \quad (5.50.)$$

Vërejtje: Shprehja (5.46) mund të transformohet në formë më e përshtatshme për llogaritje më praktike. Vlera më e vogël nga një grup i matjeve përvetësohet për vlerën e përafërt l_0 .

Tash është:

$$L_0 = l_{i_{\min}}, \quad (5.51.)$$

$$l_1 = L_0 + \Delta l_1, \quad (5.52.)$$

$$l_2 = L_0 + \Delta l_2, \quad (5.52.)$$

... ..

$$l_n = L_0 + \Delta l_n.$$

Kur shprehja (5.52) do të futet në (5.46), fitohet:

$$L = \frac{L_0 + \Delta l_1 + L_0 + \Delta l_2 + \dots + L_0 + \Delta l_n}{n}, \quad (5.53.)$$

Ose, nga ana tjetër, pas rregullimit të shprehjes fitohet:

$$L = \frac{n \cdot L_0 + (\Delta l_1 + \Delta l_2 + \dots + \Delta l_n)}{n},$$

respektivisht:

$$L = L_0 + \frac{[\Delta l]}{n}, \quad (5.54.)$$

gjatë të cilës:

$$[\Delta l] = \Delta l_1 + \Delta l_2 + \dots + \Delta l_n.$$

5.6.2.1.1. Cilësia e mesit të thjeshtë aritmetik

Shuma e lëshimeve (ndreqjeve) të rezultateve të matjeve nga mesi i thjeshtë aritmetik është i barabartë me zero:

$$[v] = 0. \quad (5.55.)$$

Përdëftim: Kur të mblidhen ndreqjet:

$$\begin{aligned} v_1 &= L - l_1, \\ v_2 &= L - l_2, \\ &\dots \quad \dots \\ v_n &= L - l_n, \end{aligned}$$

do të fitohet

$$[v] = n \cdot L - [l]. \quad (5.56.)$$

Kur të shtohet shprehja (5.46), do të fitohet:

$$[v] = n \cdot \frac{[l]}{u} - [l] = 0.$$

Me atë përdëftimi është kryer.

Kjo cilësi e mesit të thjeshtë aritmetik shfrytëzohet për kontroll të llogaritjes së vlerës së mundshme sipas mesit të thjeshtë aritmetik. Nëse është $[\Delta l]$ ndahet me n pa mbetje, atëherë shuma ($[v]$) do të jetë zero. Në të kundërtën, mund të paraqitet ndonjë numër i cili është i afërt me zero $[v] = 0$.

Shuma e ndreqjeve v mund të përjashtohet nga zero më së shumti për $n/2$, ku n është numri për matjet e kryera. Për shembull, nëse mesit aritmetik bëhen prej 8 të dhëna në tri vende decimale, atëherë shumata:

$$[v] \leq 0.004.$$

Domethënë:

$$[v] \leq \frac{n}{2} \cdot 10^{-r}$$

ku r është numri i vendeve decimale.

A) Gabim mesatar i mesit të thjeshtë aritmetik

Mesi aritmetik është funksion i madhësive të matura me formë:

$$L = \frac{[l]}{n} = \frac{1}{n} \cdot l_1 + \frac{1}{n} \cdot l_2 + \dots + \frac{1}{n} \cdot l_n,$$

ku është $a_i = 1/n$.

Sipas kësaj, duke pasur parasysh barazimin (5.43), gabimi i mesëm aritmetik do të jetë:

$$m_L^2 = \frac{1}{n^2} \cdot m_1^2 + \frac{1}{n} \cdot m_2^2 + \dots + \frac{1}{n} \cdot m_n^2.$$

Ngase matjet janë realizuar me saktësi të njëjtë, ajo është:

$$m_1 = m_2 = \dots = m_n = m,$$

prandaj është:

$$m_L^2 = n \cdot \frac{1}{n^2} \cdot m^2 = \frac{m^2}{n},$$

respektivisht:

$$m_L = \frac{m}{\sqrt{n}}. \quad (5.58.)$$

Që të llogaritet gabimi mesatar i mesit të thjeshtë aritmetik duhet të dihet gabimi i mesëm të matjes së veçantë m .

Nga kjo formulë shihet se gabimi i mesëm m_L do të jetë më i vogël, kurse n do të jetë më i madh. Gabimi i mesëm zvogëlohet me rrënjë katrore nga numri i matjeve n , edhe atë në fillim ($n < 5$) përnjëherë, e pastaj më ngadalë, madje edhe kur $n = \infty$ do ta arrijë vlerën zero $m_L = 0$. Kjo njohuri paralajmëron se nuk ka kuptim të bëhen numër i madh i matjeve, sepse me atë investohet përpjekje e madhe, kurse në saktësi fitohet shumë pak. Më lehtë është të rritet saktësia e madhësive të matura me zgjedhje të instrumenteve më precize, me zgjedhje me metodë më të përkryer të punës dhe me sigurimin e kushteve të volitshme të punës, sesa të bëhen numër i madh i matjeve, respektivisht jo rritje e n , por zvogëlim i m . Numri i matjeve duhet të jetë në kufizime të arsyeshme. Me analizë të vetëdijshme mund të përcaktohet n . Në praktikë, një numër më i madh i matjeve paraqiten vetëm në matjen e këndeve në rrjetat trigonometrike nga radha e parë, ku këndet maten në 12 gyruse ($n = 12$)

B) Gabim i mesëm i matjes së veçantë

Le të jetë madhësia e kërkuar e matur me n herë, vlera e vërtetë e së cilës është A , ndërsa ajo e mundshmja L . Do t'i shënojmë shprehjet për gabimet e vërteta:

$$\begin{aligned} \varepsilon_1 &= l_1 - A, & (5.59.) \\ \varepsilon_2 &= l_2 - A, \\ & \dots \dots \\ \varepsilon_n &= l_n - A, \end{aligned}$$

dhe përmirësimet e mundshme:

$$v_1 = L - l_1, \quad (5.60.)$$

$$\begin{aligned} v_2 &= L - l_2, \\ &\dots \dots \\ v_n &= L - l_n. \end{aligned}$$

Kur do të mblidhen barazimet (5.59) dhe (5.60) fitohet:

$$\begin{aligned} \varepsilon_1 + v_1 &= L - A \\ \varepsilon_2 + v_2 &= L - A, \\ &\dots \dots \dots \\ \varepsilon_n + v_n &= L - A, \end{aligned} \tag{5.61.}$$

respektivisht:

$$\begin{aligned} \varepsilon_1 &= L - A - v_1, \\ \varepsilon_2 &= L - A - v_2, \\ &\dots \dots \dots \\ \varepsilon_n &= L - A - v_n. \end{aligned}$$

Kur këto barazime bëhen katrorë, fitohet:

$$\begin{aligned} \varepsilon_1^2 &= (L - A)^2 - 2 \cdot v_1 \cdot (L - A) + v_1^2, \\ \varepsilon_2^2 &= (L - A)^2 - 2 \cdot v_2 \cdot (L - A) + v_2^2, \\ &\dots \dots \dots \dots \dots \dots \dots \\ \varepsilon_n^2 &= (L - A)^2 - 2 \cdot v_n \cdot (L - A) + v_n^2, \end{aligned} \tag{5.63.}$$

dhe do të mblidhen, do të fitohet:

$$[\varepsilon^2] = n \cdot (L - A)^2 - 2 \cdot [v] \cdot (L - A) + [v^2]. \tag{5.64.}$$

Ngase $[v] = 0$, barazimi (5.64) e fiton formën që vijon:

$$[\varepsilon^2] = n \cdot (L - A)^2 + v^2,$$

respektivisht:

$$(L - A)^2 = \frac{[\varepsilon^2]}{n} - \frac{[v^2]}{n} \tag{5.65.}$$

ose:

$$(L - A)^2 = m^2 - \frac{[v^2]}{n}. \quad (5.66.)$$

Kur të merret parasysh barazimi (5.8), ndryshimi (A-L) paraqet gabim të vërtetë të mesit aritmetik:

$$\varepsilon_L = L - A.$$

Kur e kemi parasysh se ekziston vetëm një vlerë për gabimin e vërtetë të mesit aritmetik, nga barazimi (5.8.) fitohet:

$$m_L^2 = \varepsilon_L^2 = (L - A)^2, \quad (5.67.)$$

ose kur të merret parasysh (5.68) fitohet:

$$m_L^2 = (L - A)^2 = \frac{m^2}{n}. \quad (5.68.)$$

Kur shprehjet (5.8) dhe (5.68.) futen në shprehjen (5.65) fitohet:

$$\frac{m^2}{n} = m^2 - \frac{[v^2]}{n}$$

respektivisht:

$$n \cdot m^2 - m^2 = [v^2],$$

ose:

$$m^2 \cdot (n - 1) = [v^2],$$

$$m^2 = \frac{[v^2]}{n - 1}, \quad (5.69.)$$

dhe përfundimisht shprehja duket kështu:

$$m = \sqrt{\frac{[v^2]}{n - 1}}.$$

Vërejtje:

1. Nëse të gjithat matjet janë të ngarkuara me gabim konstant sistematik C , me këtë gabim do të jetë e ngarkuar edhe vlera më e mundshme L .

2. Përmirësimet nuk e përmbajnë gabimin konstant sistematik c , prandaj sipas kësaj edhe gabimi i mesëm m , (5.69), i cili është përcaktuar nga përmirësimet, nuk e përmban atë gabim.

Për shkak se gabimi i mesme përcaktohen nga një numër i vogël i matjeve, ato kanë gabime të veta:

- gabimi i mesëm i gabimit mesatar të matjeve është:

$$m = \frac{m}{\sqrt{2 \cdot (n-1)}};$$

- gabimi i mesëm i gabimit mesatar të mesit aritmetik është:

$$m_{m_L} = \frac{m_L}{\sqrt{2 \cdot (n-1)}},$$

ose, sipas barazimit (5.58), fitohet:

$$m_{m_L} = \frac{m}{\sqrt{2 \cdot (n-1) \cdot n}}.$$

Shembulli 5.6: Këndi a është i matur në 10 gyruse. Rezultatet nga matjet janë treguar në tabelën 5.2.

Tabela 5.2.

Numri rendor i matjes (gyrusit)	Vlera e këndit α o / "	$\Delta\alpha_i = \alpha_i - \alpha_o$ "	$v = \alpha' - \alpha_i$ "	v_i^2 "
1	58 13 44	+ 14	- 7	49
2	30	0	+ 7	49
3	35	+ 5	+ 2	4
4	38	+ 8	- 1	1
5	40	+ 10	- 3	9
6	37	+ 7	0	0
7	36	+ 6	+ 1	1
8	44	+ 14	- 7	49
9	37	+ 7	0	0
10	32	+ 2	+ 5	25
	$\alpha_o = 58 13 30$	+ 73	- 3	187

$$\frac{[\Delta x]}{n} = \frac{73}{10} = +7'' \quad \alpha' = \alpha_o + \frac{[\Delta \alpha]}{n} = 58^\circ 13' 37''$$

Gabimi mesatar i katrorit të matjeve të veçanta është:

$$m = \sqrt{\frac{[v^2]}{n-1}} = \pm \sqrt{\frac{187''}{9}} = 4''.6.$$

Gabimi mesatar i katrorit të mesit të thjeshtë aritmetik është:

$$m_L = \frac{m}{\sqrt{n}} = \frac{4''.6}{\sqrt{10}} = 1''.5$$

Shembulli 5.7: Gabimi i mesëm i vlerës së mundshme të këndit i cili është i matur në 8 gyruse është $m_a = 1''.6$. Të llogaritet gabimi i mesëm i këndit të matur në një gyrus.

Zgjidhje:

Nga thyesa (5.58) rrjedh se është:

$$m = m_L \cdot \sqrt{n} = 1''.6 \cdot \sqrt{8} = 4''.5.$$

Shembulli 5.8: Le të jetë një gjatësi e matur me shirit të çelikut 5 herë me saktësi të njëjtë. Rezultatet nga matjet janë treguar në tabelën

5.3. Të llogaritet vlera e mundshme e gjatësisë, gabimi i mesëm në matje të veçantë, si dhe gabimi i mesëm në vlerë të mundshme.

Tabela 5.3.

Numri rendor i matjes	Vlera e gjatësisë l [m]	$\Delta l_i = l_i - l_o$ [cm]	$v_i = L - l_i$ [cm]	v_i^2 [cm]
1	255.55	+ 6	+ 2	4
2	255.49	0	+ 8	64
3	255.61	+ 12	- 4	16
4	255.58	+ 9	- 1	1
5	255.60	+ 11	- 3	9
	$l_o = 255.49$	+ 38	+ 2	94

$$\frac{[\Delta l]}{n} = \frac{38}{5} = +8cm \quad L = L_o + \frac{[\Delta l]}{n} = 255.57m$$

i mesatar i katrorit të matjes së veçantë është:

$$m = \sqrt{\frac{[v^2]}{n-1}} = \pm \sqrt{\frac{94}{4}} = 5cm = 0.05m .$$

Gabimi mesatar i katrorit të mesit të thjeshtë aritmetik është:

$$m_L = \frac{m}{\sqrt{n}} = \frac{0.05}{\sqrt{5}} = 0.02m .$$

5.6.3. Barazimi i rezultateve nga matjet direkte me saktësi të ndryshme

Kur matjet nuk janë të bëra me saktësi të njëjtë, për vlerë të mundshme nuk mund të pranohet mes i thjeshtë aritmetik. Matjet me saktësi të ndryshme duhet të kenë ndikim të ndryshëm të përcaktimit të vlerave të mundshme të madhësisë së matur. Matja më e saktë më shumë duhet të ndikojë në rezultatin përfundimtar ose e kundërta. Kjo praktikisht do-methënë: nëse matjet janë më të sakta, atëherë kanë peshë më të madhe, prandaj sipas kësaj edhe ndikim më të madh në përcaktimin e vlerave të mundshme. Në atë rast vlera e mundshme nuk përcaktohet sipas parimit

të mesit të thjeshtë aritmetik, por shfrytëzohet mes i përgjithshëm aritmetik.

A) Peshat

Marrim një varg të matjeve L_1, l_2, \dots, l_r vlerat e të cilave janë të përcaktuara me saktësi të ndryshme, përkatësisht me gabime të ndryshme të mesme katrore:

$$m_1 \neq m_2 \neq \dots \neq m_r.$$

Të supozojmë se vlerat L_1, l_2, \dots, l_r janë të përcaktuara nga parimi i mesit të thjeshtë aritmetik nga matjet me saktësi të njëjtë:

$$L_1 = \frac{[l]_1}{n_1}, \quad L_2 = \frac{[l]_2}{n_2}, \quad \dots \quad L_r = \frac{[l]_r}{n_r}.$$

Sipas formulës (5.58), gabimet e mesme të këtyre madhësive do të jenë:

$$m_1 = \frac{m}{\sqrt{n_1}}, \quad m_2 = \frac{m}{\sqrt{n_2}}, \quad \dots, \quad m_r = \frac{m}{\sqrt{n_r}}. \quad (5.70.)$$

Nëse $n_1 > n_2$ atëherë $m_1 > m_2$. Kjo praktikisht vlen se është saktësia më e madhe nga madhësia L_1 sesa në L_2 . Ngase ka saktësi më të madhe, madhësia L_1 meriton besim më të madh, përkatësisht ka peshë më të madhe. Në këtë rast konkret numrat n_1, n_2, \dots, n_r kanë ndikim në peshë:

$$p_1, p_2, \dots, p_r. \quad (5.71.)$$

Kur kjo merret parasysh, thyesat (5.70.) mund të shkruhen:

$$m_1 = \frac{m}{\sqrt{p_1}}, \quad m_2 = \frac{m}{\sqrt{p_2}}, \quad \dots, \quad m_r = \frac{m}{\sqrt{p_r}}. \quad (5.72.)$$

Në këto shprehje paraqitet m e njëjtë, e cila është vlerë konstante:

$$p_1 m_1^2 = p_2 m_2^2 = \dots = p_r m_r^2 = k = m^2 = \text{const} \quad (5.73.)$$

prandaj peshat mund të definohen si koeficient nga konstanta k dhe katrori nga gabimi mesatar i katrorit të asaj madhësie në të cilën i përket pesha:

$$p_i = \frac{k}{m_i^2}. \quad (5.74.)$$

Nëse me m_0 është shënuar gabimi i mesëm i njësisë së peshës, domethënë gabim i mesëm që i përket matjes reale ose fiktive, pesha e së cilës është $p_i = 1$, atëherë është:

$$1 = \frac{k}{m_0^2},$$

përkatesisht $k = m_0^2$. Kur kjo merret parasysh, peshat mund të definohen në mënyrën e ardhshme:

$$p_i = \frac{m_0^2}{m_i^2},$$

përkatesisht:

$$m_i = \frac{m_0}{\sqrt{p_i}}. \quad (5.75.)$$

Kur bëhet vlerësimi i saktësisë së matjeve me saktësi të ndryshme, gabimi mesatar i katrorit të njësisë peshë m_0 është masë e përbashkët e vlerësimit të saktësisë së atyre matjeve. Prandaj, çdoherë së pari përcaktohet ajo, kurse pastaj mbi bazë të shprehjes (5.75) edhe gabimet e mesme të matjeve të veçanta. Gabimi i mesëm i njësisë peshë m_0 i përket matjes reale ose fiktive, pesha e së cilës është e barabartë me $p_0 = 1$.

Për përcaktimin e peshës më së miri është të shfrytëzohet formula (5.74.). Nëse kërkohet pesha e ndonjë madhësie, është e mjaftueshme të njihet vetëm gabimi mesatar i katrorit m_i , kurse për konstantën k mund të zgjidhet një vlerë arbitrare. Më shpesh ato janë numrat pozitivë 1, 10, 100 etj. ose ndonjë vlerë krejtësisht tjetër e cila mund të përvetësojë krejtësisht në mënyrë arbitrare. Nga arsye praktike, më së miri është për

konstantën k të përvetësohet asi vlerë që peshat do të jenë afërsisht e barabarta me njësinë ($p_i \approx 1$). Nga shprehja (5.75.) rrjedh:

$$m_1 \cdot \sqrt{p_1} = m_2 \cdot \sqrt{p_2} = \dots = m_n \cdot \sqrt{p_n} = m_0.$$

B) Mes i përgjithshëm aritmetik

Le të jetë një madhësi e matur n herë me saktësi të ndryshme, përkatësisht me pesha të ndryshme:

$$l_1, l_2, \dots, l_n,$$

$$p_1, p_2, \dots, p_n.$$

Vlera më e mundshme përcaktohet me parimin e mesit të përgjithshëm aritmetik:

$$L = \frac{l_1 \cdot p_1 + l_2 \cdot p_2 + \dots + l_n \cdot p_n}{p_1 + p_2 + \dots + p_n} = \frac{[lp]}{[p]}. \quad (5.76.)$$

Përdëftim:

$$p_1 \cdot v_1^2 = p_1 \cdot L^2 - 2 \cdot L \cdot p_1 \cdot l_1 + p_1 \cdot l_1^2,$$

$$p_2 \cdot v_2^2 = p_2 \cdot L^2 - 2 \cdot L \cdot p_2 \cdot l_2 + p_2 \cdot l_2^2,$$

$$\dots \quad \dots \quad \dots \quad \dots \quad \dots$$

$$p_n \cdot v_n^2 = p_n \cdot L^2 - 2 \cdot L \cdot p_n \cdot l_n + p_n \cdot l_n^2,$$

$$[pv^2] = [p] \cdot L^2 - 2 \cdot L \cdot [pl] + [pl^2].$$

Nga kushti $[pv^2] = \min$, rrjedh:

$$[pv^2] = 2 \cdot L \cdot [p] - 2 \cdot [pl] = 0.$$

Gjatë të cilës del se:

$$L = \frac{[pl]}{[p]}.$$

Me atë përdëftimi është i kryer.

Duhet të përmendet se mesi i thjeshtë aritmetik është rast special i mesit të përgjithshëm aritmetik. Kur matjet janë me saktësi të njëjtë, atëherë peshat ndërmjet veti janë të barabarta: $p_1 = p_2 = \dots = p_n = 1$. Duke e marrë parasysh këtë, direkt nga shprehja (5.76.) fitohet mesi i thjeshtë aritmetik:

$$L = \frac{[l]}{n}.$$

Vërejtje: Ngjashëm si te mesi i thjeshtë aritmetik shprehja (5.76.) mund të zbritet në formë më të përshtatshme për llogaritje më praktike.

Nga vargu i rezultateve të matjeve l_1, l_2, \dots, l_n , përvetësohet vlera më e vogël për vlerën më të përafërt e cila nuk patjetër duhet të jetë në mënyrë të drejtë:

$$L_o = l_i \text{ min.} \quad (5.77.)$$

Rrjedh:

$$\begin{aligned} l_1 &= L_o + \Delta l_1, \\ l_2 &= L_o + \Delta l_2, \\ &\dots \quad \dots \quad \dots \\ l_n &= L_o + \Delta l_n. \end{aligned} \quad (5.78.)$$

Nëse shprehja (5.78.) futet në (5.76.) do të fitojmë:

$$L = \frac{p_1 \cdot L_o + p_1 \cdot \Delta l_1 + p_2 \cdot L_o + p_2 \cdot \Delta l_2 + \dots + p_n \cdot L_o + p_n \cdot \Delta l_n}{p_1 + p_2 + \dots + p_n},$$

përkatesisht:

$$L = \frac{L_o(p_1 + p_2 + \dots + p_n) + (p_1 \cdot \Delta l_1 + p_2 \cdot \Delta l_2 + \dots + p_n \cdot \Delta l_n)}{p_1 + p_2 + \dots + p_n}.$$

ose:

$$L = L_o + \frac{p_1 \cdot \Delta l_1 + p_2 \cdot \Delta l_2 + \dots + p_n \cdot \Delta l_n}{p_1 + p_2 + \dots + p_n} = L_o + \frac{[p\Delta l]}{[p]}. \quad (5.79.)$$

5.6.3.2. Cilësitë e mesit të përgjithshëm aritmetik

Vetia I. Shuma e prodhimit të peshës dhe shmangieve nga meset (ndreqjet) e përgjithshme aritmetike është i barabartë me zero, domethënë:

$$[pv] = 0. \quad (5.80.)$$

Përdëftim: Ndreqjet:

$$\begin{array}{l} v_1 = L - l_1 \quad | \quad p_1 \\ v_2 = L - l_2 \quad | \quad p_2 \\ \dots \quad \dots \quad \dots \\ v_n = L - l_n \quad | \quad p_n \end{array}$$

do t'i shumëzojmë me peshat përkatëse:

$$\begin{array}{l} p_1 \cdot v_1 = p_1 \cdot L - p_1 \cdot l_1 \\ p_2 \cdot v_2 = p_2 \cdot L - p_2 \cdot l_2 \\ \dots \quad \dots \quad \dots \\ p_n \cdot v_n = p_n \cdot L - p_n \cdot l_n \end{array}$$

dhe pastaj këto thyesa do të mblidhen:

$$[pv] = L \cdot [p] - [pl]. \quad (5.81.)$$

Me zëvendësimin e shprehjes (5.76.) në (5.81) fitohet:

$$[pv] = \frac{[pl]}{[p]} \cdot [p] - [pl] = 0.$$

që duhet të përdëftohet.

Kjo veçori e mesit të përgjithshëm aritmetik shfrytëzohet si kontroll i llogaritjes së mesit të përgjithshëm aritmetik. Nëse $[pl]$ është i pjesëtueshëm me $[p]$ pa mbetje, atëherë shuma $[pv]$ do të jetë e barabartë me zero. Në të kundërtën, mund të paraqitet ndonjë numër i cili përafërsisht është zero:

$$[pv] \approx 0.$$

Shuma $[pv]$ mund të mënjanohet nga zeroja më së shumti për disa vende decimale, ashtu që ajo do të përshtatet me gjysmën e shumës së peshave $[p]/2$. Për shembull nëse $[p] = 14$, kurse llogaritet në 2 vende decimale, atëherë shuma duhet të jetë $[pv] \leq 0.07$.

Domethënë, $[pv] \leq 1/2 \cdot [p] \cdot 10^{-r}$, ku p është numri i vendeve decimale.

Vetia II. Mesi i përgjithshëm aritmetik nuk do ta ndryshojë vlerën, kurse të gjitha peshat shumëzohen me numër të ndryshëm arbitrar nga zero.

Përdëftim: Nëse peshat p_1, p_2, \dots, p_n , shumëzohen me $a \neq 0$ të ashtuquajtura $a \cdot p_1, a \cdot p_2, \dots, a \cdot p_n$ dhe të njëjtat vlera futen në thyesën (5.76.), fitojmë:

$$L = \frac{a \cdot p_1 \cdot l_1 + a \cdot p_2 \cdot l_2 + \dots + a \cdot p_n \cdot l_n}{a \cdot p_1 + a \cdot p_2 + \dots + a \cdot p_n} = \frac{a \cdot [pl]}{a \cdot [p]} = \frac{[pl]}{[p]},$$

që edhe duhej të përdëftohej.

Nga këtu bëhet përfundim i rëndësishëm se nuk është me rëndësi vlera absolute e peshave, por marrëdhënia e tyre relative. Kjo do të thotë se të gjitha peshat çdoherë mund të shumëzohen me konstantë arbitrare pozitive dhe ajo nuk do të ketë asnjë ndikim në rezultatin përfundimtar. Domethënë, vlerat e peshave mund të ndryshohen, por raporti ndërmjet tyre duhet të mbetet i njëjtë:

$$p_1 : p_2 : \dots : p_n = p'_1 : p'_2 : \dots : p'_r,$$

ku është:

$$p'_i = a \cdot p_i \quad (a > 0).$$

C) Gabimi mesatar i mesit të përgjithshëm aritmetik

Mesi i përgjithshëm aritmetik (5.76.) ka formë të funksionit (5.41.):

$$L = \frac{p_1}{[p]} \cdot l_1 + \frac{p_2}{[p]} \cdot l_2 + \dots + \frac{p_n}{[p]} \cdot l_n,$$

ku janë:

$$a_1 = \frac{p_1}{[p]}, a_2 = \frac{p_2}{[p]}, \dots, a_n = \frac{p_n}{[p]},$$

konstante, kurse l_1, l_2, \dots, l_n janë madhësi të ndryshueshme. Sipas barazimit (5.43) fitohet gabim mesatar i mesit të përgjithshëm aritmetik:

$$m_L^2 = \frac{p_1^2}{[p]^2} \cdot m_1^2 + \frac{p_2^2}{[p]^2} \cdot m_2^2 + \dots + \frac{p_n^2}{[p]^2} \cdot m_n^2. \quad (5.82.)$$

Me zëvendësim të shprehjes (5.75.) në (5.82.) fitohet:

$$m_L^2 = \frac{p_1^2}{[p]} \frac{m_o^2}{p_1} + \frac{p_2^2}{[p]} \frac{m_o^2}{p_2} + \dots + \frac{p_n^2}{[p]} \frac{m_o^2}{p_n},$$

përkatësisht:

$$m_L^2 = \frac{p_1}{[p]^2} \cdot m_o^2 + \frac{p_2}{[p]^2} \cdot m_o^2 + \dots + \frac{p_n}{[p]^2} \cdot m_o^2, \quad (5.83.)$$

ose:

$$m_L^2 = \frac{m_o^2}{[p]^2} \cdot (p_1 + p_2 + \dots + p_n) = \frac{m_o^2}{[p]^2} \cdot [p] = \frac{m_o^2}{[p]},$$

domethënë:

$$m_L^2 = \frac{m_o}{\sqrt{[p]}}. \quad (5.84.)$$

Domethënë, gabimi mesatar i mesit të përgjithshëm aritmetik është i barabartë me herësin e gabimit të mesëm katror në njësi peshë dhe rrënjë katrore nga shumta e peshave.

Kur thyesa (5.75.) do të krahasohet me (5.84.), rrjedh se pesha e mesit të përgjithshëm aritmetik:

$$P_L = [p].$$

Pesha e mesit të thjeshtë aritmetik ($p_1 = p_2 = \dots = p_n = 1$) do të jetë:

$$P_L = n.$$

Kjo drejtpërdrejtë shihet nga formula (5.58.).

D) Gabim i mesëm i matjes së veçantë

Gabimi i mesëm i matjes së veçantë llogaritet sipas formulës (5.75), domethënë:

$$m_1 = \frac{m_o}{\sqrt{p_1}}.$$

Gabimi i mesëm i ndonjë matjeje është i barabartë me herësin nga gabimi i mesëm të njësisë peshë dhe rrënja katrore nga pesha e asaj matjeje.

E) Gabimi i mesëm i njësisë peshë

Do t'i shumëzojmë thyesat (5.63) me peshat e përshtatshme:

$$\begin{aligned} p_1 \cdot \varepsilon_1^2 &= p_1 \cdot (L - A)^2 + p_1 \cdot v_1^2 - 2 \cdot p_1 \cdot (L - A) \cdot v_1, \\ p_2 \cdot \varepsilon_2^2 &= p_2 \cdot (L - A)^2 + p_2 \cdot v_2^2 - 2 \cdot p_2 \cdot (L - A) \cdot v_2, \\ &\dots \dots \dots \dots \dots \dots \dots \dots \dots \\ p_n \cdot \varepsilon_n^2 &= p_n \cdot (L - A)^2 + p_n \cdot v_n^2 - 2 \cdot p_n \cdot (L - A) \cdot v_n, \end{aligned} \tag{5.85.}$$

dhe pastaj do t'i mbledhim këto thyesa:

$$[p\varepsilon^2] = [p] \cdot (L - A)^2 + [pv^2] - 2 \cdot (L - A) \cdot [pv],$$

përkatesisht:

$$[p\varepsilon^2] = [p] \cdot (L - A)^2 + [pv^2], \tag{5.86.}$$

sepse është:

$$[pv] = 0.$$

Më së pari ta futim shprehjen (5.67.) në (5.86.):

$$[p\varepsilon^2] = [p] \cdot m_L^2 + [pv^2], \tag{5.87.}$$

dhe pastaj (5.84.) në (5.87.)

$$[p\varepsilon^2] = [p] \cdot \frac{m_o^2}{[p]} + [pv^2],$$

përkatësisht:

$$[p\varepsilon^2] = m_o^2 + [pv^2]. \quad (5.88.)$$

Gabimi i mesëm i njësisë peshë llogaritet nga gabimet e vërteta mbi bazë të barazimit (5.8.). Kjo formulë shfrytëzohet kur gabimet e vërteta i përkasin matjeve me saktësi të njëjtë.

Nëse matjet janë me saktësi të ndryshme në vend të (5.8.) duhet të përdoret:

$$m_o^2 = \frac{[p\varepsilon^2]}{n}. \quad (5.89.)$$

Kur (5.89.) do të futet në (5.88.), fitohet:

$$n \cdot m_o^2 = m_o^2 + [pv^2],$$

përkatësisht:

$$m_o^2 \cdot (n - 1) = [pv^2],$$

ose:

$$m_o^2 = \frac{[pv^2]}{n - 1},$$

domethënë:

$$m_o = \sqrt{\frac{[pv^2]}{n - 1}}, \quad (5.90.)$$

gjatë të cilës n është numri i matjeve, $(n - 1)$ është numri i matjeve të shumta, ndërsa 1 është numri i matjeve të domosdoshme.

Kur gabimi i mesëm i njësisë peshë m_o është e llogaritur nga numri i vogël i të dhënave, atëherë edhe ajo do të ketë gabimin e vet:

$$m_{m_o} = \frac{m_o}{\sqrt{2 \cdot (n-1)}},$$

si dhe gabimi mesatar i mesit të përgjithshëm aritmetik:

$$m_{m_L} = \frac{m_L}{\sqrt{2 \cdot (n-1)}}.$$

Gabimi i mesëm i njësisë peshë m_o gjithmonë i përket ndonjë madhësie e cila në mënyrë arbitrare mund të zgjidhet, e rëndësishme është që ajo madhësi të ketë peshë e cila është e barabartë me njësinë. Sigurisht, më së miri është t'i takojë ndonjë madhësie reale. Për shembull, nëse kjo shfrytëzohet për ndonjë madhësi lineare, më së miri është t'i takojë një vlerë të gjatësisë prej 1 km etj. Atëherë, gabimi i mesëm i njësisë peshë, në thelb do t'i përgjigjeshe gabimit të mesëm të njësisë gjatësi (1 km, 1m etj.).

Shembulli 5.9: Këndi a është matur tri herë me saktësi të ndryshme, kurse rezultatet e matjeve janë treguar në tabelën 5.4.

Të njehsohet vlera e gjasës së këndit a , gabimi i mesëm të njësisë peshë, si dhe gabimi i mesëm i vlerës së gjasës.

Tabela 5.4.

Nr. rendor	Matja α_i			Pesha a p_i	$\Delta\alpha_i$ "	$p_i \cdot \Delta\alpha_i$ "	v_i "	$p_i \cdot v_i$ "	$p_i \cdot v_i^2$ "
1	56	17	18	2	0	0	+3	+6	18
2			28	1	+10	+10	-7	-7	49
3			21	2	+3	+6	0	0	0
$\alpha_o =$	56	17	18	5		+16		-1	67

$$\Delta\alpha_i = \alpha_i - \alpha_o, \quad v_i = \alpha' - \alpha_i$$

$$\frac{[p\Delta\alpha]}{[p]} = \frac{+16}{5} = +3''$$

$$\alpha' = \alpha_o + \frac{[p\Delta\alpha]}{[p]} = 56^\circ 17' 21''$$

Gabimi mesatar i katrorit të njësisë peshë është:

$$m_o = \sqrt{\frac{[pv^2]}{n-1}} = \sqrt{\frac{67}{2}} = 5''.8.$$

Gabimi mesatar i katrorit të vlerës së mundshme:

$$m_\alpha = \frac{m_o}{\sqrt{[p]}} = \frac{5''.8}{\sqrt{5}} = 2''.6.$$

Shembull 5.10: Le të jetë një gjatësi e matur tri herë me saktësi të ndryshme. Rezultatet nga matjet janë të dhëna në tabelë 5.5. Të përcaktohet vlera e mundshme e gjatësisë së matur dhe gabimi mesatar i katrorit të saj.

Tabela 5.5.

Nr. rendor	Matja l_i m	Pesha p_i	Δl_i cm	$p_i \cdot \Delta l_i$ cm	v_i cm	$p_i \cdot v_i$ cm	$p_i \cdot v_i^2$ cm
1	276.88	1.25	+ 6	7.50	0	0	0
2	276.93	1.00	+ 11	11.00	- 5	- 5	25.00
3	276.82	0.80	0	0	+ 6	4.80	28.80
$L_o =$	276.82	3.05		18.50		- 0.20	53.80

$$\Delta l_i = l_i - L_o, \quad v_i = L - l_i$$

$$\frac{[p\Delta l]}{[p]} = \frac{18.50}{3.05} = +6 \text{ cm} \quad L = L_o + \frac{[p\Delta l]}{[p]} = 276.88 \text{ m}$$

Gabimi mesatar i katrorit të njësisë peshë është:

$$m_o = \sqrt{\frac{[pv^2]}{n-1}} = \sqrt{\frac{53.80}{2}} = 5.2 \text{ cm} = 0.05 \text{ m}.$$

Gabimi mesatar i katrorit të vlerës së mundshme është:

$$m_L = \frac{m_o}{\sqrt{[p]}} = \frac{5.2}{\sqrt{3.05}} = 3 \text{ cm} = 0.03 \text{ m}.$$

Shembull 5.11: Lartësia mbidetare e reperit është e përcaktuar nga tre matjet të cilat ndërmjet veti janë me saktësi të ndryshme. Rezultatet nga matjet janë treguar në tabelën 5.6. Të llogaritet vlera e mundshme e lartësisë mbidetare e reperit.

Tabela 5.6.

Nr. rendor	Lartësia mbidetare H_i m	Pesha p_i	ΔH_i cm	$p_i \cdot \Delta H_i$ cm	v_i cm	$p_i \cdot v_i$ cm	$p_i \cdot v_i^2$ cm
1	110.38	1.1	+ 10	+ 11.0	- 6	- 6.6	39.6
2	110.31	2.0	+ 3	+ 6.0	+ 1	+ 2.0	2.0
3	110.28	1.2	0	0	+ 4	+ 4.8	19.2
$H_o =$	110.28	4.3				+ 0.2	60.8

$$\Delta H_i = H_i - H_o, \quad v_i = H - H_i$$

$$\frac{[p\Delta H]}{[p]} = \frac{17.0}{4.3} = +4 \text{ cm} \quad H = H_o + \frac{[p\Delta H]}{[p]} = 110.32 \text{ m}$$

Gabimi mesatar i katrorit të njësisë peshë është:

$$m_o = \sqrt{\frac{[pv^2]}{n-1}} = \sqrt{\frac{60.8}{2}} = 5.5 \text{ cm} = 0.06 \text{ m}.$$

Gabimi i mesëm i vlerës së mundshme është:

$$m_L = \frac{m_o}{\sqrt{[p]}} = \frac{5.5}{\sqrt{4.3}} = 2.7 \text{ cm} = 0.03 \text{ m}.$$

Kur aplikohet mesi i përgjithshëm aritmetik, duhet të përcaktohen peshat p_i .

Peshat për ndryshimet në lartësi përcaktohen sipas formulës:

- për nivelmanin gjeometrik

$$p_i = \frac{1}{s_i};$$

- për nivelmanin trigonometrik

$$p_i = \frac{1}{s_i^2} \text{ - kur ana është e matur në mënyrë dy anësore}$$

$$p_i = \frac{1}{2 \cdot s_i^2} \text{ - kur ana është e matur në mënyrë njëanësore}$$

ku s është gjatësia e matur.

Gjatësitë s duhet të jenë të shprehura në aso njësisë, vlera e peshave të të cilave të jenë sa më afër njësisë.

6. MATJET E GJATËSIVE

6.1. MATJET E GJATËSIVE ME SHIRIT

Gjatësitë çdoherë, kur është ajo e mundshme, maten direkt në terren me ndihmën e instrumenteve dhe veglave speciale. Matjet të cilat bëhen gjatë kushteve të jashtme të ndryshme dhe nga procedura e vërtetuar më parë, i quajmë metoda të punës. Nga preciziteti i instrumentit, përshtatshmëria e kushteve të jashtme, metodat e punës dhe përvoja e operatorit, varet saktësia e matjes së gjatësive. Diametri i saktësisë me të cilin maten gjatësitë është mjaft i madh dhe lëviz nga 1mm deri disa decimetra. Kur gjatësitë maten me precizitet të madh, të njëjtat maten me precizitet deri 1mm, kurse gjatë punëve jo të sakta (të ashpra) deri disa decimetra. Për çdo detyrë nga sfera e gjeodezisë prej përpara definohet saktësia e matjes së gjatësive, kurse në varësi nga saktësia e definuar zgjidhen metodat dhe instrumentet për matje, me të cilat do të plotësohet saktësia e definuar.

Gjatësitë përcaktohen drejtpërdrejtë (direkt) në terren ose, tërthorazi (indirekt). Përcaktimi i drejtpërdrejtë i gjatësive bëhet me ndihmën e:

- shiritave të fushës ose të dorës
- shiritave preciz
- telave invarzuese

Gjatësitë përcaktohen tërthorazi me ndihmën e:

- matësit optik në largësi
- matësit elektrooptik në largësi
- matësit në largësi të radios
- sistemit global për pozicionim (GPS)

Pajisja për matje të gjatësive është e thjeshtë dhe me të disponon secila organizatë pune e cila bëhen paramasën e tokës ose mirëmbajtjen e saj.

6.1.1. Profil i gjatësisë në terren

Profil (gjatësor) i gjatësisë së terrenit paraqet prerje të terrenit me rrafsh vertikal që i përmban pikat e tij të fundit. Gjatësia e terrenit mund të jetë me rënie të njëjlojshme ose të ndryshme (fig. 6.1.). Vendi ku ndërrohet rënia e gjatësisë së terrenit quhet pikë e përthyer e gjatësisë. (fig. 6.1b). Vendet e përthyer të terrenit tokësor shënohen me kunjja të drurit ose gozhda të ngulura në terren, kurse në asfalt ose beton shënohen me thupra çeliku. Gjatësia e thuprave është prej 40 deri 60 cm, me gjerësi 6-10 mm. Nëse profili i gjatësisë është me rënie të njëjtë dhe nëse pas asaj pikët e fundit janë në lartësi të njëjtë, themi se gjatësia është horizontale.




Fig. 6.1. Profil i gjatësisë me rënie të njëjlojshme dhe të ndryshme.

Profil i gjatësisë vizatohet me vlerësim të lirë të personit kompetent, domethënë vizatimi bëhet në bazë të vështrimit direkt në terren. Për vizatimin e profilit të gjatësisë, është e domosdoshme të përcaktohet: cila pikë është më e lartë, e cila më e ulët; dhe të caktohen vendet ku terreni ka pika të përthyer në kuptimin e lartësisë. Gjatë vizatimit të profilit duhet të përpiqemi që pamja e gjatësisë së përshtatet sa mund më shumë me profilin e vërtetë të terrenit. Për shkak se ndryshimi i lartësisë së pikave të drejtimit të gjatësisë është shumë më i vogël nga ndryshimi i gjatësisë, gjatë vizatimit zvogëlohet pamja e gjatësisë, përkatësisht më shumë duhet të shprehen ndryshimet e lartësisë sesa që ajo është reale. Pikat përfundimtare të gjatësisë së profilit vizatohen, ashtu që pamja e

shenjave të tyre t'i përgjigjet formës së tyre në natyrë. Pikat përfundimtare të profilin të gjatësisë shënohen me numrat përkatëse të pikave, kurse përthyerjet shënohen me shkronja të vogla të alfabetit. Pozita e shiritit të gjatësisë së matur shënohet me vijë të ndërprerë.

6.1.2. Matje e gjatësive

Nën termin matje të gjatësive nënkuptohet procedura me të cilën fitohet numri i cili përcakton se sa herë njësia themelore e gjatësisë (për shembull 1 m) përmbahet në gjatësinë e matur. Me ndihmën e shiritit të fushës gjatësia mund të matet me saktësi të zmadhuar ose të thjeshtë. Matja e gjatësive me saktësi të zmadhuar bëhet me përgatitje të posaçme në terren dhe sipas procedurës së veçantë. Matja e kësaj lloji është shumë e ngadalshme dhe jo ekonomike, prandaj kjo mënyrë e matjes është më e braktisur, prandaj sot për matje të kësaj lloji shfrytëzohen matës të largësisë elektronik.

Matjen e gjatësive në mënyrë të thjeshtë më tej do ta quajmë matje e gjatësive me shirit. Procedura e matjes është e thjeshtë, por duhet të dallohen rastet kur në drejtim të gjatësisë ka ose nuk ka pika të përthyerja në kuptim të lartësisë. Grupin për matjen e gjatësive duhet ta përbëjnë: një ekspert dhe dy persona ndihmës (figurantë). Pajisja që është e nevojshme për matje përbëhet nga: shiriti i fushës, tri shenja, gozhda - numërues dhe trekëmbësh për mbajtjen e shenjave.

Të gjitha gjatësitë e terrenit të bazamenteve gjeodezike tregohen në projektion horizontal. Që të arrihet deri te projektionet horizontale të gjatësive, të njëjtat mund të maten në dy mënyra. Në mënyrën e parë maten gjatësitë e segmenteve të pjerrëta, prandaj me llogaritje përcaktohen projektionet e tyre horizontale, kurse në mënyrën tjetër menjëherë maten segmentet horizontale.

Mënyra e parë quhet matje në terren ose matje e pjerrtë, mënyra e dytë matje horizontale. Cilat nga këto dy mënyra do të shfrytëzohen varet nga: gjatësia e segmentit, nga situata në terren (nëse terreni është i rrafshët, i rrëpishëm, i prerë etj.), nga lloji i pajisjes me të cilën disponojmë dhe nga saktësia e kërkuar.

A) Matje e gjatësive pa përthyerje

Kur gjatësia nuk ka pika e përthyer, para fillimit të matjes pikat përfundimtare të gjatësive duhet të shënohen me shenja (vertikalisht të pozicionuara). Figuranti i përparmë e mban shenjën për sjelljen e shiritit në drejtim të matjes së gjatësisë, njëren unazë me thumba, dhe e tërheqë skajin e përparmë nga shiriti. Figuranti i pasmë e mbështjell shiritin, e mban kornizën metalike të shiritit dhe unazën e zbraztë për mbledhjen e thumbave-numëror. Kur shiriti është i mbështjellë, figuranti i pasmë e sjell figurantin e përparmë me shirit në drejtim të gjatësisë së matur. Pastaj drejtohet shiriti, ashtu që me gjithë gjatësinë e tij të shtrihet në terren dhe të jetë në drejtim.

Figuranti i pasmë e mban fundin e shiritit pas pikës në distancë nga 3 deri 5 cm dhe zëshëm jep komandë “ngrehe”. Atëherë figuranti i përparmë fillon në mënyrë barabartë të ngrejë shiritin me forcë përafërsisht 9, 8 N (10 kg). Kur skaji i pasmë i shiritit do të vijë në distancë në 1 cm deri te qendra e shenjës, figuranti i pasmë jep komandë të re ”ku-jdes”, kurse kur fundi i skajit të shiritit do të vijë në qendër të shenjës, jep tjetër komandë “shëno”. Në komandën “shëno” figuranti i përparmë ngul thumb-numërues përreth shenjës në fund të shiritit dhe në të njëjtin moment shpall “kryerje”. Atëherë shiriti mund të lëshohet. Nëse matet në terren ku nuk është i mundur duhet të ngulet thumbi-numëruesi, fundi i shiritit shënohet me shkumës me ngjyrë (të bardhë, të kuqe, të kaltër etj.) gjatë të cilës vija duhet të jetë e tërhequr normal në gjatësinë e matur. Përskaaj shiritit tërhiqet edhe një vijë në drejtimin e shiritit, me çka formohet shenja T. Ndërprerja e këtyre dy vijave është vendi ku mbahet fillimi i shiritit të ardhshëm. Përskaaj shiritit T vendohet thumb-numërues.

Pas shënimit të fundit nga shiriti i parë, ajo llogaritet para në drejtim të gjatësisë së matur.

Figuranti i pasmë e mban fillimin e shiritit përkaj thumbi-numërues, me të cilin është shënuar fundi i shiritit të parë dhe i jep shenjë figurantit të përparmë që ta sjellë shiritin në drejtim të gjatësisë, ta shtrëngojë me vëmendje (gjithashtu në shenjë) dhe me numërues ta shënojë fundin e shiriti të dytë. Gjatë zhvendosjes së shiritit, figuranti i pasmë e radhit gozhdën-numëruesin e kornizës (hallkës) që e mban me vete. Procedura e tillë përsëritet deri sa nuk arrihet deri te pjesa e mbetur nga prerja, e cila ka gjatësi më të vogël se gjatësia e një shiriti të plotë. Ajo pjesë e prerjes quhet mbetje e gjatësisë. Vendosja e shiritit bëhet në mënyrë të njëjtë si më parë, vetëm se komanda e thënë “shëno” zëvendësohet me komandën “lexo”. Në vendin e shënimit në fund të shiritit, personi ekspert e lexon mbetjen e gjatësisë. Nëse hapësira e shenjës është në lartësi me terrenin, mbetja e gjatësisë lexohet direkt në qendrën e shenjës. Nëse shenja është në nivelin e terrenit, projektimi i qendrës së shenjës duhet të bëhet me ndihmën e lavjerrësit. Në atë rast përreth perit të lavjerrësit bëhet lexim i fundit të shiritit, matet lartësia e hapësirës së sipërme të shenjës deri te peri dhe shiriti, respektivisht mendohet se sa shiriti është i tërhequr mbi qendrën e shenjës. Ajo lartësi futet në vizatim për profilin e gjatësisë. Gjatësia e përgjithshme e prerjes do të fitohet: kur numri i shiritave të plotë (të shfrytëzuar gjatë matjes) do të shumëzohet me gjatësinë e shiritit (gjatësinë nominale) dhe gjatë saj do të shtohet mbetja e matur.

Për shembull, nëse gjatësia nominale e shiritit është 50,00 m dhe nëse gjatë matjes ajo ishte e shfrytëzuar tri herë me gjatësi të plotë, nëse punëtori i pasmë ka mbledhur tre thumba-numërues dhe nëse mbetja është 22, 45 m, atëherë gjatësia e përgjithshme është: $3 \times 50,00 \text{ m} + 22, 45 = 172, 45 \text{ m}$.

Për kontroll dhe zmadhim të saktësisë, sipas rregullës, secila madhësi matet në dy drejtime. Pas fundit të matjes së parë (matjes përpara), bëhet matje e gjatësisë dhe në drejtim të kundërt (matje prapa), respe-

ktivisht matje e dytë. Si vlerë definitive merret mesi aritmetik nga të dy matjet, deri sa ndryshimi mes tyre nuk e tejkalon kufirin e lejuar.

B) Matje e gjatësive me përthyerje

Kur gjatësia e cila matet nuk ka lakim njëfishor, në atë rast thuhet se terreni ka pika të përthyer në mendim të vërtetë. Vendi i përthyerjes së terrenit në mendimin e vërtetë quhet pikë e përthyer. Para fillimit të matjes së gjatësisë duhet të bëhet shënimi i pikave thyese. Në drejtimin e gjatësisë së matur mund të ketë më shumë pika e përthyer. Pikat e përthyerja në terren tokësor shënohen me kunjja me dimensione 5 x 5 x 20 - 30 cm, kurse në terren të fortë (asfalt, beton etj.) me thumba prej hekuri.

Sinjalizimi i pikave të përthyerja në drejtim të gjatësisë së matur bëhet me ndihmën e shenjave. Në pikat përfundimtare, pikat e përthyerja mund të mënjanohen me ngritjen e shiritit. Gjatësia e shiritit, e cila ngrihet në ajër, nuk duhet të jetë më shumë se 10 m, kurse në fundin e gjatësisë shiriti nuk duhet të ngrihet më shumë se 1 m (fig. 6.2.).




Fig. 6.2. Ngritje e shiritit.

Gjatësia me një ose më shumë pika të përthyerja mund të matet në dy mënyra, edhe atë: nga pika e përthyer në atë jo të përthyer, ose pa ndërprerje (në kontinuitet). Matja e gjatësive nga pika e përthyer deri te pika e përthyer zbatohet në kushte më të vështira në terren ose gjatë kalimit më të madh në terren në profilin gjatësor, e veçmas nëse skajet e shiritit nuk mund të shënohen (, fushëgropa, lumi, vendi i pashkelur etj.).

Secila pjesë e distancës matet veçmas, nga pika fillestare deri te përthyerja a pastaj deri te përthyerja a deri te përthyerja b dhe për shembull, nga përthyerja b deri te pika e fundit. Procedura e njëjtë zbatohet edhe gjatë matjes së gjatësive në drejtim të kundërt, me çka në këtë rast shkohet në të kundërtën (nga pika e fundit e distancës deri te përthyerja b etj.).

Mënyra e dytë e matjes së gjatësive zbatohet në kushte terreni më të mira dhe më pak lakim të pjesëve, ndërmjet pikave të fundit dhe pikave të përthyerja. Procedura gjatë matjes është identike me matjen e gjatësive pa pika të përthyerja. Ndryshimi është në atë që shiriti i cili kalon përreth pikës përthyesë duhet të lexohet distanca midis pikës përthyesë dhe pikës fillestare në drejti të matjes në kontinuitet ose distancë relative.

6.1.3. Procesverbal për matjen e gjatësive

Njëkohësisht me matjen e gjatësive, të dhënat e matjes shënohen në procesverbal adekuat i cili quhet formulat trigonometrik nr. 18 (shtesa nr. 1). Para fillimit të matjes, në vend të posaçëm të procesverbalit (kolonën 8) vizatohet profili gjatësor i gjatësisë, pozita e shiritit gjatë matjes dhe me çka janë shënuar pikat përfundimtare të distancës. E gjithë ana e majtë e procesverbalit shërben për shënimin e të dhënave nga matjet, kurse ana e djathtë nga kolona e 12 shërben për operacione llogaritëse për reduktim të gjatësive të matura në mënyrë të pjerrët në horizont.

Në shtesën 1 është treguar direkt matje e pjerrët e gjatësisë së disa distancave pa përthyerje dhe me përthyerje.

Në këtë shembull do ta shpjegojmë mënyrën dhe procedurën e shënimit të të dhënave.

Në kolonën 1 shënohen numrat dhe shenjat topografike të pikave përfundimtare. Kolonat 2, 3 dhe 4 shërbejnë për shënimin e të dhënave të matjes së parë (matjes përpara) dhe atë në kolonën 2 me vijëza vertikale shënohet sa herë gjatë matjes është e shfrytëzuar e gjithë gjatësia e

shiritit. Në kolonën 3 shënohen leximet e shiritit, ndërsa në kolonën 4 formohen vlerat e apcisës nga pika fillestare e distancës deri te përthyerja e ardhshme, si dhe gjatësia e përgjithshme e distancës. Kolonat 5, 6 dhe 7 shfrytëzohen në mënyrë të njëjtë për shënimin e të dhënave nga matjet në drejtim të kundërt (matje nga prapa). Kolona 8 shërben për vizatim të profilit gjatësor të terrenit. Në kolonën 9 shënohet kategoria e terrenit e cila e përcakton personin adekuat gjeodezik, në kolonën 10 ndryshimi në mes gjatësisë së përgjithshme nga matja e parë dhe e dytë, si dhe të dhënat për largimin e lejuar. Në kolonën 11 formohet mesi aritmetik nga dy matjet nëse ndryshimi është në kufijtë e lejuar. Ndryshimet e lejuara të matjeve të gjatësive para-prapa varen nga kategoria e terrenit dhe gjatësia dhe janë:

$$\text{Kategoria e I: } \Delta_I = \pm 0,0070 \cdot \sqrt{S} + \dots + \dots;$$

$$\text{Kategoria e II: } \Delta_{II} = \pm 0,0090 \cdot \sqrt{S} + \dots + \dots;$$

$$\text{Kategoria e III: } \Delta_{III} = \pm 0,0120 \cdot \sqrt{S} + \dots + \dots.$$

ku S është gjatësia e përgjithshme e shprehur në metra.

Shmangia e lejuar fitohet në metër.

6.1.4. Ndrejtet gjatë matjes së gjatësive

A) Ndrejtja për komparacion

Para çdo përdorimi shiriti duhet të *komparohet*, respektivisht duhet të përcaktohet gjatësia e tij. Shumë shpesh gjatësia e cila është e përcaktuar gjatë komparimit nuk është identike me gjatësinë e saj nominale. Vlerën nominale e shiritit e jep prodhuesi dhe ajo është e përcaktuar në vetë shiritin. Gjatësia nominale e shiritit i përket gjatësisë së shiritit e cila gjendet në temperaturë prej 20°C. Gjatësia e punës së shiritit përcaktohet me komparimin e tij me gjatësi të njohur (komparator). Me ndihmën e komparimit të shiritit fitohet gjatësia e punës së shiritit e cila mund të

jetë më e vogël ose më e madhe nga nominalja. Në procedurën e matjes së gjatësisë duhet të ndreqet për vlerën:

$$\Delta S_k = \frac{l_R - l_N}{l_N} \cdot S \quad (6.1.)$$

ku është:

S - vlera e gjatësisë së matur

l_R - vlera e punës të shiritit

l_N - vlera nominale e shiritit

Gjatësia e riparuar fitohet:

$$S' = S + \Delta S_k \quad (6.2.)$$

Shembull 6.1: Me ndihmën të komparatorit është vërtetuar se gjatësia e shiritit është $l_R = 49,985$ m. Të llogaritet ndreqja për gjatësinë e matur e cila vlerë është 252,76 m.

Ndreqja:

$$\Delta S_k = \frac{49,985 - 50,000}{50,000} \cdot 252,76 = -0,08m.$$

Gjatësia e riparuar:

$$S' = S + \Delta S_k = 252,68m.$$

B) Ndreqjet për reduktim

Tanimë kemi cekur se gjatë matjes së gjatësive me ndihmën e shiritit shpesh herë maten gjatësi të pjerrëta në terren. Për përpunim të mëtejshëm të nevojshme janë distancat horizontale ku duhet të bëhet projeksion të gjatësive të matura të pjerrëta në rrafsh horizontal, apo siç thuhet në gjeodezi: gjatësia e matur pjerrtazi duhet të reduktohet në horizont.

Nga figura 6.8. rrjedh se vlera e gjatësisë së matur do të zvogëlohet për vlerën e reduktimit r

$$S = S' - r \quad (6.3.)$$

ku është:

S - vlera e reduktuar e gjatësisë së matur të pjerrët;

S' - gjatësi e pjerrët e matur

R - reduktimi




Fig. 6.3. Reduktimi i gjatësisë së matur pjerrtazi

Për llogaritjen e reduktimit r , përveç vlerës së gjatësisë së matur në mënyrë të pjerrët duhet të dihet edhe vlera e ndryshimit të lartësisë ΔH ndërmjet pikave përfundimtare të gjatësisë. Ndryshimi i lartësisë ΔH matet në terren me ndihmën e metodave të ndryshme gjeodezike të cilat do të shpjegohen më vonë.

B.1) Formula e saktë për reduktimin e gjatësive

Gjatë pikës A përshkruajmë rreth me rreze S' (fig. 6.4.). Nëse këndin BAB e shënojmë me α si kënd i qendror mbi harkun BC , atëherë këndi BDC është këndi periferik mbi të njëjtin hark BC dhe është $\alpha/2$. Këndi CBD mbi diametrin DC është kënd i drejtë. Këndet CBB' dhe BDC ndërmjet veti janë të barabarta si kënde me brinjë normale. Nga trekëndëshi $BB'C$ vendosim barazimin trigonometrik:

$$\operatorname{tg} \frac{\alpha}{2} = \frac{r}{\Delta H}, \quad (6.4.)$$

respektivisht:

$$r = \Delta H \cdot \operatorname{tg} \frac{\alpha}{2}. \quad (6.5.)$$




Fig. 6.4. Formulë e saktë e reduktimit

Këndi α përcaktohet nga trekëndëshi ABB' :

$$\sin \alpha = \frac{\Delta H}{S'} . \quad (6.6.)$$

Barazia e këndeve CBB' dhe BDC mund të tregohet edhe në tjetër mënyrë. Nga trekëndëshi ΔABC mund të vendoset thyesa:

$$2 \cdot \beta + \alpha = 180^\circ . \quad (6.7.)$$

Me zgjidhjen e barazimit (6.7) fitohet:

$$\beta = 90^\circ - \frac{\alpha}{2} . \quad (6.8.)$$

Nga trekëndëshi kënddrejtë $BB'C$ rrjedh:

$$\beta = 90^\circ - x . \quad (6.9.)$$

Për shkak se brinjët e majta të barazimeve (6.8) dhe (6.9.) janë të njëjta, del se $x = \frac{\alpha}{2}$.

Nëse e dimë ndryshimin e lartësisë ndërmjet pikave përfundimtare për gjatësinë e cila matet, përveç mënyrave të lartpërmendura për llogaritjen e reduktimit në praktikë shpesh herë llogaritet gjatësia horizontale me ndihmën e zbatimit të teoremës së Pitagorës të trekëndëshit $\Delta ABB'$ (fig. 6.3.).

Formula për llogaritjen e gjatësisë horizontale e llogaritur me zbatimin e teoremës së Pitagorës thotë:

$$S = \sqrt{S'^2 - \Delta H^2} . \quad (6.10.)$$

Shembull 6.2: Përcaktoje reduktimin e gjatësisë së matur tërthorazi me ndihmën e teoremës së Pitagorës nëse është matur gjatësia tërthore në terren $S = 234,36$ m dhe ndryshimi i lartësisë ndërmjet pikave përfundimtare $\Delta H = 2,36$ m

Zgjidhje:

$$S' = 234,56m \quad \Delta H = 4,36m$$

$$S = \sqrt{S'^2 - \Delta H^2} = \sqrt{(234,56m)^2 - (4,36m)^2} = 234,23m .$$

B. 2) *Formula e përafërt për reduktimin e gjatësive*

Në trekëndëshit ABB' (fig. 6.9.) zbatohet teorema e Pitagorës:

$$(S')^2 - S^2 = \Delta H^2 , \quad (6.11.)$$

respektivisht:

$$(S' - S)(S' + S) = \Delta H^2 \quad (6.12.)$$

ose:

$$r = S' - S = \frac{\Delta H^2}{S' + S} \approx \frac{\Delta H^2}{2S'} . \quad (6.13.)$$

Për çdo rast konkret lehtë mund të përcaktohet se për përcaktimin e reduktimit a mund të shfrytëzohet formula e përafërt. Vlera e reduktimit, e llogaritur me saktësinë dhe formula e përafërt, mund të dallohet më së shumti për 1 cm. Te ndryshimet më të mëdha të lartësisë shfaqet ndryshim më i madh ndërmjet reduktimit i cili është llogaritur sipas formulës së saktësisë dhe asaj të përafërt. Në raste të tilla formula e përafërt për reduktim është:

$$r = \frac{\Delta H^2}{2 \cdot S'} + \frac{\Delta H^4}{8 \cdot S'^3} . \quad (6.14.)$$

Shembulli 6.3: Të llogaritet reduktimi sipas formulës së saktë dhe formulës së përafërt nëse është:

$$S' = 196,27m \text{ dhe } \Delta H = +2,56m .$$

Zgjidhje:

$$\sin \alpha = \frac{\Delta H}{S'} = 0,0730 \Rightarrow \alpha = 0^{\circ}45'$$

$$r = \Delta H \cdot \tan \frac{\alpha}{2} = 0,02m \qquad r = \frac{\Delta H^2}{2 \cdot S'} = \frac{6,55}{392,54} = 0,02m .$$

Shembulli 6.4: Të llogaritet reduktimi sipas formulës së saktë dhe formulës së përafërt nëse është:

$$S' = 66,86m \text{ dhe } \Delta H = +17,26m .$$

Zgjidhje:

$$\sin \alpha = \frac{\Delta H}{S'} = 0,2582 \Rightarrow \alpha = 14^{\circ}57'$$

$$r = \Delta H \cdot \tan \frac{\alpha}{2} = 2,27m \qquad r' = \frac{\Delta H^2}{2 \cdot S'} = \frac{297,9076}{133,72} = 2,23m$$

$$r'' = \frac{\Delta H^4}{8 \cdot S'^3} = \frac{17,26^4}{8 \cdot 66,86^3} = 0,04m$$

$$r = r' + r'' = 2,23m + 0,04m = 2,27m .$$

B. 3) Përcaktimi i ndryshimeve në lartësi

Me ndihmën e metodave gjeodezike, të cilat do të shpjegohen më vonë, përcaktohen ndryshimet e lartësisë ΔH_A^B ndërmjet hapësirave të sipërme të shenjave të pikave, gjatë të cilës të njëjtat janë të stabilizuara në terren. Për reduktimin e gjatësive të nevojshme janë ndryshimet në lartësi ΔH ndërmjet pikave përfundimtare të vijës së matur (pikat përfundimtare të shiritit).

Nga figura 6.5. rrjedh:

$$\Delta H = \Delta H_A^B - l_A ,$$

ndërsa nga figura 6.11 rrjedh:

$$\Delta H = \Delta H_A^B + l_B .$$

Në bazë të këtyre shembujve të thjeshtë mund të silllet ky përfundim:




Fig. 6.5. Ngritja e shiritit.




Fig. 6.6. Ngritja e shiritit.

- nëse shiriti ngrihet në pikën më të ulët, vlera absolute e ndryshimit të dhënë në lartësi duhet të zvogëlohet për vlerën e ngritjes së shiritit, ashtu që dallimi i ndryshimeve në lartësi shfrytëzohet për llogaritjen e reduktimit;
- kur shiriti ngrihet në pikën më të lartë, vlera absolute e ndryshimit të dhënë në lartësi duhet të rritet për vlerën e ngritjes së shiritit, ashtu që dallimi i ndryshimeve në lartësi shfrytëzohet për llogaritjen e reduktimit.

Ndryshimi i lartësisë ndërmjet pikave përfundimtare të gjatësisë mund të jetë pozitiv ose negativ, me çka para shenja nuk ka ndikim në reduktim. Reduktimi gjithmonë është me shenjë negative. Edhe përveç kësaj, në formën 18, futet shenja e ndryshimeve në lartësi që të shikohet cila pikë është më e lartë ose më e ulët që të mund drejt të futen ngritjet e shiritit në ndryshimin e lartësisë për reduktim.

Vlera e gjatësisë është e dhënë deri në 1 cm, prandaj rrjedh se edhe reduktimi duhet të llogaritet deri në 1 cm, sepse nuk ka nevojë vlera e reduktimit të llogaritet me saktësi më të madhe nga saktësia e leximit të shiritit.

7. INSTRUMENTET GJEODEZIKE

7.1. TEODOLITI DHE PJESE E TIJ PËRBËRËSE

Teodoliti është instrument i dedikuar për matjen e këndeve. Me ndihmën e teodolitit mund të maten këndet vertikale dhe horizontale. Nga varësia e konstruktionit dhe saktësisë, dallojmë më shumë lloje të teodoliteve. Me atë mund të maten kënde me saktësi prej 1' deri më 1", ndërsa te punët precize gjeodezike edhe me më shumë saktësi (për shembull 0.1").

7.1.1 Matja e këndeve

Këndi është pjesë e rrafshit i cili është i përkufizuar me dy gjysmëdrejtëza të cilat priten në pikën A . Pjesa e rrafshët e cila gjendet mes gjysmëdrejtëzave quhet kënd, gjysmëdrejtëzat quhen krahë këndeve, kurse pika e prerë A kulmi i këndit. Në gjeodezi na intereson madhësia e këndit (vlera e tij), ajo është masë e rrotullimit, domethënë për sa duhet të rrotullohet krahu i majtë nga këndi në drejtim të rrotullimit të akrepave të orës, kurse nuk përputhet me krahun e djathtë të këndit (fig 7.1.). Këndi i cili është i shënuar në letër matet me ndihmën e këndmatësit në mënyrën në vijim: qendra e këndmatësit vendoset në majën e këndit. Nëse ndarja e këndmatësit rritet në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës, në krahun e majtë të këndit vendoset zeroja e këndmatësit, në krahun e djathtë lexohet vlera e tij e shprehur në njësi me të cilat është kryer ndarja e këndmatësit.

Në hapësirë këndi është definuar me ndihmën e tri pikave gjeodezike A , B dhe C (fig. 7.2.) të cilat janë të stabilizuara me shenja të përkohshme ose të përhershme me qendra të shënuara. Pika A është kulmi i këndit, ndërsa gjysmëdrejtëzat AB dhe AC janë krahët e këndit. Ngase pikat A , B dhe C janë në nivele mbidetare të ndryshme, mbi to mund të tërhiqet një rrafsh i pjerrët në të cilin do të shtrihet këndi BAC .




Fig. 7.1. Këndi në rrafsh.





Fig 7.2. Këndi në hapësirë.

Megjithatë, në gjeodezi përdoren vetëm këndet horizontale dhe vertikale. Të marrim se nëpër vertikale të drejtëzave AB dhe AC do të vendosim nga një rrafsh vertikal, π_b dhe π_c , kurse nëpër pikën A rrafsh horizontal π , prerjen e rrafshit horizontal π me rrafshin vertikal π_b dhe π_c do t'i japë gjysmëdrejtëzat p dhe q , të cilat i formojnë këndet β . Ky kënd paraqet projektion ortogonal të këndit BAC. Kjo do të thotë këndi shtrihet në rrafshi horizontal, kurse nga ana tjetër këndet α_b dhe α_c shtrihen në rrafshin vertikal π_b dhe π_c dhe quhen kënde vertikale. Këndet vertikale mund të jenë pozitive ($\alpha_b < 0$), kur pika B ka lartësi më të madhe absolute nga lartësia absolute e pikës A, dhe negative ($\alpha_c < 0$), kur pika C ka lartësi më të vogël absolute nga lartësia absolute e pikës A. Në gjeodezi këndet maten me ndihmën e teodolitit i cili na mundëson që mbi pikën A të vendoset rreth (*limbë*) me ndarje (këndmatës), ashtu që i njëjti është

paralel me rrafshin horizontal π , kurse qendra e tij gjendet në pikën vertikale A. Me ndihmën e limbës ashtu të vendosur (këndmatës) mund të matet këndi horizontal β i cekur në fig. 7.2.

7.1.2 Përshkrimi i teodolitit

Teodoliti është mjet optik-mekanik i cili është i përbërë nga pjesë të ndryshme. Pjesët kryesore të teodolitit janë: vidat pozicionale, limba horizontale dhe vertikale, alkidada, libelat dhe pajisjet për leximin e ndarjeve të limbave (fig. 7.3.).



Legjenda:

- 2. Pllaka elastike
- 3. Vidat pozicionale
- 4.9 dhe 13. Frenat
- 5.10 dhe 14. Vida mikrometrike
- 6. Alkidada dhe limba
- 7 dhe 8. Mjeti për lexim
- 11. Libela
- 12. Dylbia
- 15. Stativi
- 16. Vida qendrore
- 17. Penda spirale
- 18. Mbajtësit i dylbisë

Fig. 7.3 Instrumenti gjeodezik – teodoliti.

Gjatë punës instrumenti vendoset në stativ ose në shtresë speciale (shtyllë). Stativi shërben si shtresë në të cilën mund të vendoset teodoliti gjatë matjes së këndeve. Me ndihmën e vidës qendrore (16) instrumenti përforcohet për stativ.

Për përforcimin e teodolitit për stativ shfrytëzohet pendë spirale (17), kurse te llojet e reja të instrumenteve shfrytëzohen pllaka elastike.

Në pjesën e sipërme e kokës së stativit të mbështetura janë vidat pozicionale (3), me ndihmën me të cilave instrumentet sillen në pozitë të përcaktuar.

Limba horizontale* është këndmatës me ndarje (6) i përcaktuar për matjen e këndeve horizontale.

Alkidada e limbës horizontale është pjesë e sipërme e lëvizshme e instrumentit (6) e cila lëviz dhe në të gjenden: pjesët për lexim të ndarjeve të limbës horizontale (7), mbajtëset e dylbisë (18), libelat (11), limba vertikale, alkidada e limbës vertikale etj.

Në alkidadën e limbës vertikale gjenden pjesët për lexim të ndarjes së asaj limbe dhe i libelave të tyre. Limba horizontale gjatë matjes së këndeve horizontale duhet të qëndrojë në një pozitë. Pas kryerjes së matjeve, ajo mund të lëvizë që të arrihet pozita e duhur.

Alkidada e limbës horizontale përmes boshtit** mbështetet në pjesën e poshtme të teodolitit. Gjatë matjes limba horizontale mbetet e shtangur me alkidadën e saj dhe mund të rrotullohet rreth pajisjes së menduar e cila quhet boshti i alkidadën***.

Dylbia, së bashku me limbën vertikale, është e përforcuar për boshtin e pasmë të dylbisë e cila me skajet është e mbështetur në mbajtëset e dylbisë. Në atë mënyrë është i mundur rrotullimi i dylbisë në rrafsh i cili është normal me boshtin e pasmë të dylbisë.

* Limba horizontale dhe vertikale i kanë fituar emrat sipas asaj se gjatë matjes së këndeve ato qëndrojnë horizontalisht, respektivisht vertikalisht.

** Boshtet janë trupa me formë cilindrike ose kone.

*** Boshti alkidad dhe boshti i limbës duhet të përshtaten dhe të kalojnë kah qendra e ndarjes së limbës.

Ngase dylbia mund të rrotullohet rreth boshtit të kundërt, mund ta vendosim në pozitën e duhur, respektivisht ta kthejmë kah kahja në cilëndo pikë të vëzhgimit.

7.2 VIDAT POZICIONALE

Në pjesën e poshtme të instrumentit gjendet tri vida pozicionale me ndihmën e të cilave instrumentin e vendosim në pozitën që e dëshirojmë. Vidat pozicionale janë të përpunuara nga metali. Në pjesën e poshtme të vidës pozicionale është i shtrënguar disku prej metali me ndihmën e të cilit rrotullohet vida pozicionale. Në vidat pozicionale veprohet në atë mënyrë që alkidadën mund ta sjellim, për shembull, në pozitë vertikale.

7.3. LIBELA

Gjatë matjes së këndeve horizontale, rrafshi i ndarjes së limbës vendoset në pozitë horizontale. Për arritjen e rrafshit në pozitën horizontale shfrytëzohet libela. Sipas formës së tyre libelat mund të jenë gypore dhe sferike.

7.3.1. Libela gypore

Libela gypore është gyp qelqi me formë të shtrembëruar e mbushur me alkool ose me eter sulfuri (lëng i cili ka pikë të ulët të ngrirjes). Në gypin e përpunuar prej qelqi futet lëng (i ngrohtë) dhe atëherë gypi mbyllet në mënyrë hermetike. Pas ftohjes lëngu mblidhet dhe në gyp mbetet vendi pa ajër i cili quhet fluskë e libelës. Ai gjithherë e merr pozitën më të lartë në libelë (fig. 7.4.).




Fig. 7.4. Libela gypore.

Për mbrojtjen e libelës nga dëmtimet vendoset mbrojtës prej metali i cili për shkak të vëzhgimit të libelës nga pjesa e sipërme ka hapje prej qelqi në formë elipsi. Për uljen e ndryshimeve të temperaturave, të cilat ndodhin tek instrumentet precize, libelat së bashku me mbështjellësin e tyre vendosen në gyp më të madh prej qelqi. Pjesa e sipërme e libelës gjithmonë ka formë e harkut rrethor. Pika e cila gjendet në mesin e harkut rrethor nga libela quhet *pikë normale e libelës* (M). Rrezja e libelës e cila kalon përmes normales së pikës M quhet *rreze normale e libelës* (MO) (fig. 7.5.). Tangjentja e harkut rrethor të libelës, e cila kalon rreth pikës kryesore është normale më rrezen kryesore dhe quhet *tangjentja kryesore* ose boshti i libelës. Në momentin kur mesi i fluskës së libelës përputhet me pikën normale, tangjentja kryesore të ashtuquajtur *boshti i libelës* merr pozitë horizontale, ndërsa rrezja kryesore është vertikale dhe në atë rast themi se fluska e libelës lëviz.

Për vlerësim më të lehtë të fluskës, është bërë ndarje e libelës nga pjesa e jashtme e gypit prej qelqit. Te libelat e vjetra vlера e një të dhëne i përgjigjet gjatësisë së vijës parësore (parës i ndarjes) 2,66 mm, kurse te të rejat është 2,00 mm. Megjithatë edhe më tej është mbajtur shprehja *parës* i libelës.




Fig. 7.5. Boshti i libelës.

Ndarja parësore mund të zbatohet, ashtu që do të jetë në kontinuitet nga njëri fund deri te tjetri fund i libelës (fig. 7.6.), ose simetrikisht majtas ose djathtas të rritet në raport të pikës normale.




Fig. 7.6. Ndarja parëse.

Libela e cila është e përpunuar vetëm nga njëra anë quhet *libelë e thjeshtë*, ndërsa libela e cila është e përpunuar në të dy anët, kurse ndarja është bërë në dy anë diametralisht të kundërta quhet *libelë reverzionale*. Kjo libelë mund të shfrytëzohet në dy pozicione të cilat në mes veti dallohen për 180° . Forma e brendshme e kësaj libele fitohet me rrotullim e harkut rrethor drejt drejtëzës AB (fig. 7.7.). Siç duket libelat reverzionale kanë dy pika normale M_1 dhe M_2 , dy rreze kryesore dhe dy tangjentja kryesore T - T dhe $T_2 - T_2$. Pikat kryesore të libelës duhet të shtrihen në

një rrafsh i cili është normale e drejtëzave AB, kurse tangjentet kryesore (boshtet e libelës) T_1-T_1 dhe T_2-T_2 ndërmjet veti duhet të jenë paralele.




Fig. 7.7. *Libela reversionuese.*

Sa më e madhe është rrezja e libelës, aq është më e madhe është ndjeshmëria e libelës, kurse edhe gjatësia e flluskës në atë rast është më e madhe.

Libelat me gjatësi më të madhe të flluskës së libelës janë më precize. Gjatësia e flluskës varet nga gjatësia e libelës, si dhe nga temperatura të cilën e ka pasur lëngu gjatë mbushjes në gypin e libelës.

Kur temperatura e jashtme është më e madhe, lëngu zgjerohet, kurse flluska e libelës mbetet më e vogël. Gjatësia optimale e flluskës shpesh herë duhet të jetë 0,5 - 0,6 nga gjatësia e libelës.

Libelat mund të jenë të lira ose të lidhura për ndonjë mjeti ose instrumenti, dhe sipas mënyrës së përdorimit ndahen në libela të lidhura dhe të lira. Libelat e lidhura janë të përforcuara për ndonjë pjesë të instrumentit dhe pa të nuk mund të shfrytëzohen. Libelat e lira sipas dëshirës mund të vendosen në bazën e instrumentit (libela varëse) ose mund të mbështeten në bazën e instrumentit (fig. 7.8.). Libelat varëse shpesh herë shfrytëzohen për sjelljen e bazës së instrumenteve në pozitë vertikale dhe horizontale.




Fig. 7.8. Libela varëse (a) dhe libela shtrirëse (b)

7.3.2. Ndjeshmëria e libelës

Ndjeshmëria e libelës është kënd i qendror i cili përgjigjet në harkun e një parësi (fig. 7.9.). Kjo është vlerë këndore nga një parës:

$$\alpha = \frac{b}{R}$$

respektivisht:

$$\alpha'' = \rho'' \cdot \frac{b}{R}. \quad (7.1.)$$

Kur flluska e libelës lëviz, atëherë boshti i libelës qëndron horizontalisht, ndërsa rrezja kryesore vertikalisht. Nëse libela zhvendoset, ashtu që flluska e saj do të mënjanohet për një parës, kurse rrezja kryesore do të zhvendoset për një vlerë këndore dhe për të njëjtin kënd, tangjentja kryesore (boshti i libelës) do të mënjanohet nga horizonti. Ndjeshmëria

e libelës është kënd për të cili duhet të zhvendoset boshti i libelës që muri i libelës të mund të mënjanohet për një pars (vlera këndore për një pars).




Fig. 7.9. Ndjeshmëria e libelës.

Kur është e njohur vlera e një parsit $b = 2 \text{ mm}$ dhe rrezja e lakores së libelës R , mund të llogaritet ndjeshmëria e libelës.

A) Përcaktimi e ndjeshmërisë së libelës

Në terren të rrafshët (fig. 7.10.) vendoset hatull në pozitë vertikale në 40 deri 50 m larg nga instrumenti dhe matet gjatësia S . Dylbinë e vendosim në drejtimin e hatullës, fluskën e libelës e sjellim të lëvizë dhe pastaj me vijëzën e mesëm lexohet vlera e ndarjes së hatullës. Pastaj dylbia pak ngritet, ashtu që fluska e libelës mënjanohet prej 3 deri në 4 parse dhe prapë me fijen e mesme lexohet vlera l_2 e hatullës. Ndryshimi i vlerës së leximit të hatullës $l_2 - l_1$ është bërë nga zhvendosja e fluskës nga libela për n parse, prandaj është:

$$n\alpha = \frac{l_2 - l_1}{S} \text{ respektivisht: } \alpha'' = \rho'' \cdot \frac{l_2 - l_1}{n \cdot S}.$$




Fig. 7.10. Përcaktimi i ndjeshmërisë së libelës.

7.3.3 Libela qendërzuese (sferike)

Libela (sferike, cilindrike) qendërzuese është e përpunuar nga gypi i gjerë prej qelqi ku pjesa e brendshme e lartë, është gjendur si kalotë sferike. Gypi prej qelqi mbushet me lëng të nxehtë dhe pastaj hermetikisht mbyllet. Gjatë ftohjes lëngu pak mblidhet dhe në gyp mbetet pak hapësirë pa ajër (fluskë e libelës) e cila ka formë rrethi. Pika në të cilën boshti i libelës e pret sferën kalotike, quhet pika kryesore e libelës. Rrafshi, i cili qëndron normalisht në boshtin e cilindrit dhe në vete mban pikën normale, quhet tangjentja kryesore T-T (fig. 7.11.).




Fig. 7.11. Libela sferike

Kur mesi i fluskës së libelës dhe pika normale përputhen thuhet se fluska e libelës lëvizë dhe tangjentja kryesore qëndron horizontalisht, kurse boshti kryesor vertikalisht. Libela qendërzuese është me ndjeshmëri të vogël dhe shërben përafërsisht për afrimin e boshteve në pozita vertikale dhe horizontale.

7.3.4. Analiza dhe rektifikimi i libelës.

Libelat, të lidhura për pjesë të veçanta nga instrumenti, duhet t'i kënaqin kushtet të cilat janë në lidhje me kushtet e instrumentit (për atë do bëhet fjalë më vonë). Këtu do ta shpjegojmë analizën dhe rektifikimin e libelës së lirë. Gypi prej qelqi i libelës është e vendosur në kornizë dhe me të është e përqendruar shtresa P-P (fig. 7.12.).




Fig. 7.12. Libela e lirë.

Me njërin skaj libela është e lidhur me boshtin S, ndërsa me skajin tjetër mbështetet në vidën korrigjues K, me ndihmën e të cilës libela mund të ngrihet dhe ulet.

Që libela të mund të shfrytëzohet për sjelljen e rrafshit në pozitë horizontale, patjetër duhet ta kënaqë kushtin me të cilin boshti i libelës duhet të jetë paralel me shtresën (rrafshin e shtresës P-P).

Që ky kusht të mund të kontrollohet, është e nevojshme:

- libela të vendoset në rrafsh afërsisht horizontal, i cili sipas nevojës mund të zhvendoset;
- me zhvendosje të lehtë të rrafshit, në të cilin qëndron libela, të silllet fluska në libelë që të lëvizë;
- pastaj libelën e ngremë dhe e rrotullojmë për 180° , ashtu që skajet e saj t'i zëvendësojnë vendet e njëjta. Nëse fluska e libelës lëviz, kushti është kënaqur.

Nëse fluska e libelës shmanget, shmangia është e dyfishtë (2ω), gjysma e shmangies (ω) rrjedh nga boshti joparalel i libelës dhe rrafshit të bazamentit P -P, kurse gjysma tjetër (ω) sepse rrafshi në të cilin qëndron është lakuar kah horizonti nën kënd ω (fig. 7.13.).




Fig. 7.13. Kontrollimi i libelës.

Rektifikimi (ndreqja) e libelës bëhet sipas shmangies së ndodhur. Duke ndikuar në vidën korigjuese K (fig. 7.12.), ndreqet gjysma e shmangies, respektivisht vendoset boshti në libelë që të jetë paralel me rrafshin e poshtëm të bazamentit, kurse gjysma tjetër ndreqet ashtu që vendoset me njërin skaj te rrafshi në të cilin qëndron libela. Është e sigurt se vetëm me një procedurë nuk do të kënaqet kushti. Nevojitet procedura për kontrollim dhe rektifikim të përsëritet shumë herë derisa shmangia nga të dy pozicionet (2ω) nuk është më e vogël se 0,2 deri 0,3 parësa.

Me libelën e kontrolluar dhe të rektifikuar lehtë vijmë deri te cilido qoftë rrafsh në pozitën horizontale. Vendoset libela në rrafsh në pozitë të përafërt dhe pastaj me ngritje ose me lëshim të rrafshit sillet flluska e libelës që të lëvizë. Libela rrotullohet për 90° në raport me kahjen e mëparshme, rrafshi ngritet ose lëshohet në atë kahje, ashtu që flluska në libelë sillet që të lëvizë. Në këtë mënyrë janë bërë të dy drejtëzat, të cilat ndërmjet veti janë normale dhe shtrihen në rrafsh të njëjtë që të jenë horizontale. Në këtë rast, rrafshi i cili i përmban të dy drejtëzat është horizontal.

Kur rrafshi horizontal, në të cilin është vendosur libela e lirë, pak do të zhvendoset, flluska në libelë në fillim lëviz shpejt, kurse më vonë lëvizja zvogëlohet derisa nuk ndalet tërësisht (fig. 7.14.).

7.3.5 Përtesa e libelës

Kur rrafshi horizontal, ku është e vendosur libela e lirë, pak do të zhvendoset, flluska e libelës në fillim lëviz më shpejt, ndërsa më vonë lëvizja e saj ngadalësohet deri kur nuk ndalet tërësisht (fig. 7.14.).




Fig. 7.14. Përtesa e libelës.

Nëse nuk pritet krejtësisht të qetësohet, bëhet gabim i cili quhet vërejtje e hershme. Te libela mund të vërehet edhe kjo veçori: flluska e libelës rregullohet të kalojë, pastaj ngritet pak njëri fund i libelës dhe prapë lëshohet në vendpozitën e parë. Kur flluska prapë do të qetësohet, ajo nuk do ta zërë vendpozitën e mëparshme. Gabimi i të vërejturit të hershëm dhe gabimi i vonuar i flluskës së libelës karakterizohet si përtesë e libelës. Që flluska e libelës përsëri të mund të qetësohet, duhet të pritët 2-3 minuta.

7.3.6. Vrojtimi i flluskës së libelës

Ndjekja e lëvizjes së flluskës së libelës dhe përcaktimi nëse flluska e libelës kalon, mund të kontrollohet në shumë mënyra:

a) Kur flluska vrojtohet me sy, kalimi i flluskës vlerësohet me krahasimin e skajeve të flluskës së libelës me vijëzat të cilët janë simetrike në raport të pikës normale (fig. 7.15.).

Nëse flluska e libelës vrojtohet nga pozita nën kënd, përkundrejt rrafshit i cili qëndron normalisht në boshtin e libelës (fig. 7.16.), do të fitohet përfundim i gabuar për pozitën e flluskës së libelës.



Fig. 7.15. Vështrimi i flluskës së libelës.

Prandaj gjatë vështrimit të flluskës së libelës vrojtuesi duhet të vendoset, ashtu që ndarja e libelës të shikohet nën kënd të drejtë në raport me boshtin e libelës. Anët negative e vështrimit të këtillë me sy janë:

- vrojtuesi (operatori) gjithherë sillet rreth instrumentit, me çka zvogëlohet stabiliteti i tij dhe zmadhohet kohëzgjatja e matjes;

- fluska nuk vrojtohet nga pozita më e volitshme;
- nuk mund mjaft preciz të konstatohet nëse fluska e libelës kalon, respektivisht nëse skajet e fluskës së libelës njëlloj janë të distancuara nga viza e përshtatshme e ndarjes së libelës.




Fig. 7.16. Vështrimi i libelës nën kënd.

b) Flluska e libelës mund të vrojtohet me ndihmën e pasqyrës. Mbi libelë vendoset pasqyrë, ashtu që forma e fluskës të shikohet në pasqyrë nga vendi ku normalisht qëndron operatori. Dukja e fluskës dhe raporti i saj drejt ndarjes së libelës varet nga pozita e pasqyrës. Pozita e pasqyrës duhet të vendoset, ashtu që forma e fluskës së jetë e njëjtë sikur të duket me sy. Prandaj, në mbajtësen e pasqyrës është vendosur kufizues i cili pamundëson lëvizje të mëtutjeshme të pasqyrës. Kur pasqyra është e kthyer deri te kufizuesi, forma shikohet tërësisht (drejt), kurse në të kundërtën forma është e deformuar (zgjatur).

c) Mënyra më e përshtatshme dhe më e saktë e sjelljes së fluskës që kalon arrihet me ndihmën e prizmave speciale për ko incidencë të cilat mundësojnë që në fushë të veçantë ose përmes pamjes së dylbisë të shënohen skajet e fluskës së libelës. Flluska e libelës kalon nëse skajet e fluskës ko incidohen (përputhen) (fig. 7.17.)




Fig. 7.17. *Koincidenca e skajeve të fluskës së libelës me ndihmën e prizmave.*

Koincidenca (sjellja) e fluskës së libelës që kalon me ndihmën e prizmave ka disa përparësi:

- operatori nuk duhet të zhvendoset në mënyrë speciale për kontrollim dhe sjellje të fluskës së libelës;
- shmangia e fluskës së libelës tregohet dy herë e zmadhuar për lëvizjen e dyanshme të formave të skajeve të fluskës;
- dylbitë përmes të cilave vëzhgohet libela ka zmadhim, prandaj përjashtimi i fluskës shikohet i zmadhuar prandaj shumë preciz mund të sillet që fluska të kalojë;
- me shumë precizitet mund të bëhet vlerësimi i përputhjes së formave të skajeve të fluskës sesa simetria e tyre në raport të vizave të ndarjes parësore të libelës.

Disa përparësi të përmendura kontribuojnë që fluska e libelës të sillet të kalojë 5-10 më saktësisht, në raport të sjelljes në pozitë të njëjtë me vrojtim dhe vlerësim të syrit. Prandaj të gjitha instrumentet gjeodezike bashkëkohore fluska e libelës sillet të kalojë me ndihmën e prizmave, të vendosur në vegla të posaçme (dylbitë etj.).

7.4. DYLBIA

Dylbia është vegël optike e përcaktuar për zmadhimin e formave të objekteve të largëta të cilat vrojtohen ose zmadhohen. Ekzistojnë dy pjesë të dylbive: katoptike dhe dioptrike.

Katoptiket janë të përpunuara në parim të përjashtimit të dritës nga pasqyrat. Në gjeodezi këto dylbi nuk përdoren. Dylbitë dioptrike janë të përpunuara në parimin e përthyerjes së dritës me ndihmën e sistemit diellor. Në kohën më të re përpunohen dylbitë të cilat në konstruksionin e tyre kanë edhe sistem të thjerrëzave dhe pasqyrës, pra paraqet kombinim të dylbive katoptike dhe dioptrike. Ngase në gjeodezi shfrytëzohen vetëm dylbi dioptrike, këtu do ta përshkruajmë vetëm konstruksionin e tyre.

Dylbitë dioptrike i kanë elementet kryesore (fig. 7.18.):

- *Thjerrëza objektive* e cila gjendet në pjesën ballore të dylbisë dhe është e kthyer kah objekti;
- *Thjerrëza okulare* e cila gjendet në pjesën e pasme të dylbisë dhe është kthyer kah operatori;
- *Penjësori* i cili gjendet ndërmjet objektivit dhe okularit;
- *Vida për fokusim*.




Fig. 7.18. Dylbia.

Pjesët e përmendura të dylbisë janë të vendosura në gyp të metalit sipas të cilit janë edhe të emëruara:

- në gypin objektiv është vendosur thjerrëza objektive;
- në gypin okular gjendet thjerrëza okulare;
- në gypin e penjzorit gjendet penjzori.

Gypi i okularit tërhiqet në gypin e penjzorit, e bashkë me atë në gypin e objektivit.

7.4.1. Penjzori

Penjzori në të kaluarën ishte i përpunuar me penj të preparuar nga merimanga të shtrënguara në unazë të penjzorit, prej ku edhe e ka fituar emrin. Sot ai përpunohet në lloj të pllakës planparalele me vijëza mirë të gdhendura. Penjzori i tillë ka më shumë përparësi:

- nuk ndodh që fijet e perit të këputen ose të shkëputen nga unaza;
- më lehtë është që të përpunohen penjzorë në më shumë forma (fig. 7.20.).




Fig. 7.19. Gypi i penjzorit dhe penjzori.




Fig 7.20. Llojet e penjzorëve.

Gjatë analizave të teodolitit ndonjëherë penjzori duhet të rrotullohet ose të zhvendoset pak në mënyrë translatore djathtas-majtas dhe poshtë-lart. Këto zhvendosje janë të mundura me dy vida korrektuese horizontale dhe dy vertikale ($K_1 - K_2, -K_3, -K_4$, fig. 7.19). Nëse njëkohësisht

njëri nga vidat çrrotullohet, ndërsa tjetra rrotullohet, penjzori zhvendoset. Kur të çrrotullohet vida K_5 , penjzorin mund ta rrotullojmë në drejtimin e dëshiruar dhe prapë ta shtrëngojmë me vidën K_5 . Penjzori ka rol të rëndësishëm tek instrumentet gjeodezike, sepse pa të dylbia mund të shfrytëzohet vetëm për vështrim të objekteve. Megjithatë, te odolitet dhe instrumentet tjera dylbia me ndihmën e penjzorit shërben për vijëzim të sinjaleve gjeodezike, në të cilat njëkohësisht bëhen edhe matje të caktuara. Pamja e penjzorit, para se gjithash, varet nga qëllimi i instrumentit. Penjzori në fig. 7.20. (a dhe b) ka formë më të thjeshtë dhe ndërtohet në instrumente të cilat shërbejnë për matjen e këndeve horizontale dhe vertikale. Penjzori në fig. 7.20. (c dhe d) ndërtohet tek instrumentet me ndihmën e të cilave maten distanca, për shembull siç është largmatësi i Rajhenbahut e tjera.

Drejtëzat të cilat i lidh qendra optike e thjerrëzës së objektivit (pikën nëpër të cilën kalojnë rrezet dhe pastaj nuk e ndërrojnë kahjen e tyre të lëvizjes) dhe ndërprerja e vijëzës vertikale dhe të mesme të penjzorit quhet *vizurë*. Zhvendosja e vizurës mund të bëhet vetëm me zhvendosje të penjzorit.

Procedura kur vizurën e vëmë që të qëllojë ndonjë pikë të perceptueshme ose objekt quhet *vijëzim*.

7.4.2. Paralaksa e penjzorit

Me ndihmën e dylbisë vështrohen objekte në largësi të ndryshme, kurse format e tyre formohen në distanca të ndryshme nga thjerrëza objektive, që do të thotë se çdoherë nuk mund t'i shikojmë qartë. Shëmbëlltyra e paqartë e cila formohet në objekt paraqitet, sepse forma që formohet nuk është në rrafsh të penjzorit. Distanca ndërmjet këtyre dy rrafsheve quhet *paralaksë e penjzorit*. Ekzistimi i paralaksës së penjzorit mund të konstatohet kur forma e ndonjë objekti vështrohet me dylbi, kurse pastaj e zhvendosim syrin para okularit majtas-djathtas. Nëse gjatë kësaj procedure format e objektit dhe penjzorit pushojnë njëra ndaj tjetra, kjo tregon se nuk ekziston paralaksa e penjzorit (fig.

7.21.), kurse kur format zhvendosen, në atë rastt ekziston paralaksa e penjësorit. Nëse ekziston paralaksa e penjësorit, forma e objektit mund të gjendet:

- ndërmjet penjësorit dhe okularit, nëse gjatë lëvizjes së syrit para okularit në të majtë forma e objektit në raport me penjësorin e fiksuar zhvendoset në të djathtë dhe anasjelltas (fig. 7.21b)
- ndërmjet penjësorit dhe objektivit mund të vërehet, ashtu që gjatë lëvizjes së syrit para okularit në të majtë forma e objektit në raport me penjësorin e fiksuar do të zhvendoset në të majtë dhe anasjelltas (fig. 7.21a).

Sjellja e formës në shikim të qartë (mprehtësi) – prishja e penjësorit të paralaksës – bëhet ose me sjelljen e penjësorit në rrafshin e formës ose me sjelljen e formës së objektit në rrafshin e penjësorit.




Fig. 7.21. Paralaksa e penjësorit.

Në rastin e parë forma e formuar e objektit nuk zhvendoset, por zhvendoset penjësori me tërheqjen ose me nxjerrjen e gypit të penjësorit në gypin e objektivit. Në atë mënyrë ndërrohet gjatësia e dylbisë. Zhvendosja e gypit të penjësorit dhe ndryshimi i gjatësisë së dylbisë bëhet me ndihmën e vidës së posaçëm paralaktike e cila gjendet nga ana e dylbisë (fig. 7.18. A.). Dylbitë e tilla quhen dylbi me konstruktim të vjetër ose dylbi me gjatësi të ndryshueshme. Ana negative e këtyre dylbive është në atë që vijon:

- ndryshimi i gjatësisë së dylbisë kushtëzon ekzistimin e një distance të vogël ndërmjet gypit objektiv dhe penjësorit, ashtu që në

- dylbi lehtë hyn avulli i ujit dhe pluhur i imët; paraqitja e tillë ka për pasojë pamje të keqe dhe fërkim i zmadhuar i dhëmbëzoreve.
- gypi i penjëzorit vazhdimisht zhvendoset, fiton lëvizje të pa rregullt, ashtu që me kalimin e kohës zvogëlohet saktësia e dylbisë, respektivisht pjesët e saj nuk e mbajnë pozitën ndërmjet tyre dhe nuk i përmbushin kushtet të cilat janë të nevojshme për matjen e këndeve;
 - teodolitet shpesh herë mund të shfrytëzohen edhe për matjen e gjatësive, të ashtuquajtur si largmatës optik (për të cilët do të bëhet fjalë më vonë), pra dylbitë me gjatësi të ndryshueshme kanë konstantë adicionele, e cila e komplikon procedurën për përcaktimin e gjatësive dhe ndryshimeve në lartësi.

Në rastin e dytë penjëzori qëndron i palëvizshëm, kurse forma e objektit zhvendoset, ashtu që të bjerë në rrafshin e penjëzorit. Për zhvendosjen e formës së objektit, në dylbi ekziston edhe një *thjerrëz analitike*, e cila mund të jetë e shtypur në të dy anët ose e thelluar në të dy anët, si anëtar negativ i *teleobjektivit* (fig. 7.18b). Me rrotullimin e vidës së përcaktuar, thjerrëza analitike zhvendoset para-prapa, kurse me atë forma e objektit sillet në rrafshin e penjëzorit {bëhet fokusim i brendshëm (fig. 7.18.)}. Dylbitë, të cilat kanë gjatësi konstante, quhen edhe dylbi me konstruktion të ri ose dylbi analitike.

Dylbitë analitike kanë më shumë përparësi në raport me dylbitë me konstruktion të vjetër:

- dylbia është me gjatësi fikse, por nuk ka vrima nëpërmjet të cilave në brendësinë e saj mund të hyjë pluhur dhe lagështi;
- lëvizja e thjerrëzës analitike është më saktë në dylbi sesa lëvizja e gypit penjëzor;
- si largmatës kjo dylbi nuk ka konstantë adicionele.

Nëse paralaksa e penjëzorit nuk mënjanohet mjaft mirë, atëherë vijëzimi varet nga pozita e syrit para okularit. Rast i këtillë nuk duhet praktikuar.

7.4.3. Thjerrëza okulare

Thjerrëza okulare është kombinim i thjeshtë i dy thjerrëzave. Ekzistojnë më shumë lloje të thjerrëzave okulare, por te dylbitë e instrumenteve gjeodezike shfrytëzohet okulari i Ramsdenit (fig. 7.22.).




Fig. 7.22. Llojet e okularëve të Ramsdenit

Karakteristikat e këtyre okularëve është që penjzori gjendet para thjerrës okulare. Thjerrëza okulare mund të afrohet ose mënjanohet nga penjzori, dhe në atë mënyrë ndryshohet largësia e shikimit të qartë të penjzorit. Që penjzorin të mund ta sjellim në shikueshmëri të qartë, është e nevojshme dylbinë ta drejtojmë kah qielli ose kah ndonjë hapësirë të ndritshme. Me rrotullimin e thjerrës okulare tërhiqet ose nxirret gypi okular nga gypi i penjzorit, kurse forma e penjzorit nuk është mjaft e qartë.

Forma në penjzor do të jetë më se e qartë kur ndodhet në largësi në shikim të qartë. Largësia e shikimit të qartë varet nga cilësitë fiziologjike të syve të operatorit.

7.4.4 Karakteristikat e dylbisë

Karakteristikat e dylbisë janë: zmadhimi, fusha e dukshme, ndjeshmëria dhe forma e qartë.

1. *Zmadhimi i dylbisë* paraqet herësin ndërmjet madhësisë së formës së objektit të vështruar përmes dylbisë dhe madhësisë së objektit të vështruar me sy. Zmadhimi i dylbisë është dhënë me barazimin që vijon:

$$U = \frac{f_{ob}}{f_{ok}} \quad (7.2.)$$

ku është:

f_{ob} - largësia fokuse e thjerrzës objektive;

f_{ok} - largësia fokuse e thjerrzës okulare.

Instrumentet të cilat shfrytëzohen për matje precize, duhet të kenë zmadhim të dylbisë 30-40 herë, kurse për matje të thjeshta zmadhimi është 18-30 herë. Që të mund të arrihet zmadhim më i madh shfrytëzohen objektivë me largësi të madhe fokuse ose okular e me largësi të vogël fokuse. Dylbitë me largësi fokuse të madhe kanë gjatësi të madhe, pra instrumentet do të ishin gjigante. Gjatësia e dylbisë zvogëlohet me ndihmën e krijimit të formës e cila fitohet me ndihmën me përtsherjes dhe dëbimit të dritës, i ashtuquajtur kombinacion i tyre (fig. 7.23.). Me kombinim të tillë dylbitë me gjatësi të vogël mund të kenë largësi të madhe fokuse të objektivit.




Fig 7.2.3. Krijimi i formës me thyerje dhe dëbim të dritës

2. Fusha e dukshme e dylbisë quhet hapësira e cila mund të shihet përmes dylbisë. Madhësia e hapësirës varet nga hapja e unazës së penjëzorit gjatë së cilit ajo e ka rolin e diafragmës.

Fusha e dukshme e dylbisë shprehet me këndin hapësinor të cilin e formojnë rrezet përfundimtare, gjatë së cilës diafragma i lëshon në fushën e dukshme të dylbisë. Hapja e diafragmës d mund të kuptohet si pjesë e harkut, rrezja e të cilit ka madhësi f_1 ,

$$d = V \cdot f_1 \quad \text{ose} \quad V = \frac{d}{f_1}. \quad (7.3.)$$

Nëse diafragma është $d = 0,5 \cdot f_2$, atëherë do të fitohet:

$$V = \frac{0,5 \cdot f_2}{f_1} = \frac{0,5}{f_1 : f_2}; \quad (7.4.)$$

respektivisht:

$$V = \frac{0,5}{U}. \quad (7.5.)$$

Domethënë, madhësia e fushës së dukshme të dylbisë është proporcionalisht e kundërt me zmadhimin e dylbisë.

Këndi i fushës së dukshme mund të përcaktohet me matje. Për shembull: me ndihmën e skajit të majtë të fushës së dukshme vijëzohet një pikë dhe në atë moment bëhet leximi i limbës. Ndryshimi i këtyre dy leximeve paraqet madhësia e fushës së dukshme.

3. *Ndjeshmëria e formës* është raporti ndërmjet sasisë së dritës e cila prek deri te syri (në një sipërfaqe) gjatë vështrimit të objektit me sy përmes dylbisë.

4. *Forma e qartë* e objektit fitohet me vështrimin e objekteve me konstruksion të rregullt (p.sh. katror etj.). Nëse forma e objektit mbetet e rregullt dhe e qartë, dylbia ka qartësi të mirë. Nëse fitohet formë e deformuar (fig. 7.24.), atëherë dylbia ka qartësi të dobët dhe të këtyllat nuk përdoren.




Fig. 7.24. *Forma e qartë.*

7.5 LIMBA

Siç është e njohur, me këndmatës mund të përcaktohet madhësia e këndit. Prandaj në instrumentin i cili shërben për matjen e këndeve horizontale dhe vertikale është i ndërtuar këndmatës special në formë të rrethit i cili quhet *limbë*. Limbat përpunohen nga qelqi special ose nga metali, ashtu që nuk e ndryshojnë madhësinë e saj me ndryshimin e temperaturës. Madhësia e limbave është e shprehur me diametra të saj dhe lëviz nga 10 deri 20 cm. Ndarja e limbës është bërë në anën e tërthortë me ndihmën e makinës speciale. Rrafshi i cili kalon përmes skajeve të jashtme të ndarjes së limbës quhet rrafshi i limbës. Përparësia e limbave të qelqit në raport me ato të metalit është me sa vijon:

- ndarja e limbave të qelqit bëhet me ndihmën e foto mënyrës, gjatë të cilës zvogëlohet ndarja e shfaqur nga një limbë e madhe me madhësi të zakonshme;
- gjatë zvogëlimit të formës së ndarjes për n herë, zvogëlohen në raport të njëjtë edhe me gabimet e imëta të ndarjes;
- limbat e qelqit janë të dukshme, përmes tyre kalon drita (dhe me të forma e ndarjes së limbës) që e shfrytëzojnë pajisjet për lexim dhe mundësohet saktësi e saktë gjatë leximit të ndarjes së limbës.

Ndarja e limbës rritet në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës dhe mund të jetë seksagezimale ose centizimale. Sipas rregullës, shkaktohen shkallë të tëra dhe vlerat e tyre shënohen me numra. Nëse ndarja e limbës vështrohet me llupë, e cila ka një fushë të dukshme, çdo shkallë e pestë ose e dhjetë shënohet me numër. Kur ndarjen e vështrojmë me mikroskop, çdo shkallë është e shënuar me numra (fig. 7.25.).

Te disa limba shkalla më tutje ndahet në dy, tri ose gjashtë pjesë të barabarta (30', 20' ose 10'). Sa do të jetë vlera e pjesës më të vogël, varet nga saktësia e ndarjes së limbës, si dhe nga pajisjet me të cilat bëhet leximi i ndarjes. Ndarja e limbës është bërë, ashtu që pa vështirësi të mëdha mund të bëhet leximi.

Shkallët janë shënuar me vijëza më të gjata, gjysma e shkallëve (nëse janë të shënuara) pak më të shkurta, kurse 10 të mbeturat të minutave, me viza më të shkurta.




Fig. 7.25. *Limba.*

Limba horizontale duhet të jetë e palëvizshme deri sa të bëhet matja e këndeve. Te disa teodolite limba horizontale është e lidhur fort me pjesën e poshtme të teodolitit dhe prandaj ato i quajmë *teodolite të thjeshtë*. Pjesa më e madhe e teodoliteve kanë limbë të lëvizshme. Gjatë kohës së matjes së këndeve limba fiksohet me ndihmën e penjëzorit të limbës, kurse zhvendosja bëhet me ndihmën e vidës së posaçme mikrometrike. Teodolitët që e kanë këtë mundësi quhen *teodolite repetecionale*.

Limba ka bosht mekanik i cili e mban limbën. Pjesa e menduar me të cilën limba rrotullohet quhet boshti i limbës dhe kalon nëpërmjet qendrës së ndarjes së limbës.

Limba vertikale mund të ketë ndarje të bërë edhe në drejtim të kundërt nga lëvizja e akrepave të orës.

7.6. ALKIDADA

Alkidada është pjesë ku si mbështjellës prej metali e mbron limbën nga dëmtimet edhe me vete i mban pajisjet për leximin e ndarjes së limbës, transportuesit të dylbisë dhe libelat.

Alkidada mbështetet si bartës i boshtit të alkidadës, dhe kjo mundëson të rrotullohet. Pajisja e menduar përreth të cilës alkidada rrotullohet quhet boshti alkidad, i cili përputhet me boshtin e alkidadës dhe njëkohësisht është normale e rrafshit të limbës. Boshti i alkidadës

dhe boshti i limbës duhet të vendosen, ashtu që boshtet e tyre të përputhen. Sqarimi skematik i boshtit të limbës dhe boshtit të alkidadës është dhënë në fig. 7.26.




Fig. 7.26. Pozita ndërmjet limbës dhe alkidadës te konstrukcioni i vjetër.

Ngase konstrukcioni dhe përpunimi i boshtit të alkidadës dhe limbës nuk është i përkryer, ndodh që alkidadada gjatë lëvizjes “ta tërheqë” limbën. Nëse kjo paraqitje vërehet, dhe nëse tërheqja e limbës është e vogël, gabimet në vlerat e këndeve të matura mund të zvogëlohen me metodën e punës. Nëse gabimet janë domethënëse, atëherë instrumenti nuk është për përdorim.

Te instrumentet me konstrukcion të ri, boshtet e limbës dhe alkidadës nuk kanë pika prekëse, kështu që tërheqja e limbës praktikisht është e përjashtuar (fig. 7.27.).




Fig 7.27. Pozita ndërmjet limbës dhe alkidadës te konstrukcioni i ri.

Për fiksimin e alkidadës ekziston vidë i veçantë - freni i alkidadës. Kur freni është i liruar, alkidadada lirisht mund të lëvizë me dorë. Për zh-

vendosje të vogla të alkidadës ekziston vidë mikrometrike e cila mund të reagojë nëse freni është i shtrënguar. Në fig. 7.28. është paraqitur shpjegimi skematik i teodolitit hapësinor dhe repeticional, kurse në fig. 7.29. është treguar mënyra e reagimit të vidave mikrometrike.




Fig. 7.28. Teodoliti repeticional (a) dhe i thjeshtë (b).




Fig. 7.29. Vida mikrometrike.

7.7. MJETET PËR LEXIM

Ndarja e limbës është bërë, ashtu që ndarja më e vogël është nga 10' deri në 1°. Megjithatë, kjo vlerë nuk i përmbush edhe gjërat më të

ashpra gjeodezike. Leximi i pjesëve të vogla nga më të voglat e limbës arrihet me ndihmën e mjeteve speciale. Me ndihmën e mjeteve ndarja e limbës mund të lexohet me saktësi prej 1' deri 0",01. Në varësi prej saktësisë me të cilën duhet të lexohet ndarja e limbës, përpunohen mjete të ndryshme. Parimi i leximit nuk është identike të të gjitha mjetet, ashtu që ato dallohen sipas konstruksionit të tyre. Këtu do të rishikohen vetëm disa mjete për lexim. Në varësi nga saktësia e leximit të ndarjes së limbës përdoren mjetet vijuese: noniusi, mikroskopi dhe mjetet digjitale.

7.7.1. Noniusi

Noniusi është mjet për leximin e vlerave më të vogla nga ndarja më e vogël e masës. Sipas formës, noniusi mund të jetë *linear* (i drejtë) ose *rrethor* (harkor). Noniusi linear shfrytëzohet gjatë matjes së gjatësive me ndihmën e vizores, ndërsa ai rrethor (harkori) shfrytëzohet për leximin e ndarjeve këndore të limbat.

Sipas konstruksionit noniuset ndahen në: *të pasme* (pozitive) dhe *të përparshme* (negative)

Për konstruksionin e noniusit të pasmë merren $(n-1)$ pjesë të masës (vizores) me madhësi L dhe ndahet në n pjesë të noniusit me madhësi N (fig. 7.30). Për shembull $9L = 10N$ ose i përgjithshëm:

$$(n-1) \cdot L = n \cdot N \Rightarrow L - N = \frac{L}{n}. \quad (7.6.)$$




Fig. 7.30. Noniusi.

Vlera më e vogël e cila mund të lexohet me ndihmën e noniusit quhet e *dhënë nonusoide* P . Kjo mund të përcaktohet si ndryshim i vler-

ave të të dhënës më të vogël të masës dhe noniusit ose si herësi i të dhënës më të vogël nga masa dhe numri i ndarjeve të noniusit:

$$P = L - N = \frac{L}{n}. \quad (7.7.)$$

Shembull 7.1: Të përcaktohet e dhëna e noniusit kur ndarja më e vogël e masës është $L = 2 \text{ mm}$, kurse numri i ndarjeve të noniusit është $n = 20$.

Zgjidhje:

$$P = \frac{l}{n} = \frac{2\text{mm}}{20} = 0,1\text{mm}.$$

Shembull 7.2: E dhëna më e vogël e masës është $L = 1\text{mm}$. Sa numra të ndarjeve n duhet të ketë noniusi për të dhënë nonusoide të jetë $P = 0,05 \text{ mm}$?

Zgjidhje:

$$n = \frac{L}{P} = \frac{1\text{mm}}{0,05\text{mm}} = 20.$$

Përcaktimi i të dhënës nonusoide bëhet sipas formulës:

$$P = \frac{L}{n}. \quad (7.8.)$$

Prandaj para shfrytëzimit të noniusit mirë duhet të analizohet ndarja e masës që të shikohet sa është vlera e të dhënës më të vogël të ndarjes (L) dhe të përcaktohet numri i ndarjeve të noniusit (n). E dhëna nonusoide mund të përcaktohet edhe me vëzhgim. Nëse dihet se vlera e tërë noniusit përgjigjet në ndarjen më të vogël të masës, vëzhgohet e dhëna nonusoide dhe bëhet krahasimi i ndarjes së masës dhe noniusit. Kur është e përcaktuar e dhëna nonusoide, ndarjen mund ta lexojmë me ndihmën e noniusit siç është treguar në fig. 7.31.




Fig. 7.31. Llojet e leximit.

Ndarja e noniusit pozitiv rritet në kahjen e njëjtë si edhe ndarja e masës. Fillimi i noniusit është shënuar me vlerën zero. Në masë lexohen ndarjet e plota deri te zeroja e noniusit (fig. 7.31.), e pastaj kërkohet viza e ndarjes. Sipas kësaj, leximi i ndarjes me ndihmën e noniusit përbëhet nga dy pjesë:

$$\beta = a + b \quad (7.9.)$$

ku janë:

- a - lexim i ndarjes së masës deri te zeroja e noniusit e përfshirë me vlerën e ndarjes më të vogël të limbës;
- b - mbetja e cila lexohet me ndihmën e noniusit.

Vlera a lexohet drejtpërdrejtë në limbë, kurse vlera b lexohet me ndihmën e noniusit. Në atë mënyrë numërohen ndarjet e noniusit nga zeroja deri tek ajo vizë e noniusit e cila koïncidon me një vizë nga masa. Nëse numri i ndarjeve shumëzohet me të dhënë e noniusit, do të fitohet leximi i noniusit.

Leximi me noniusin rrethor në thelb është e njëjtë si edhe leximi me ndihmën e noniunit linear. Në fig. 7.32. është treguar leximi me noni-
us rrethor.




Fig. 7.32. Leximi me noniusin rrethor.

Sipas fig. 7.32. e dhëna e noniunit është:

$$P = \frac{L}{n} = \frac{20'}{60} = \frac{20 \cdot 60''}{60} = 20''.$$

Numërimi e ndarjeve të noniunit do të ishte i mundimshëm, punë jo e sigurt dhe e kontestuar. Secila ndarje e tretë e noniunit me nga $20''$ paraqesin $1'$, prandaj secila vizë e tretë e noniunit është më e gjatë, e në çdo të pestën minutë është shënuar me numër. Në këtë mënyrë leximi thjeshtësohet.

Për konstruksionin (negativ) të noniunit merret $(n + 1)$ ndarja nga masa, dhe ndahen me n , ndarje nga noniusi. Ndarja e noniunit të për-
pamë rritet në drejtim të kundërt në raport të ndarjes së masës, dhe prandaj ndarja e këtillë nuk ka aplikim të gjerë në praktikë.

Ndarja e limbës dhe noniunit është shumë e imët dhe me sy nuk mund të lexohet direkt, kështu që leximi bëhet me ndihmën e llupës ose mikroskopit.

7.7.2. Mikroskopi me vizë

Mikroskopi me vizë ka penjëzor i cili përbëhet nga një vizë me ndihmën e së cilës lexohet ndarja e limbës. Secila shkallë e limbës është shënuar me numër, kurse ndarja më e vogël e limbës është $10'$ ose $20'$. Në pjesën e brendshme të ndarjes me vlerësimin e syrit, mund të lexohet

pjesa e dhjetë nga ndarja, respektivisht, 1' ose 2'. E qartë është se para se të bëhet leximi i ndarjes së limbës, viza e mikroskopit duhet të sillet në largësi me shikim të qartë. Ajo arrihet me rrotullimin e gypit okular të mikroskopit. Përveç asaj, me vëzhgimin në mikroskop duhet të dihet ndarja e limbës dhe të përcaktohet e dhëna e saj më e vogël.

Me zhvendosjen e syrit majtas-djathtas para okularit do të vërte-tohet nëse ekziston paralaksa penjzore, ose nëse ndarja e limbës është në rrafsh të penjzorit. Nëse ekziston penjzori paralaks, ai anulohet me ndihmën e afrimit ose largimit në tërë mikroskopin në raport të ndarjes së limbës.




Fig. 7.33. Mikroskopi me vizë.

Ndarja, e treguar në fig. 7.33. (a dhe b), lexohet shumë thjesht. Sipas rregullës, teodoliti duhet të ketë dy mikroskopë të vendosur në një (diametër) të alkidadës, që të mënjanohet ndikimi të ekstrencitetit të alkidadës. Mikroskopi me vizë duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

Kushti i parë: Viza e penjzorit duhet të jetë paralele me vizat e ndarjes së limbës. Analiza e këtij kushti bëhet me vëzhgimin dhe krahasimin e vizave të penjzorit me vizën më të afërt nga ndarja e limbës. Nëse kushti nuk është i kënaqur, i tërë mikroskopi duhet pak të rrotullohet përreth boshtit të gjatësisë, pas lirimimit të vidave të cilat e shtrëngojnë mikroskopin.

Kushti i dytë: Ndryshimet e leximeve nga dy vende diametralisht të kundërta të limbës duhet të dallohen për 180° (200^{gr}). Që të mund të analizohet ky kusht, duhet që viza e një mikroskopi të vendoset në leximin e rrethuar, e pastaj të kontrollohet leximi i mikroskopit tjetër i

cili duhet të dallohet për 180° (200^{gr}). Rektifikimi bëhet me zhvendosjen e penjëzorit të njërit mikroskop me ndihmën e vidave të veçanta (fig. 7.34.).




Fig. 7.34. Vida në mikroskop me vizë për rektifikim.

7.7.3. Mikroskop me shkallë të vizave

E dhëna më e vogël e cila mund të lexohet me ndihmën e mikroskopicit të vizave është 1-2, edhe atë me vlerësimin e syrit.

Prandaj është e mundur, çdoherë për shkak të vlerësimit nga syri, të bëhet gabim prej 1 ose 2. Ky gabim mund të mënjanohet nëse shfrytëzohet mikroskop me shkallë të vizave. Në të vërtetë, në vend të një vize, penjëzori i mikroskopit ka shkallë prej vizave e cila i përgjigjet ndarjes më të vogël nga limba. Me ndihmën e shkallës prej vizave mund të lexohen minutat, kurse nga syri të vlerësohet pjesa e dhjetë e minutës. Me të sigurohet saktësi më e madhe e leximit të ndarjes së limbës.




Fig. 7.35. Mikroskop me shkallë prej vizave – tip i vjetër.




Fig. 7.35. Mikroskop me shkallë prej vizave – tip i ri.

Te tipat e vjetër të instrumenteve gjatësia e shkallës së vizave është 10 ose 20 (fig. 7.35.), kurse tek instrumentet me konstrukcion gjatësia e shkallës është një shkallë, që paraqet edhe të dhënën më të vogël të limbës. Me ndihmën e sistemit të prizmeve dhe pasqyrave, format e ndarjes së limbës horizontale dhe vertikale janë paraqitur në fushën e dukshme të mikroskopit okulari i të cilit gjendet përreth okularit të dylbisë (fig. 7.36.). Shkalla e vizave të mikroskopit e pret vetëm një vizë që e përcakton shkallën e tërë.

Lexohet, ashtu që për shkallë merret ajo vlerë e shkallës e cila vizë e pret shkallën prej vizave, kurse në shkallën prej vizave me atë vizë lexohet numri i minutave dhe pjesët e një minute. Te disa lloje të vjetra të teodoliteve, e dhëna më e vogël e limbës është $2'$, kurse shkalla prej vizave ka 10 ndarje. Sipas asaj në atë rast ndarja më e vogël e shkallës është $2'$, kurse me vlerësim nga syri lexohet vlera prej $0,2$. Ngase leximi bëhet me dy mikroskopë (majtas-djathtas), për vlerë definitive merret vlera e mesme nga dy leximet, pastaj merren shkallët nga mikroskopi i majtë, kurse mesi llogaritet vetëm për minutat dhe pjesët e minutave.

Mikroskopi me shkallë prej vizave duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

Kushti i parë: Vizat e ndarjes nga shkalla e vizave duhet të jenë paralele me vizat e ndarjes prej limbës. Analiza dhe rektifikimi i këtij kushti është shpjeguar në kapitullin 7.8.2

Kushti i dytë: Forma e shkallës së vizave duhet të jetë e barabartë me formën e ndarjes më të vogël të limbës. Analiza bëhet, ashtu që fil-

limi i shkallës prej vizave vendoset që të përputhet me fillimin e një vize prej limbës.

Kushti do të jetë i kënaqur nëse gjatë asaj përputhen viza përfundimtare prej shkallëve dhe viza e ardhshme e limbës. Kur rasti nuk është i tillë, atëherë kushti nuk është i kënaqur, sepse forma e shkallës prej vizave është më e gjatë ose më e shkurtë nga forma më e vogël e ndarjes së limbës (fig. 7.37.).




Fig. 7.37. Paralaksa te mikroskopi me shkallë prej vizave.

Rektifikimi i këtij kushti, respektivisht ndryshimi i zmadhimit të mikroskopit arrihet me largim e gypit të objektivit, deri sa nuk arrihet viza përfundimtare e shkallës prej vizave që të përputhet me vizën e ardhshme nga ndarja e limbës. Gjatë kësaj procedure do të paraqitet edhe penjzori paralaks i mikroskopit, respektivisht rrafshi i formës së ndarjes nuk do të gjendet në rrafshin e penjzorit. Eliminimi i paralaksit penjzori arrihet me ndryshimin e gjatësisë së mikroskopit, respektivisht me afrimin ose largimin e mikroskopit të limbës. Kushti i parë dhe i dytë analizohet veçanërisht për çdo mikroskop.

Kushti i tretë: Ndryshimi i leximeve të mikroskopëve diametralisht të kundërt duhet të jetë 180° (200^{gr}). Kushti analizohet dhe rektifikohet në mënyrë identike si te mikroskopi me vizë.

7.7.4. Mikroskop me nonius

Mikroskopi me nonius (fig. 7.38.) në rrafshin e penjëzorit përmban nonius. Leximi i ndarjes së limbës me ndihmën e noniusit është më i shpjeguar, kurse kushtet që ky mikroskop duhet t'i përmbushë janë të njëjta edhe te mikroskopi me shkallë prej vizave.




Fig. 7.38. Mikroskopi me nonius.

7.7.5. Mikroskop me mikrometër optik

Me ndihmën e mikroskopëve të përshkruar në kapitujt e mëparshëm mund të lexohet ndarja e limbës me saktësi prej 0,1.

Më saktësisht leximin e limbës e mundëson mikroskopi me mikrometër optik. Të gjitha instrumentet bashkëkohore të cilat kanë limbë prej qelqi, kanë edhe mikroskop me mikrometër optik.

Mikrometri optik përbëhet prej sistemit optik kompleks ku element themelor është pllaka planparalele ose pyka optike.

A) *Pllaka planparalele*

Pllaka planparalele është plakë prej qelqi me dy anë paralele.

Kur rrezja e ndritshme bie nën kënd të drejtë të pllakës planparalele (në rrafshin e hapësirës AA), e vazhdon lëvizjen dhe nuk e ndërron kahjen e tij (fig. 7.39.).




Fig. 7.39. Pllaka planparalele.

Nëse pllaka planparalele rrotullohet për kënd a , rrezja ndriçuese nuk do të bjerë nën këndin e drejtë, por me normalen do të zërë këndin a . Ngase rrezja kalon nga mesi më i rrallë optik në mes optik më të trashë (nga ajri në qelq), do të thyhet kah normalja e anës AA nën kënd β ($a > \beta$) dhe do ta vazhdojë lëvizjen e saj deri te rrafshi BB , që bie nën këndin β në raport me normalen, ku prapë do të thyhet nën kënd a nga normalja, sepse kalon prej mesit optik të trashë në mes optik më të rrallë (nga qelqi në ajër).

Ngase këndi hyrës dhe këndi dalës kah normalja ndërmjet tyre janë të njëjtë, do të thotë se rrezja hyrëse dhe dalëse ndërmjet tyre do të jenë paralele. Sipas asaj rrotullimi i pllakës planparalele shkakton zhvendosje paralele të rrezes ndriçuese. Rrezja pas daljes nga pllaka planparalele e mban drejtimin që e ka pasur para se të bjerë në të, vetëm është zhvendosur në mënyrë translatore për vlerën e . Nëse rrotullimi i pllakës është më i madh, atëherë edhe vlera e do të jetë më e madhe.

Rrezja nëpërmjet pllakës planparalele e kalon rrugën $A_1 \rightarrow B_1$ (fig. 7.39), respektivisht:

$$\overline{A_1 B_1} = \frac{d}{\cos \beta}, \quad (7.10.)$$

kurse pas daljes në mënyrë translatore do të zhvendoset për madhësinë e , e cila është:

$$e = d \cdot \frac{\sin(\alpha - \beta)}{\cos \beta} = d \cdot (\sin \alpha - \cos \alpha \cdot \operatorname{tg} \beta). \quad (7.11.)$$

Ngase këndet α dhe β janë të vogla, mund t'i bëjmë këto zëvendësime:

$$\sin \alpha = \alpha \quad \cos \alpha = 1 \quad \cos \beta = 1, \quad (7.12.)$$

me çka fitohet:

$$\sin \beta = \frac{1}{n} \cdot \sin \alpha = \frac{1}{n} \cdot \alpha$$

dhe me zëvendësimin në (7.11.) përcaktohet zhvendosja e shenjës e , respektivisht:

$$e = d \cdot \left(\alpha - \frac{1}{n} \cdot \alpha \right) = d \cdot \alpha \cdot \frac{n-1}{n}. \quad (7.13.)$$

Në bazë të formulës (7.13) mund të përfundohet se zhvendosja varet nga:

- trashësia e pllakës planparalele d ;
- këndi i rrotullimit të pllakës planparalele α ;
- lloji i qelqit, respektivisht indeksi i tij i thyerjes n ;

B) Mikrometër optik

Mikrometri optik me pllakën planparalele në rrafshin e penjëzorit ka një ose dy viza të afërta paralele. Ndërmjet thjerrzës objektive të mikroskopit dhe penjëzorit gjendet pllaka planparalele të cilën mund ta rrotullojmë rreth boshtit të tij. Për boshtin e pllakës planparalele është i lidhur dhëmbëzori i cili mbështetet në dhëmbëzor më të vogël të barabanit të mikrometrit optik (fig. 7.40.).





Fig. 7.40. Mikrometri optik me pllakë planparalele.

Forma e ndarjes së limbës, të cilën e krijon thjerrëza objektive e mikroskopit, nuk do të përputhet me vizën indekse të penjësorit. Duke vepruar në baraban (me rrotullim, majtas ose djathtas) të mikrometrit optik, pllaka planparalele rrotullohet, kurse forma e ndarjes nuk përputhet me vizën e penjësorit ose, në anën tjetër, nuk merret pozitë simetrike në raport të dy vizave të afërta të penjësorit. (fig 7.43.). Një rreth i plotë i barabanit (rrotës) nga mikrometri optik i përgjigjet ndarjes më të vogël të limbës dhe shpeshherë është 1° . Në barabanin e mikrometrit optik shkalla ndahet në pjesë më të vogla, respektivisht në minuta dhe sekonda. Mënyra e përshkruar e leximit zbatohet tek instrumentet e firmës WILD T1 (fig. 7.41.). Me ndihmën e këtij mikrometri optik lexohet vetëm te një vend i ndarjes së limbës, prandaj me atë lexim është ngarkuar me gabimin i cili ndodh për shkak ekscentritetit të alkidadës.



leximi:
 $a = 87^\circ$
 $b = 27'09''$
 $\beta = a + b = 87^\circ 27'09''$

Fig. 7.41. Leximi i mikrometrit optik me pllakë planparalele.

Nëse e lexojmë ndarjen e skajeve diametralisht të kundërta të limbës, si rezultat merret mesi aritmetik nga vlerat, e cila është i lirë nga gabimi për shkak të ekstrencitetit të alkidadës. Që të mënjanohet ky gabim, tek instrumentet e kushtuara për matje këndore precize është prodhuar mikrometër optik i cili mundëson drejtpërdrejt të lexohet vlera e cila i përgjigjet mesit të leximit të dy skajeve diametralisht të kundërta të limbës.

Kjo do të thotë se në rrafshin e dukshëm të okularit të mikroskopit duhet të paraqiten format e ndarjeve diametralisht të kundërta të limbës. Me ndihmën e sistemit optik të përbërë nga prizmat, pasqyra, format e ndarjes diametralisht të kundërta të limbës fotografohen në një vend në fushën e dukshme të mikroskopit. Vizat e skajeve diametralisht të kundërta të limbës nuk do të përputhen me vizën indekse të penjësorit të mikroskopit. Vizat e njërit skaj të ndarjes së limbës do të gjenden djathtas nga viza indekse e penjësorit të mikroskopit, ndërsa vizat e skajeve diametralisht të kundërta të limbës do të jenë në distancë të njëjtë nga viza indekse, por në anën e djathtë. Në rrugën prej objektivit të mikroskopit deri te penjësori, rrezet të cilat e sjellin formën e skajeve diametralisht të kundërta të limbës kalojnë nëpërmjet dy pllakave planparalele. Që format e vizave të skajeve diametralisht të kundërta të limbës të mund të sillen dhe të koïncidohen me vizën indekse të penjësorit të mikrometrit optik, si dhe të përputhen ndërmjet veti, duhet të zhvendosen për madhësi të njëjtë, por në drejtim të kundërt. Kjo mundësohet me rrotullim të kundërt të pllakave planparalele (fig. 7.42) përmes të cilave kalojnë format diametralisht të kundërta të limbës.




Fig. 7.42. *Koincidimi me pllakë planparalele.*

Procedurë e leximit: Në një pjesë të fushës së dukshme të mikroskopit janë fotografuar format e skajeve diametralisht të kundërta të limbës dhe viza indekse e penjzorit të mikroskopit, kurse në pjesën tjetër ndarja e barabanit të mikrometrit optik ((fig. 7.43). Më së pari shihet ndarja e limbës, për shembull, shkalla është e ndarë në tri pjesë me ndarje më të vogël 20' (si te teodolitet WildT2). Pastaj, duke vepruar në baraban (me rrotullim) të mikrometrit optik, vizat e skajeve diametralisht të kundërta të limbës sillen të koincidojnë. Ndërsa, viza indekse e penjzorit të mikroskopit ose do të koincidojë me vizat e ndarjes së limbës ose do të jetë në mes ndërmjet dy vizave fqinje të ndarjes së limbës.

Distanca nga vizat fqinje të ndarjes së limbës deri te viza indekse e mikroskopit është dy herë më e vogël sesa viza e skajeve diametralisht të kundërta të ndarjes së limbës, pra në vend 20' ndarja më e vogël e limbës duhet të konsiderohet se është 10', kur lexohet me ndihmën e ndarjeve diametralisht të kundërta të limbës. Sipas kësaj, leximin mund ta kryejmë me indeksin e ndarjeve dhe atëherë ndarja më e vogël e limbës është 20' ose me skajet diametralisht të kundërta të ndarjes së limbës dhe atëherë ndarja më e vogël e limbës është 10'. Procedura e leximit përbëhet prej tri pjesëve (fig. 7.43.):




Fig. 7.43. Leximi i instrumenteve Wild.

- lexohen vlerat e shkallëve të plota (numri i cili është i pari nga ana e majtë e vijës indeks të mikroskopit), domethënë numri 265, i treguar në fig. 7.43a;
- numërohen fushat e vizave të shkallës së lexuar deri te viza e shkallës diametrikisht të kundërt të ndarjes së limbës dhe llogariten nga $10'$;
- në boshtin e mikrometrit optik lexohen vlerat e minutave të plota (prej 0 deri 9, të shënuara me numra në pjesën e poshtme), pastaj lexohen sekondat dhe pjesët e dhjeta të sekondës.

Në mënyrën e përshkruar lexohet ndarja e limbës tek instrumentet nga firma Wild (T2, T3, dhe T4).

B) Mikrometri optik me pykë optike

Pyka optike është prizëm prej qelqi e përpunuar në formë të pykës (fig. 7.44)




Fig. 7.44. Pyka optike.

Lëvizja e rrezes përmes pykës është treguar në fig. 7.45.




Fig. 7.45. Lëvizje e dritës përmes pykës optike.

Nga trekëndëshi ABD në fig. 7.45. rrjedh:

$$\gamma = (\alpha - \alpha') + (\beta - \beta') \quad (7.14.)$$

respektivisht:

$$\gamma = (\alpha + \beta) - (\alpha' + \beta'). \quad (7.15.)$$

Nëse në barazimin e fundit i ndërrojmë vlera e ardhshme:

$$\begin{aligned} \sin \alpha &= n \cdot \sin \alpha' & \alpha &= n \cdot \alpha' \\ \sin \beta &= n \cdot \sin \beta' & \beta &= n \cdot \beta' \end{aligned}$$

do të fitojmë:

$$\gamma = n \cdot (\alpha' + \beta') - (\alpha' + \beta') = (\alpha' + \beta') \cdot (n - 1). \quad (7.16.)$$

Nga trekëndëshi $\triangle ABC$ në fig. 7.45. rrjedh:

$$\theta + (90^\circ - \alpha') + (90^\circ - \beta') = 180^\circ, \quad (7.17.)$$

respektivisht:

$$\theta = \alpha' + \beta'. \quad (7.18.)$$

Pas zëvendësimit të formulës (7.18) në shprehjen për γ (7.16.) do të fitohet vlera e këndit për të cilën rrezja hyrëse përthyeret kah normalja pas daljes së pykës optike:

$$\gamma = \theta(n - 1). \quad (7.19.)$$

Domethënë, përthyerja e rrezes varet nga forma e pykës (këndi pranë kulmit 0) dhe nga lloji i qelqit (indeksi i thyerjes n). Zhvendosja lineare e_i në raport me kahjen të cilën rrezja do ta mbante nëse nuk kishte kaluar nëpërmjet pykës (pozita zero e rrezes), varet nga këndi i përthyer dhe nga largësia e pykës optike S_i (fig. 7.46) në rrafshin R, respektivisht:

$$e_i = S_i \cdot \operatorname{tg} \gamma. \quad (7.20.)$$




Fig. 7.46. Zhvendosja lineare.

Prandaj zhvendosja e pykës optike në kahjen e lëvizjes së rrezes në ndonjë rrafsh π , do të zëvendësohet për vlera të vogla të përthyerjes lineare së rrezes e_i në raport të pozitës zero.

Në atë rast, njëjtë si te mikrometri optik me pllakën planparalele, ndërmjet thjerrrës objektive të mikroskopit dhe penjëzorit të mikroskopit të vendosur është pyka optike. Me zhvendosjen e pykës optike përgjatë gjatësisë së mikroskopit mund të sillen vizat e ndarjes së limbës që të përputhen me vizën indekse të penjëzorit të mikroskopit. Në vizore të mikroskopit optik në fushën e dukshme të mikroskopit lexohet vlera e ndarjes së vizores e shprehur në sekonda (fig. 7.47. b dhe c)

Procedura e leximi është si vijon:

- së pari vërehet vlera e ndarjes më të vogël e limbës (fig. 7.48. ndarja më e vogël e limbës është $20''$);
- ekuilibrohen format e vizave të skajeve diametralisht të kundërta të ndarjes së limbës që të koïncidohet (ndarja e parë ka numra të shënuar vertikalisht në shkallët, kurse te ndarja tjetër numrat janë të kthyer);




Fig. 7.47. Leximi me ndihmën e pykës optike.

- vërehen të dy numrat diametralisht të kundërt të shkallëve të ndarjes së limbës, ku njëri është numër i shënuar vertikalisht nga ana e majtë deri te numri i kundërt i shënuar;




Fig. 7.48. Ndarja e limbës e sjellë në fushë të dukshme me ndihmën e pykës optike.

- shkalla e numrit i cili është shënuar drejt;
- numërohen numrat e ndarjes nga ai numër deri te numri i cili është diametralisht i kundërt me të, me atë që vlera e ndarjeve llogaritet dy herë më e vogël nga vlera e vërtetë (për 10^3);
- në vizore nga mikrometri optik lexohen minutat e plotë dhe sekondat.

C) Limba me ndarje të dyfishtë

Disa firma (për shembull Kern) përpunojnë limba me rrathë të dyfishtë. Në limbë janë të futura dy ndarje:

- ndarja e jashtme ose ndarja kryesore ku shkallët janë shënuar me numra të përshtatshëm dhe ata janë të ndarë në ndarje më të vogla prej nga 10' ose 20';
- ndarja e brendshme ose ndarja ndihmëse ku të gjitha shkallët janë të shënuara me viza dhe nuk janë shënuar numrat e shkallëve. E dhëna më e vogël e ndarjes ndihmëse ndonjëherë është një shkallë. Te disa limba ndarja ndihmëse është shënuar me viza të dyfishta. Ndarja ndihmëse shërben si indeks për lexim preciz të ndarjes kryesore (fig. 7.49.).




Fig. 7.49. Limba me ndarje të dyfishtë.

Karakteristikat e limbave të atillë, si dhe procedura e leximit të tyre këtu nuk do të shpjegohen.

D) Limba elektronike

Me paraqitjen e stacioneve të përgjithshme (për të cilat do të bëhet fjalë më vonë) paraqiten edhe limbat elektronike. Ato njëjtë përpunohen

prej qelqi, por ndarja e tyre është bërë ngjyrim alternativ të qelqit me ngjyrë të hapur dhe të mbyllur (njëjtë si te barkodet të cilat janë te çdo prodhim) dhe leximi bëhet me ndihmën e fotodiodës. Kur fotodioda do të bëhet me sistemin e njohjes së fushave, për të cilët tash nuk do të bëhet fjalë, në ekranin e stacionit të përgjithshëm shënohet vlera numerike e kahjes horizontale dhe vertikale.




Fig. 7.50. Pamja e limbës elektronike.

7.8. VIJËZIMI

Nën nocionin vijëzim nënkuptohet procedura në të cilën vizura sillet në kahjen e ndonjë pike ose objekti. Procedura e vijëzimit përbëhet nga vijëzimi i ashpër dhe vijëzimi i saktë. Vijëzimi i ashpër do të thotë se vizura sillet afërsisht në kahjen e objektit të vrojtuar me ndihmën e shënjestrës speciale (ngjashëm si shënjestra e pushkës), e cila gjendet mbi dylbinë. Te disa instrumente shënjestra përbëhet nga gypi i shkurtër

nëpër të cilën shihet një trekëndësh ose drejtëz në bazament të errët. Gjatë vijëzimit të ashpër është e nevojshme të lirohet penjzori i alkidadës dhe dylbisë. Pastaj dylbia mund të vendoset në kahjen e dëshiruar. Me njëren dorë mbahet penjzori i alkidadës, kurse me tjetrën mbahet dylbia (menjëherë pas okularit) dhe me ndihmën e shënjestrës futet vizura sa më mirë në kahjen e objektit vrojtues.

Nëse punohet me kujdes, në fushën dukshme të dylbisë do të shihet shëmbëllimi i objektit vrojtues. Me këtë ka përfunduar vijëzimi i ashpër.

Vijëzim i saktë do të thotë sjellja precize e vizurës në drejtimin e dëshiruar. Pas vijëzimit të ashpër është e nevojshme që vizura të zhvendoset në horizontale dhe në vertikale. Lëvizjet e tilla të vizurës arrihen me ndihmën e vidave mikrometrike 10 dhe 14, të cilat funksionojnë vetëm nëse frenohen frenat e alkidadës 9 dhe dylbia 13, të treguara në fig. 7.3.

Posaçërisht duhet theksuar se ekzistojnë vida për zhvendosje të ashpër dhe precize të vizurës. Me ato horizontalisht zhvendoset alkidadë, kurse vertikalisht dylbia. Gjatë vijëzimit të saktë duhet mbajtur llogari që rrotullimi i vidës mikroskopike të jetë në kahjen e lëvizjes së akrepave të orës. Shkaku për rrotullimin e tillë të vidës mikroskopike mund të shihet nga figura 7.29. Vida mikrometrike gjatë zhvendosjes së boshtit të përforcuesit ose e mbledh spiralen e vet ose e lëshon. Nëse rrotullimin e fundit të vidës mikrometrike e bëjmë në kahjen e kundërt të lëvizjes së akrepave të orës, spiralja do të zgjatet. Megjithatë, lëshimi i spirales nuk do të bëhet në të njëjtin moment, por do të bëhet edhe pas ndalimit të lëvizjes së vidës mikrometrike. Prandaj, në ndërkohë mund të ndodhë që gjatë leximit të ndarjes këndore, vizura “vetë” të zhvendoset nga pika e vijëzuar. Zhvendosja e tillë ndodh për shkak veprimit të vonuar të vidës mikrometrike. Prandaj, me të drejtë, lëvizja e fundit që e bëjmë me vidën mikrometrike duhet të jetë në kahjen e lëvizjes së akrepave të orës, sepse spiralja atëherë mblidhet dhe nuk mund të vijë te veprimi i vonuar i së njëjtës. Lëvizjet e cilat i bëjmë me duart tona nuk janë të përsosura, prandaj është e mundur që gjatë vijëzimit të ndodhë vizura ta kalojë pikën të cilën e vijëzojmë. Në këtë rast duhet të përsëritet vijëzimi i saktë

kur vida mikrometrike do të rrotullohet në kahjen e kundërt të lëvizjes së akrepave të orës.

7.9. REKTIFIKIMI I TEODOLITIT

Siç është e ditur, me ndihmën e teodolitit maten këndet horizontale. Prandaj, kur bëhen matjet e këndeve horizontale, ndarja e limbës patjetër duhet të shtrihet në rrafshin horizontal, kurse vizura gjatë rrotullimit të dybisë rreth boshtit të saj të rrotullimit e përshkruan rrafshin vertikal. Teodoliti duhet t'i kënaqë këto kushte.

Kushti i parë: Boshti i libelës në alkidadë duhet të jetë normal me boshtin alkidad, respektivisht boshti alkidad duhet të jetë vertikal në hapësirë.

Kontrollimi i kushtit të parë. Kur do ta kontrollojmë dhe do ta përforcojmë teodolitin në stativ, me veprim të vidave pozicionuese të instrumentit instrumentin e vendosim afërsisht në pozitën horizontale (e sjellim flluskën në libelën e qendëruar që të lëvizë). Pastaj e kontrollojmë kushtin.

Duke e lëvizur alkidadën e sjellim libelën gypore, e cila gjendet në alkidadë që të jetë afërsisht paralele me boshtin e paramenduar të të dy (cilado qofshin) vidave pozicionuese (fig. 7.51.).

Me ndihmën e atyre dy vidave e sjellim flluskën në libelën gypore që të lëvizë {vidat pozicionuese rrotullohen në kahje të kundërta (fig. 7.51.)}. Pastaj alkidadën e rrotullojmë për 180° , e bashkë me atë rrotullohet edhe libela gypore që ta marrë pozicionin i cili do të jetë afërsisht paralel me pozitën vet të mëparshme (fig. 7.51.). Në pozitën re, nëse flluska e libelës lëviz, kushti është kënaqur. Nëse flluska e libelës shmanget, atëherë shmangia e tillë është e dyfishtë (fig. 7.52.).




Fig. 7.51. Procedura për kontrollim të kushtit të parë.




Fig. 7.52. Ndodhja e shmangies së dyfishtë.

Njëra gjysmë e shmangies së fluskës së libelës është bërë nga ajo se boshti alkidad nuk është vertikal, kurse gjysma tjetër është bërë nga ajo se boshti i libelës nuk është normal me boshtin alkidad. Shmangia e fluskës së libelës mënjanohet varësisht nga shkaku nga i cili është bërë shmangia. Gjysma e shmangies përmirësohet me vida korrektuese të libelës, kurse gjysma tjetër me vidat pozicionuese. Ngase shmangia në tërësi nuk mund të përmirësohet me një procedurë, procedurën e përshkruar e përsërisim shumë herë, respektivisht e përsërisim procedurën, kurse shmangia e fluskës së libelës nga të dy pozicionet nuk është më e madhe se gjysma e ndarjes së libelës gypore. Që boshti alkidad të mund të sillet në pozitën vertikale, mjafton që alkidadën ta rrotullojmë për

90°, ashtu që libela gypore të vijë në kahjen e vidës së tretë pozicionuese dhe atëherë më vidën e njëjtë (të tretën) e sjellim fluskën në libelë që të lëvizë. Në të gjitha pozicionet e alkidadës së instrumentit, fluska në libelën gypore të mund të lëvizë. Nëse kjo nuk ndodh, e tërë procedura e rektifikimit përsëritet.

Kur kushti i parë është i kënaqur, fluska në libelën gypore do të lëvizë në të gjitha pozicionet e alkidadës. Atëherë boshti alkidad merr pozicionin vertikal në hapësirë, kurse ndarja e limbës dhe fluska e saj gjendet në rrafshin horizontal. Në kushte të tilla, nëse ekziston libelë qendërzuere edhe fluska e saj duhet të lëvizë. Nëse fluska e libelës rrotulluese nuk lëviz, kjo do të thotë se boshti në libelën qendërzuere nuk është paralel me boshtin alkidad. Rektifikimi i libelës qendërzuere qëndron në atë se fluska në libelë sillet që të lëvizë me ndihmën e vidave korrektuese të libelës rrotulluese.

Kur tek alkidadada ekzistojnë dy libela gypore, të cilat midis veti qëndrojnë në kënd prej 90°, kontrollimin dhe rektifikimin e saj mund t'i bëjmë së bashku, me atë që për kontrollimin e libelës së dytë duhet ta shfrytëzojmë vidën e tretë pozicionuese (fig. 7.53.).

Shpjegim: Është shumë me rëndësi që gjatë matjes së këndeve horizontale, limba të jetë horizontale, respektivisht boshti alkidad të jetë vertikal., kurse boshti alkidad nuk është vertikal, por me vertikalen zë këndin δ , atëherë vlerat e këndeve matëse do të ngarkohen me gabime të pashmangshme të cilat varen nga këndi δ . Gabimi i tillë (gabimi për shkak boshtit alkidad jo vertikal) nuk mund të mënjanohet me metodën e punës. Nëse këndi δ është më i madh, atëherë edhe vlera e gabimeve do të jetë më e madhe. Prandaj, kontrollimi dhe rektifikimi i kushtit të parë duhet të zbatohet me vetëdije. Gjatë matjes së këndeve është e nevojshme të bëhet kontrolli i fluskës në libelë. Nëse fluska në libelë shmanget më tepër se 2 deri 3 porsa, matjet ndërpriten, fluska në libelë sillet të lëvizë dhe përsëriten matjet e filluara.




Fig. 7.53. Pozita e alkidadës gjatë qendërimit.

Kushti i dytë: Vizura duhet të jetë normale në boshtin e rrotullimit të dylbisë.




Fig. 7.54. Vizura.

Siç është treguar, vizura është drejtëz e cila e lidh qendrën optike të thjerrëzës së objektivit dhe prerjen e penjve të penjëzorit. Unaza e penjëzorit, e me atë edhe penjëzori mund të zhvendosen me ndihmën e vidave korigjuese përkatëse (fig. 7.54.). Këndi c të cilin e formojnë normalja e boshtit rrotullues të dylbisë dhe vizura quhet *gabim kolimantik*. Ai na e jep informacionin për sa vizura shmanget nga normalja me boshtin rrotullues të dylbisë.

Normalja e vizurës dhe boshtit rrotullues të dylbisë mund të kontrollohet në dy mënyra: me ndihmën e gabimit të dyfishtë ose katërfishtë kolimatik.

A) Kontrollimi i gabimit të dyfishtë kolimatik

Pas rektifikimit të kushtit të parë dhe vendosjes së alkidadës në pozitë vertikale, kontrollohet normalja e vizurës me boshtin rrotullues të dylbisë. Në pozitën e parë të instrumentit (kur limba vertikale është nga ana e majtë të operatorit) vijëzohet një pikë, e cila afërsisht është në lartësi të njëjtë si edhe instrumenti (vizura të jetë afërsisht horizontale) në distancë prej 200 m nga instrumenti dhe lexohet ndarja e limbës horizontale (fig. 7.55.). Pastaj pikën e njëjtë e vijëzojmë në pozicionin e dytë të instrumentit (kur rrethi vertikal është nga ana e djathtë e operatorit) dhe përsëri bëhet leximi i limbës horizontale. Nëse leximet në pozicionin e parë ose të dytë të instrumentit ndryshojnë për 180° , kushti i dytë është i kënaqur. Nëse ndryshimi i leximit është më i vogël ose më i madh se 180° , ekziston gabimi kolimatik c i cili duhet të caktohet.




Fig. 7.55. Gabimi i dyfishtë kolimatik.

Nëse supozojmë se vizura nuk është normale me boshtin rrotullues të dylbisë dhe nëse me atë zë këndin prej $90^\circ - c$, dhe indeksi për lexim të ndarjes gjendet në kahjen e boshtit rrotullues të dylbisë. Kur do ta

vijëzohet pikën A në pozicionin e parë të dylbisë, indeksi për lexim do të jetë në pozicionin I, respektivisht do të jetë në raport me vizurën nën kënd prej $90^\circ - c$. Pastaj dylbinë e vendosim në pozicionin e dytë dhe përsëri vijëzohet pika A , kurse indeksi për lexim tash vjen në pozicionin II.

Nga fig. 7.55 shihet se ndryshimi i leximit:

$$2c = (II - 180^\circ) - I, \quad (7.21.)$$

paraqet gabim të dyfishtë kolimatik.

Leximet të cilat do të jenë liruar nga gabimi i dyfishtë klimatik do të fitohen nëse vlera e gabimit kolimatik në mënyrë algjebrike mbledhet me leximin e ndarjes së limbës nga pozita e parë e instrumentit ose zbritet nga vlera e leximit të ndarjes së limbës në pozitën e dytë. Sipas kësaj, nëse pika vijëzohet në të dy pozicionet e dylbisë, prandaj si vlerë definitive e leximeve të minutave dhe sekondave merret vlera mesatare nga pozicioni i parë dhe i dytë i dylbisë, do të fitohet vlera e cila është e liruar nga ndikimi e gabimit polimetrik.

Rektifikimi i këtij kushti bëhet në këtë mënyrë:

- llogaritet vlera e leximit, e ndrequr nga ndikimi i gabimit kolimatik;
- duke ndikuar në vidën mikrometrike të alkidadës bëhet leximi i cili është llogaritur, për ç'arsye vizura do të vendoset nga pika e vijëzuar;
- duke e vendosur unazën e penjëzorit me ndihmën e vidave korrigjuese, rregullohet vizura (me prerje të penjve) që ta qëllojë pikën e vijëzuar. Me këtë ka përfunduar rektifikimi i këtij kushti.

Shembulli 7.3: Gjatë kontrollimit të kushtit (normalja e vizurës me boshtin rrotullues të dylbisë), janë fituar këto rezultate të leximeve:

Pozicioni I - indeksi i majtë: $192^\circ 26', 8$; - indeksi i djathtë: $- 12^\circ 26', 6$

Pozicioni II - indeksi i majtë: $12^\circ 28', 4$; - indeksi i djathtë: $- 192^\circ 28', 6$.

Të njehsohet vlera e gabimit kolimatik:

leximi i mesëm në pozicionin I - $192^\circ 26', 7$

leximi i mesëm në pozicionin II - $12^\circ 28', 5$

$$\frac{2c = II - I = + 1',8}{c = \quad \quad + 0',9}$$

Leximet të cilat janë liruar nga ndikimi i gabimit kolimatik do të jenë:

- në pozicionin I të dylbisë - $192^{\circ}27', 6$
- në pozicionin II të dylbisë - $12^{\circ}27', 6$.

Shpjegimi nr. 1: Kur limba lexohet në dy vende diametrikisht të kundërta, e nëse si vlerë definitive të minutave dhe sekondave merret vlera e tyre mesatare, atëherë leximi është liruar nga ndikimi i ekscentricitetit të alkidadës.

Shpjegimi nr. 2: Kur pikat vijëzohen në të dy pozicionet dhe lexohet ndarja e limbës, e nëse si vlerë definitive të minutave dhe sekondave nga të dy pozicionet, atëherë fitojmë vlerën e liruar nga ndikimi i gabimit kolimatik

B) Kontrollimi me gabimin katërfishor kolimatik

Ngjashëm si edhe te kontrollimet me ndihmën e gabimit të dyfishtë kolimatik në pozicionin e parë të instrumentit duhet të vijëzohet një pikë, për shembull pika A. Pastaj, dylbia rrotullohet rreth boshtit të vet rrotullues dhe bëhet leximi i hatullës me ndihmën e vijës vertikale të penjëzorit l_1 . Hatulla vendoset në distancë pre rreth 40 m, ashtu që të shtrihet horizontalisht në terren dhe afërsisht të jetë normale me vizurën. Pastaj, pas pozicionit të dytë të instrumentit përsëri vijëzohet pika e njëjtë, e rrotullojmë dylbinë tash në pozicionin e parë dhe bëjmë leximin e hatullës l_2 . Nëse ndryshimi është $(l_1 - l_2) < 3 - 4$ mm, mund të themi se kushti është i kënaqur, d. M. Th. vizura është normale me bishtin rrotullues të dylbisë. Por, nëse $(l_1 - l_2) > 3 - 4$ mm kushti nuk është i kënaqur dhe duhet të bëhet rektifikimi.

Ndryshimi $l_1 - l_2$ ndodh për shkak të ekzistimit të gabimit të katërfishtë kolimatik $4c$ (fig. 7.56). Nëse supozojmë se vizura nuk është normale me boshtin rrotullues të dylbisë (O-O), por me atë zë këndin prej $90^\circ - c$, gjatë rrotullimit të dylbisë rreth boshtit të saj rrotullues do të përshkruajë konin, ndarësit e të cilit zënë këndin prej $180^\circ - 2c$. Prandaj

vizura në pozicionin e dytë do të jetë 180° për shumën e gabimit të dyfishtë kolimatik $2c$, prandaj në hatull do të fitohet leximi l_1 . Nëse pika A vijëzohet në pozicionin e dytë të dylbisë, boshti rrotullues i dylbisë do ta marrë pozicionin $O' - O'$.




Fig. 7.56. Gabimi katërfishor kolimatik.

Gjatë rrotullimit të dylbisë nga pozicioni i dytë në atë të parë, vizura do të shmanget për 180° me kënd $2c$ prandaj në hatull do të fitohet leximi l_2 . Sipas kësaj, këndi i qendëruar i cili përgjigjet në ndryshimin e leximeve $S - l_2$ është $4c$. Që të bëhet rektifikimi duhet të zhvendoset unaza penjëzore, kurse vijëza vertikale e penjëzorit nuk vendoset në leximin:

$$l = l_1 - \frac{l_1 - l_2}{4}.$$

Shembulli 7.4: Gjatë kontrollimit të vizurës dhe boshtit rrotues të dylbisë me vlerën e katërfishtë të gabimit kolimatik është vendosur hatulla horizontale në distancë prej $S = 40$ m nga instrumenti. Leximet të cilat janë fituar në hatull gjatë kontrollimeve janë:

$$\begin{aligned} \text{në pozicionin I të dylbisë } l_1 &= 1,270 \text{ m} \\ \text{në pozicionin II të dylbisë } l_2 &= 1,262 \text{ m} \\ l_1 - l_2 &= 0,008 \text{ m} \end{aligned}$$

Të llogaritet:

- vlera e gabimit kolimatik;
- të llogaritet leximi i cili duhet të bartet në hatull, duke e vendosur unazën penjzore që të eliminohet gabimi kolimatik, nëse pozicioni momental i leximit është l_2 .

Zgjidhje:

$$a) 4c = \frac{0,008}{40} \cdot 206265''$$

$$c = \frac{8}{160000} \cdot 206265'' = 10'',31,$$

$$b) l = l_2 + \frac{l_1 - l_2}{4} = 1,262 + 0,002 = 1,264m.$$

Ekzistojnë dy procedura për kontrollim të kushtit për normalitet të vizurës me bosht të kundërt të dylbisë. Këtu do të theksojmë disa karakteristika edhe të dy procedurave të kontrollimit.

Saktësia e kontrollimit të normalitetit të vizurës dhe boshtit rrotullues të dylbisë, me ndihmën e gabimit katërfishor kolimatik është:

$$c = \frac{1mm}{40000} \cdot 206265'' = 5'',2.$$

Kjo do të thotë se rektifikimi i kushtet për normalitet të vizurës dhe boshtit rrotullues të dylbisë nuk mund të zbatohet me gabim më të vogël se 5". Nëse saktësia e leximit është më e madhe se 5", atëherë kjo saktësi është krejtësisht e kënaqshme. Megjithatë, tek instrumentet precize (e dhëna noniusit të të cilit është 1") kërkohet saktësi më e madhe. Saktësinë e tillë mund ta realizojmë nëse e zbatojmë procedurën e gabimit të dyfishtë kolimatik.

Te teodolitet, te të cilat ndarja e limbës lexohet vetëm në një vend, e jo në dy vende diametrikisht të kundërta, leximi do të ngarkohet me ndikimin e ekscentricitetit të alkidadës. Kur ekziston ekscentriciteti i alkidadës, çdo lexim i ndarjes së limbës do të jetë më shumë ose më pak i ngarkuar me gabimin i cili ndodh për shkak të ekscentricitetit të alkidadës. Gjithashtu edhe ndryshimi i leximeve të ndarjes së limbës gjatë

vijëzimit të një pike të njëjtë në të dy pozicionet e instrumentit, përveç ngarkesës me vlerën e gabimit të dyfishtë kolimatik do të jetë ngarkuar edhe nga ndikimi i ekscentricitetit të alkidadës. Në këtë mënyrë, mund të fitojmë përshtypje të gabuar për gabimin kolimatik varësisht nga vendi ku bëhet leximi i ndarjes së limbës (gjatë kohës së kontrollimit). Sipas kësaj, kushti i normalitetit të vizurës dhe boshtit rrotullues të dylbisë te teodolitet, ku ndarja e limbës lexohet në një vend, duhet të ndreqet me ndihmën e gabimit të katërfishtë kolimatik. Ky konstatim vlen edhe për teodolitet, e dhëna e noniusit të të së cilës është 20" - 30".

Në të gjitha rastet e tjera kontrollimi duhet të bëhet me ndihmën e gabimit të dyfishtë kolimatik.

Nëse me kontrollim dhe rektifikim nuk është mënjanuar plotësisht gabimi kolimatik, ndikimi i tij në rezultatet nga matja e këndeve, siç u tha më parë, do të mënjanohet me llogaritje të vlerave mesatare të leximeve për minutat dhe sekondat e fituara në të dy pozita të instrumentit.

Kushti i dytë: Vijëza "vertikale" e penjësorit me të vërtetë duhet të ketë pozicion vertikal.

Ky kusht kontrollohet në atë mënyrë që me vijëzën vertikale të penjësorit do të vijëzohet ndonjë pikë, prandaj me lëvizjen e dylbisë rreth boshtit të saj të rrotullimit përcillet vallë vijëza vertikale gjatë tërë kohës kalon nëpër pikën e vijëzuar. Nëse ajo nuk kalon, atëherë është e nevojshme që të rrotullohet unaza penjësore. Në këtë rast vida K_3 , në fig. 7.19. do të lëshohet dhe rrotullimi i unazës penjësore do të bëhet, kurse nuk e arrin vijëzën vertikale të penjësorit që gjithmonë të kalojë nëpër pikën e vijëzuar.

Kushti i tretë: Boshti rrotullues i dylbisë patjetër duhet të jetë normal me boshtin alkidad.

Kur do të kënaqen të dy kushtet e para gjatë rrotullimit të dylbisë se boshtit të vetë të rrotullimit, vizura përshkruan një rrafsh. Nëse me këtë rast, boshti rrotullues është normal me alkidadën, respektivisht nëse boshti rrotullues është horizontal, vizura do të përshkruajë rrafshin i cili është lakuar prej vertikales nën këndin e njëjtë nën të cilin është lakuar boshti rrotullues deri në horizont.

Që të mund ky kusht të kontrollohet, është e nevojshme në ndonjë objekt të lartë (ndërtesë, vizura të jetë sa më e pjerrët) që të vijëzohet

ndonjë pikë B, e pastaj të lëshohet vizura në hatull horizontale, të lexohet segmenti l_1 (fig. 7.57.). Nën supozim se kushti i përmendur nuk është plotësuar, rrafshi i vizurës nuk do të jetë vertikal, prandaj leximi l_1 nuk do të jetë në rrafshin vertikal.

Pastaj, në pozicionin e dytë të instrumentit përsëri vijëzohet pika e njëjtë B, rrotullohet dylbia dhe lexohet vlera e hatullës l_1 . Nëse kushti nuk është plotësuar, leximi l_2 do të jetë simetrik me leximin l_1 në raport me rrafshin vertikal AB. Ndryshimi i leximeve $l_1 - l_2$ na tregon se boshti rrotullues i dylbisë nuk është normal me bishtin alkidad, respektivisht se nuk është horizontal. Nëse është plotësuar kushti, vlerat e leximeve l_1 dhe l_2 do të jenë të njëjta.




Fig. 7.57 Kontrollimi i kushtit IV.

Që të bëhet rektifikimi i këtij kushti, njëri skaj i boshtit rrotullues të dylbisë duhet të ngritet ose lëshohet me vidat përkatëse korrigjuese (fig. 7.58.).




Fig. 7.58. Vidat korrigjuese të boshtit rrotullues.

Rektifikimi i këtij kushti bëhet sipas kësaj renditjeje:

1. Njehsohet mesi i leximit l_1 dhe l_2

$$l = \frac{\widehat{l_1} + l_2}{2}.$$

2. Vizura rregullohet në leximin e llogaritur në hatullën horizontale, me zhvendosje të vidës mikrometrike për zhvendosje të alkidadës.

3. Rrotullohet dylbia rreth boshtit të vet rrotullues kah pika e vizurës.

4. Me zëvendësimin e lartësisë së njërit skaj të boshtit rrotullues, me ndihmën e vidave korigjuese, vizura sillet që ta qëllojë pikën e vizurës, me çka kushti është rektifikuar.

Shpjegim: Edhe pse boshti rrotullues të dylbisë nuk është në tërësi horizontal (për shkak se nuk ka mundësi të bëhet rektifikimi ose nuk është kryer plotësisht rektifikimi i plotë) dhe nëse këndet maten në të dy pozicionet e instrumentit, ajo që boshti rrotullues e dylbisë nuk është normal me bishtin alkidad, nuk do të shprehet në rezultate e fundit të këndeve matëse, sepse rezultatet paraqesin mes aritmetik të leximeve në të dy pozicionet e instrumentit.

7.10. GABIMET GJATË MATJES SË KËNDEVE

Gjatë matjes së kahjeve (këndi fitohet si ndryshim të të dy kahjeve matëse) paraqiten gabime të matjeve që ndodhin për shkaqe të ndryshme, për shembull: gabime personale të operatorit, ndikimi i ndikimeve të jashtme, moskryerja e teodolitit etj. Disa nga burimet e gabimeve shkaktojnë gabime të natyrës së tillë që i ngarkojnë rezultatet e matjeve dhe ato nuk mund të mënjanohen.

7.10.1. Ekscentriciteti i boshtit të alkidadës

Në fabrikën për prodhimin (konstruktimin) e instrumentit tentohet që boshti alkidad të kalojë nëpër qendër të ndarjes së limbës. Megjithatë, edhe përkaj precizitetit më të madh që arrihet gjatë konstruktimit të instrumenteve, nuk ka mundësi të sigurohet gjithmonë boshti alkidad që të kalojë nëpër qendër të ndarjes së limbës ose, në anë tjetër, për shkak të përdorimit afatgjatë të instrumentit bëhet ngrënia i boshteve të tij, prandaj boshti alkidad nuk kalon nëpër qendër.

Distanca midis boshtit të alkidadës dhe qendrës së ndarjes së limbës quhet *ekscentriciteti* i alkidadës. Ekscentriciteti i alkidadës ka ndikim gjatë leximit të limbës horizontale.

Në fig. 7.59. është treguar ekscentriciteti i boshtit alkidad (i zmadhuar). Nëpër qendrën e ndarjes së limbës L bishti alkidad nuk kalon nëpër A , por nga ai shmanget nga madhësia e . Në një diametër të alkidadës janë vendosur indekset për lexim të ndarjes së limbës I dhe II . Në pozicionin e dhënë të vizurës (indekseve I dhe II) do të jenë leximet a_x dhe a_2 . Kur nuk do të ekzistonte ekscentriciteti i alkidadës, indekset për lexim do të ishin në pozitat I' dhe II' , kurse leximet e drejta do të ishin a'_x dhe a'_2 .




Fig. 7.59. Ekscentriciteti i alkidadës.

Ndryshimet në leximet: $\varepsilon = a_1 - a_1'$ dhe $\varepsilon_2 = a_1 - a_1' = -(a_2' - a_2)$ paraqesin gabime në lexime të ndarjes së limbës, për shkak të ekscentricitetit të alkidadës. Është e kuptueshme se (nga fig. 7.59.), për shkak të kahjes në të cilën ndarja e limbës rritet, gabimet në leximet ε_1 dhe ε_2 kanë parashenja të kundërta. Me zbatimin teoremës sinusoide fitohet:

$$\Delta ILLA: \frac{e}{\sin \varepsilon_1} = \frac{R}{\sin \varphi}, \text{ ose } \Delta ILLA: \frac{e}{\sin \varepsilon_2} = \frac{R}{\sin(180 - \varphi)}, \quad (7.22.)$$

respektivisht:

$$\sin \varepsilon_1 = \frac{e}{R} \sin \varphi; \quad \sin \varepsilon_2 = \frac{e}{R} \sin \varphi. \quad (7.23.)$$

Ngase anët e djathta të barazimeve të mëparshme janë të barabarta, vijon se edhe anët e majta janë të barabarta, respektivisht do të jenë të barabarta edhe këndet ε_1 dhe ε_2 . Këndet ε_1 dhe ε_2 janë të vogla, prandaj vlerat e tyre do të jenë:

$$\varepsilon_1'' = \rho'' \frac{e}{R} \sin \varphi \text{ dhe } \varepsilon_2'' = \rho'' \frac{e}{R} \sin \varphi. \quad (7.24.)$$

Nuk është vështirë të konkludohet se gabimet (ε_1 dhe ε_2) kanë vlerë të njëjtë absolute, por parashenja të kundërta.

Nëse e formojmë shumën $\varepsilon_1 + \varepsilon_2$ do të fitojmë:

$$\varepsilon_1 + \varepsilon_2 = (a_1 + a_2) - (a_1' + a_2') = 0 \quad (7.25.)$$

respektivisht:

$$a_1 + a_2 = a_1' + a_2' \text{ ose } \frac{a_1 + a_2}{2} = \frac{a_1' + a_2'}{2}. \quad (7.26.)$$

Prej këtu mund të sjellim përfundim: nëse ndarja e limbës në dy vendet diametrale të kundërta dhe për vlerë definitive merret mesi aritmetik, do të fitohet vlera e njëjtë sikur të mos ekzistojë ekscentriciteti të boshtit alkidad. Me leximin e ndarjes së limbës në dy vende diametriki-sht të kundërta mënjanohet gabimi i cili ndodh për shkak të ekscentricitetit të alkidadës. Konstatimi i përmendur njëkohësisht është shpengim,

sepse leximet e ndarjes së limbës duhet t'i bëjmë në dy vende diametrikisht të kundërta të ndarjes.

Ndryshimi në leximet e ndarjeve të limbës të të dy vendeve diametrikisht të kundërta do të jetë:

$$d = \varepsilon_1 - \varepsilon_2 = 2\varepsilon = 180^\circ - (a_2 - a_1) \quad (7.27.)$$

respektivisht:

$$d = (a_2 \pm 180^\circ) - a_1 = 2\varepsilon = 2\rho'' \frac{e}{R} \sin \varphi. \quad (7.28.)$$

Siç shihet nga shprehja e fundit (7.28.), ndryshimi i leximit të indeksit të majtë dhe të djathtë për lexim të ndarjes do të varet nga:

- madhësia e ekscentricitetit të boshtit alkidad e ;
- këndi φ , nën të cilin diametri i alkidadës (e cila e mban indeksin e leximit) qëndron në raport të ekscentricitetit.

Ky ndryshim është i barabartë me zero nëse rrezja përputhet me kahjen e ekscentricitetit ($\varphi = 0^\circ$), kurse vlerë më të madhe ka kur janë nën kënd ($\varphi = 90^\circ$).

Kur tek alkidadada ekzistojnë dy indekse të veçanta për lexim të ndarjes së limbës, në atë rast lehtë mund të caktohet a ka ekscentricitetin në boshtin alkidad. Në vende të ndryshme të ndarjes së limbës me të dy indekset duhet të bëhet leximi dhe pastaj të formohet ndryshimi:

$$d_i = II_i - I_i. \quad (7.29.)$$

Nëse vlerat e njehsuara të ndryshimit ndërrohen, kjo është shenjë e sigurt se ekziston ekscentriciteti të alkidadës. Në ekscentricitetin nuk duhet kushtuar vëmendje nëse leximet i bëjmë në të dy indekset dhe nëse si rezultat i fundit merret mesit aritmetik. Tek instrumentet e reja bëhet leximi direkt i mesit aritmetik.

Përveç ekscentricitetit të boshtit alkidad mund të ndodhë që indekset për lexim të mos jenë në diametër, por të shmangen nga kahja e tyre. Atëherë ndryshimet $d_1 = II_1 - I_1$ do të jenë konstante në kusht të mos ekzistojë ekscentriciteti i boshtit alkidad.

Të gjitha leximet te teodolitet vetëm me një indeks (për lexim të ndarjes) janë të ngarkuara me gabime për shkak të ndikimit të ekscentricitetit të boshtit alkidad:

$$\varepsilon'' = \rho'' \frac{e}{R} \sin \varphi. \quad (7.30.)$$

Madhësia e këtij gabimi është ndryshore dhe varet nga vlerat a dhe φ .

Shembulli 7.5: Të llogaritet gabimi në lexim të ndarjes së limbës me diametër $R = 150$ mm nëse ekscentriciteti i alkidadës është $e = 0,1$ mm, kurse këndi $\varphi = 90^\circ$.

Zgjidhje:

$$\varepsilon'' = \frac{0,1}{150} \cdot 1 \cdot 206265'' = 137'',5 = 2'17'',5.$$

Shembulli përmendur tregon se vlera shumë e madh e ekscentricitetit jep shumë gabime në rezultat të leximit të ndarjes së limbës.

Teodolitet të cilat kanë ekscentricitet të alkidadës dhe një indeks për lexim të ndarjes së limbës nuk përdoren nga shkak se në rezultatet e matjes do të paraqiten gabime.

7.10.2. Ekscentriciteti i rrafshit të vizurës

Rrafshi i vizurës duhet të kalojë nëpër boshtin alkidad. Për shkak të mospërsosshmërisë së përpunimit të teodolitit ndodh që rrafshi i vizurës të shmanget nga boshti alkidad. Dukurinë e tillë e quajmë ekscentricitetin e rrafshit të vizurës. Ekscentriciteti i rrafshit të vizurës, gjatë rrotullimit të teodolitit rreth boshtit alkidad do ta përshkruajë cilindrin në të cilin boshti përputhet me boshtin alkidad, kurse rrezja e cilindrit është e barabartë me ekscentricitetin është (fig. 7.60.). Të supozojmë se në fig. 7.62. qendra e ndarjes së limbës përputhet me boshtin alkidad, për shkak të ekscentricitetit të rrafshit të vizurës, në vend të vlerës së këndit, kurse

në pozitën e parë të instrumentit do të matet këndi a'' , kurse në pozitën e dytë këndi a'' .

Nga figura 7.60. vijojnë barazimet:

$$\begin{aligned}
 1. \quad \Delta ABT_1 &\Rightarrow \alpha' + \beta + \varphi = 180^\circ; \\
 2. \quad \Delta LCT_1 &\Rightarrow \alpha + \gamma + \varphi = 180^\circ; \\
 3. \quad \Delta CDT_2 &\Rightarrow \alpha'' + \gamma + \psi = 180^\circ; \\
 4. \quad \Delta LBT_2 &\Rightarrow \alpha + \beta + \psi = 180^\circ.
 \end{aligned}
 \tag{7.31.}$$

Kur do të mblidhen e para dhe e treta, dhe e dyta dhe e katërta, atëherë do të fitohet

$$\begin{aligned}
 \alpha' + \alpha'' + \beta + \gamma + \varphi + \psi &= 360^\circ, \\
 2\alpha + \beta + \gamma + \varphi + \psi &= 360^\circ,
 \end{aligned}
 \tag{7.32.}$$

prej ku rrjedh:

$$2\alpha = \alpha' + \alpha'', \text{ respektivisht: } \alpha = \frac{\alpha' + \alpha''}{2}.
 \tag{7.33.}$$

Kur këndet maten në dy pozicione të instrumentit dhe si vlerë përfundimtare e këndit merret mesi aritmetik nga të dy pozicionet, në atë rast eliminohet ndikimi i ekscentricitetit të rrafshit të vizurës. Nëse këndin e masim në një pozicion, në instrument fitohet vlerë e gabuar e këndit të matur. Gabimin i cili ndodh për shkak të leximit të këndit vetëm në një pozicion mund ta llogarisim:

$$\alpha - \alpha' = \varphi - \psi,
 \tag{7.34.}$$

respektivisht fitojmë:

$$\alpha - \alpha' = \rho'' \cdot e \cdot \left(\frac{1}{S_1} - \frac{1}{S_2} \right).
 \tag{7.35.}$$

Nëse gjatësitë e krahëve të këndit S_1 dhe S_2 (fig. 7.60.) midis veti janë të barabarta, nuk do të shprehet ndikimi i ekscentricitetit të rrafshit të vizurës të saktësisë së matjes së këndit.

Ky ndikim posaçërisht do të jetë theksuar nëse e masim këndin, një krah i të cilit është i shkurtë, kurse tjetri është i gjatë.

Shembulli 7.6: Të gjendet gabimi i këndit të matur në pozicionin e parë të instrumentit, i cili ka ndodhur për shkak të ndikimit të ekscentricitetit të rrafshit të vizurës, d.m.th., nëse janë:

$$e = 1 \text{ mm} \quad S_1 = 20 \text{ m} \quad S_2 = 200 \text{ m}.$$

Zgjidhje:

$$\alpha - \alpha' = 206265'' \cdot 1\text{mm} \cdot \left(\frac{1}{20000\text{mm}} - \frac{1}{200000\text{mm}} \right)$$

$$\alpha - \alpha' = 10'',31 - 1'',03 = 9'',28.$$




Fig. 7.60. Ekscentriciteti i rrafshit të vizurës.

7.11. QENDËRZIMI I TEODOLITIT

Matja i këndeve horizontale mund të fillojë kur qendra e ndarjes së limbës horizontale do të vendoset, ashtu që nëpër atë të kalojë vertikalia e pikës mbi të cilën vendoset teodoliti (stacioni). Procedura e sjelljes së qendrës në ndarjen e limbës në pikën vertikale, nga e cila maten këndet horizontale, quhet *qendërzim* i instrumentit. Për qendërzimin e instrumentit shfrytëzohet: lavjerrës të thjeshtë, të ngurtë dhe optik.

7.11.1. Qendërzimi me lavjerrës të thjeshtë

Këtu detalisht do të shpjegohet procedura e qendërzimit të teodolitit me ndihmën e lavjerrësit të thjeshtë.

Stativi i instrumentit vendoset afërsisht mbi qendrën shenjës dhe në grepin e vidës qendrore varet peri me lavjerrësin. Pasta, perin nga lavjerrësi nuk duhet ta lidhim në nyje, sepse për një kohë të shkurtë do të ketë shumë nyje të lidhura dhe nuk do të jetë në gjendje për përdorim të mëtejshëm, por duhet vetëm të tërhiqet midis dy skajeve të perit dhe pak të shtrëngohet (fig. 7.61.).




Fig. 7.61. Qendërzimi i lavjerrësit të thjeshtë.

Pastaj, pjesa e sipërme e kokës së stativit duhet të vendoset afërsisht horizontalisht, duke i vendosur këmbëzat e stativit, të cilat shkelen mirë dhe ngulen në terren. Te procedura e tillë mbahet llogari që lavjerrësi të jetë afërsisht mbi shenjën, ashtu që me vendosje të instrumentit në kokën e stativit mund ta sjellim lavjerrësin mbi qendrën shenjës. Në këtë mënyrë ka përfunduar qendërzimi i ashpër i teodolitit. Për qendërzim të saktë të teodolitit së pari duhet të sillen libela e alkidadës (gypore) që të lëvizë, e pastaj të kontrollohet vallë lavjerrësi është mbi qendrën e shenjës. Nëse nuk është, atëherë atë e arrijmë me vendosje translatore të teodolitit në kokën e stativit, që të mos priset pozita e përafërt vertikale e boshtit alkidad. Nëse boshti alkidad në hapësirë nuk është në pozitën vertikale, atëherë lavjerrësi, boshti alkidad dhe qendra e ndarjes së limbës nuk do të shtrihen në vertikale të njëjtë (fig. 7.61c.). Instrumenti është qendërzuar mirë nëse libela e alkidadës lëviz në çdo pozicion të instrumentit dhe nëse lavjerrësi qëndron mbi qendrën e shenjës (të vrojtuar nga të gjitha pozicionet).

7.11.2. Qendërzimi me lavjerrës të ngurtë

Lavjerrësi i ngurtë (fig. 7.62.) është i përbërë nga tri pjesë:

- pjesa e sipërme e lavjerrësit të ngurtë tërhiqet dhe përforcohet në pjesën e zbrazët të vidës qendrore;
- gypi i sipërm i hollë i lavjerrësit të ngurtë, në të cilin gjendet ndarja centimetrike, tërhiqet në gypi e gjerë; në unazën e sipërme të gypit të gjerë lexohet lartësia e instrumentit, nga sipërfaqja e sipërme të shenjës deri te boshti rrotullues të dylbisë ose deri te sipërfaqja e sipërme e kokës së stativit (duhet të kontrollohet);
- gypi më i gjatë i gjerë
- gypi i gjerë i poshtëm, në të cilën futet gypi i ngushtë i poshtëm, e bart libelën qendërzore, e cila shërben për vendosje të lavjerrësit rrethor në pozitën vertikale; fundi i gypit të poshtëm, i cili është me skaj të mprehtë, vendoset në qendër të shenjës.

Që lavjerrësi i ngurtë të mund të përdoret për qendërzim të teodolitit, duhet të jetë plotësuar ky kusht: Kontrollimi dhe rektifikimi bëhen në këtë mënyrë:

E vendosim majën në lavjerrësin e ngurtë në qendër të shenjës dhe me zhvendosje të teodolitit nëpër kokën e stativit ose ndryshimin e gjatësisë së këmbëve të stativit, e sjellim flluskën në libelë që të lëvizë. Pastaj lavjerrësi i ngurtë rrotullohet për 180° . Shmangia e cila paraqitet, bëhet nga dy shkaqe: Gjysma e shmangies bëhet për shkak të lavjerrësit të ngurtë jo vertikal, kurse gjysma tjetër për shkak të boshtit jo paralel të limbës dhe boshtit të lavjerrësit të ngurtë. Rektifikimi bëhet ashtu që gjysmën e shmangies e vendosim me ndihmë të vidave korigjuese të libelës, kurse gjysmën tjetër me zhvendosje të instrumentit nëpër kokën e stativit. Procedura e kontrollimit, nëse është e nevojshme, përsëritet derisa flluska, e cila njëherë është sjellë që të lëvizë, nuk sillet që të lëvizë në të gjitha pozitat e lavjerrësit të ngurtë.




Fig. 7.62. Lavjerrës i ngurtë.

Procedura e qendërzimit është si vijon:

1. Stativin e vendosim mbi qendrën e shenjës dhe kur kokën e stativit për afërsisht do ta horizontojmë, maja e lavjerrësit të ngurtë vendoset në vetë qendrën e shenjës. Pastaj vida qendrore duhet të jetë për afërsisht në qendër të hapjes rrethore të kokës së stativit.

2. Me zhvendosjen e këmbëve të stativit ose me zëvendësimin e gjatësisë së tyre (nëse është e mundur ajo), përafërsisht e vendosim fluskën e libelës të lëvizë.

3. Lëshohet vida qendrore dhe me ndihmën e vidave pozicionuese vendoset fluska e libelës së alkidadës që të lëvizë.

4. Me zhvendosje translatore në kokën e stativit, fluska e libelës së lavjerrësit të ngurtë vendoset të lëvizë.

5. Me shtrëngimin e vidës qendrore, me ndihmën e vidave qendrore ndreqet shmangja e ndodhur e fluskës së libelës gypore të alkidadës.

Saktësia e qendërimit të instrumentit me ndihmën e lavjerrësit të ngurtë është 2-3 mm.

7.11.3. Qendërimi me lavjerrës optik

Lavjerrësit optik (fig. 7.63) shfrytëzohet për qendërim preciz të teodolitit. Të gjithë teodolitët të cilat shërbejnë për matje precize të këndeve me vete kanë instaluar lavjerrës optik. Lavjerrësi optik është pjesë përbërëse e instrumentit ose përpunohet si pjesë e veçantë. Lavjerrësi optik përbëhet prej dylbisë së vogël me zmadhim 3-4 herë, ku në mes është i përthyer nën kënd të drejtë. Përmes okularit të lavjerrësit optik vëzhgohet qendra e pikës, kurse për qendërim të saktë të instrumentit, penjzori i lavjerrësit optik përmban kryq ose rreth. Lavjerrësi optik mund të jetë i ndërtuar në alkidadën e teodolitit ose në pjesën e poshtme të saj. Nëse lavjerrësi optik është i vendosur në pjesën e poshtme të teodolitit, atëherë ai nuk lëviz gjatë matjes së këndeve. Pjesa e vizurës së lavjerrësit optik OA (fig. 7.63.) përputhet me drejtimin e boshtit të alkidadës. Sipas kësaj, kur boshti i alkidadës është vertikal, do të jetë vertikale edhe pjesa e vizurës të lavjerrësit optik OA, e kjo do të thotë se me ndihmën e lavjerrësit optik mund të qendërohet vetëm kur lëviz fluska e libelës së alkidadës (libela gypore).




Fig. 7.63. Lavjerrësi optik.

Lavjerrësi optik duhet ta plotësojë kushtin që vijon: pjesa e vizurës së lavjerrësit optik OA të përputhet me boshtin alkidad. Te teodolitët me lavjerrës optik, e cila është vendosur në alkidadë, ky kusht analizohet në mënyrën që vijon.

Flluska e libelës së alkidadës vendoset të lëvizë dhe përmes fushës së dukshme të lavjerrësit optik shihet një pikë e dukshme qartë e cila shtrihet në kryqëzimin e penjve. Pastaj, alkidadë rrotullohet për 180° dhe prapë shikohet përmes lavjerrësit optik. Nëse prerja e penjve është në pikën vrojtuese, kushti është i kënaqshëm, e nëse ka shmangie, duhet të bëhet rektifikimi. Që të bëhet rektifikimi duhet të zhvendoset unaza e penjzorit të lavjerrësit optik, kurse kryqëzimi i penjve nuk sillen në mesin e shmangieve.

Disa firma për instrumente, lavjerrësin optik e vendosin në pjesën e poshtme të teodolitit, ku ndodhen vidat apozicionale (fig. 7.64.). Kur rrotullohet alkidadë, lavjerrësi optik nuk lëviz dhe nuk mund të analizohet dhe përshkruhet si në mënyrën mëparshme.




Fig. 7.64. Vizura te lavjerrësi optik.

Procedura e qendërimit të teodolitit me ndihmën e lavjerrësit optik varet nga ajo nëse këmbët e stativit janë me gjatësi të ndryshueshme ose jo.

Kur këmbët janë me gjatësi jo të ndryshueshme, qendërimit i instrumentit me lavjerrës optik bëhet pasi të bëhet qendërimit i përafërt i instrumentit me lavjerrës të thjeshtë.

Pas qendërimit të përafërt të teodolitit, duke vepruar në vidat apozicionale, e sjellim flluskën e libelës që të lëviz. Pastaj duke vëzhguar përmes lavjerrësit optik, instrumentin e vendosim translatorisht në kokën e stativit deri sa me lavjerrësin optik nuk vijëzohet qendra e pikës. Gjatë zhvendosjes mund të ndodhë që flluska e libelës së alkidadës të shmanget. Prandaj është e nevojshme të silllet flluska e libelës që të lëvizë dhe të ndreqet qendërimiti deri kur vizura e lavjerrësit optik nuk do të jetë në pozitë të kalojë nëpër qendër e pikës, dhe pas saj flluska e libelës së alkidadës të lëvizë. Sjellja alternative e flluskës së libelës që të lëvizë dhe të qendërohet është e nevojshme, për shkak se vizura e lavjerrësit optik përputhet me boshtin alkidad. Prandaj nëse flluska e libelës nuk lëviz, boshti alkidad nuk është vertikal, e me atë vizura e lavjerrësit optik, gjithashtu nuk është vertikale.

Kur gjatësia e këmbëve të stativit është e ndryshueshme edhe kur në alkidadë ekziston libelë qendëruese, teodolitit mund ta qendërojmë pa lavjerrës të thjeshtë. Në atë rast procedura e qendërimit është si vijon:

1. Stativi me teodolitit vendoset përafërsisht mbi qendrën e pikës.
2. Me zhvendosjen e këmbëve të stativit e rregullojmë vizuarën e lavjerrësit optik të bjerë në qendrën e pikës. Me këtë rast, për ndërrimin e pamjes së saktë të vizurës së lavjerrësit optik në qendrën e pikës mund të shfrytëzohen edhe vidat pozicionale.
3. Me zëvendësimin e gjatësisë së këmbëve të stativit e sjellim flluskën në libelën qendëruese të alkidadës që të lëvizë, ndërsa nuk shfrytëzohen vidat pozicionale. Në këtë rast, vizura e lavjerrësit optik do të qëndrojë vertikalisht dhe do ta godet qendrën e pikës. Pas kësaj mbetet ende të silllet flluska e libelës gypore (e cila është më e ndjeshme)

që të lëvizë dhe me ndihmën e zhvendosjes jo domethënëse të teodolitit në kokën e stativit, të bëhet qendërzim i saktë.

Gabimi i qendërzimit të teodolitit me ndihmën e lavjerrësit optik është 1mm.

Kur pikat janë në varg (fig. 7.65), mbi to me ndihmën e lavjerrësit optik ose atij të ngurtë qendërzohen stativet me mbajtëse speciale në të cilat mund të vendoset instrument dhe pullë vizure*. Deri sa bëhen matjet, stativet qëndrojnë të qendëruara mbi pikat, kurse në to sipas nevojës vendoset instrument ose pullë vizure.

Kur matjet nga një pikë do të përfundojnë, instrumenti pa pjesën e poshtme (pjesa e poshtme mbetet në stativ) zhvendoset në pikë tjetër, në vendin ku para saj ishte pulla, kurse në vendin e saj vendoset pulla. Me atë gabimet e qendërzimit të instrumentit dhe pullave praktikisht janë sjellë në zero. Qendërzim i detyruar siguron saktësi të mundshme më të madhe të qendërzimit. Mënyra e këtillë e qendërzimit zbatohet te punët ku kërkohet saktësia e mundshme më e madhe gjatë matjes së këndeve dhe gjatësive.




Fig. 7.65. Proces i qendërzimit të detyruar.

* Sinjal i cili vijëzohet (fig. 4.7.).

8. MATJA E KËNDEVE HORIZONTALE

Gjatë matjes së këndeve horizontale ekzistojnë shumë procedura të punës, respektivisht metoda të ndryshme të matjes së këndeve horizontale. Ato dallohen sipas saktësisë dhe sipas ekonomizimit. Prandaj duhet mbajtur llogari gjatë zgjedhjes së metodave të matjes së këndeve, respektivisht duhet të mbahet llogari për zhvillimin e plotë të zbatimit të tyre në zgjidhjen e detyrave të caktuara nga fusha e gjeodezisë. Shumë parametra ndikojnë në zhvillimin e plotë të metodës së matjes së këndeve (saktësia, mënyra e stabilizimit, kushtet e jashtme meteorologjike dhe rrethanat objektive të cilat janë të pranishme gjatë matjes së këndeve). Këtu do të shpjegohen vetëm dy metoda të matjes së këndeve: metoda e thjeshtë dhe gyruse.

Para se të kalojmë në studimin e këtyre metodave është e nevojshme që të njihemi me disa detaje dhe me terminologjinë e parashtruar:

- pika mbi të cilën qendërzohet teodoliti quhet *stacion*;
- pika mbi të cilën vendoset sinjali, e pastaj bëhet vijëzimi quhet *pika e vijëzimit*.

Nga një stacion vijëzimi bëhet në më së paku dy pika fqinje. Pikat e vijëzuara mund të sinjalizohen në mënyra të ndryshme dhe me lloje të ndryshme të sinjalit. Cila pjesë e sinjalit do të vijëzohet, vare nga lloji i sinjalit. Nëse pikat e vijëzuara sinjalizohen me shenjë vertikale, hatull ose me ndonjë sinjal tjetër, i cili drejtpërdrejt vendoset në qendër të pikës, vijëzohet mesi i sinjalit edhe atë sa është e mundur më ulët. Kur për sinjal përdorim pullë të vijëzuar, vijëzohet mesi i pullës. Te piramidat, të cilat janë vendosur mbi qendrën e pikave, vijëzohet shtylla i cili është bërë posaçërisht për atë. Vendi i vijëzimit të objekteve të ndryshme, të cilat shërbejnë si pika të vijëzuara, mund të shihen në Fig. 8.1. Kur te disa objekte të afërta dhe të mëdha është vështirë të përcaktohet boshti i objektit, vijëzohet kulmi i tij i majtë dhe i djathtë.

Këndet maten me ndihmë të teodolitit i cili më parë është kontrolluar dhe rektifikuar. Drejtpërdrejt para fillimit të matjes së këndeve duhet të qendërzohet instrumenti dhe të sinjalizohen pikat vizure.




Fig. 8.1. Vendet e vijëzimit të objekteve të ndryshme.

8.1. METODA E THJESHTË

Matja e këndeve vetëm në pozitën parë të dylbisë quhet *metoda e thjeshtë* e matjes së këndeve. Në të vërtetë, pas kësaj metode maten drejtimet, kurse këndet përfitohen si ndryshim i vlerave të drejtimeve përkatëse. Gjithmonë nga vlera e kahjes së djathtë zbriten vlera e kahjes së majtë (fig. 2.). Vlerat e kahjeve të matura shënohet me α_1 , kurse vlerat e këndeve me β_1 .




Fig. 8.2. Matja e këndeve.

Ngase teodoliti është qendëruar edhe boshti alkidad është vendosur në pozitë vertikale, vijëzohet sinjali i pikës e cila është zgjedhur si pikë fillestare, i ashtuquajtur vijëzim fillestar. Gjatë vijëzimit të butë mbahet llogari që lëvizje e fundit e vidës mikrometrike të jetë në kahje të lëvizjes së akrepave të orës (kapitulli 7.7.). Pas kryerjes së vijëzimit të lehtë, lexohet vlera e ndarjes së limbës dhe mbrohet. Vlerën e shkruajmë në procesverbal përkatës. Pastaj, në mënyrë të njëjtë vijëzohen edhe pikate tjera, duke kaluar në kahjen e lëvizjes së akrepave të orës. Në fund, sërish e vijëzojmë pikën fillestare. Vijëzimin e tillë të pikës fillestare të quajmë vijëzim të kryer, e pastaj e bëjmë që të mund të konfirmojë vallë limba gjatë kohës së matjeve ka qenë i palëvizshëm, respektivisht vallë instrumenti ka qenë stabil. Vlera e leximit të ndarjes së limbës gjatë vijëzimit të pikës fillestare dhe të fundit nuk guxon të dallohet më tepër nga ajo e lejuar.

Veçanërisht duhet të theksohet se matja e kahjeve në një pozitë të dylbisë janë ngarkuar me disa gabime të cilat krijohen për shkak të instrumentit, por të cilat nuk janë të pranishme kur matja e kahjeve zhvillohet në dy pozita të dylbisë, siç është rasti të *metoda e sigurisë*. Prandaj kjo metodë në praktikë përdoret të metoda polare të incizimit të detalit.

8.2. METODA GYRUSE

Matja e këndeve në të dy pozitat e dylbisë quhet metoda gyruse. Edhe këtu, si të metoda e thjeshtë, maten kahjet, kurse këndet fitohen si ndryshime të vlerave të kahjeve përkatëse. Para fillimit të matjeve, ngase pikat vizure janë sinjalizuar dhe teodoliti është qendëruar, patjetër duhet të zgjidhet pika për vijëzim fillestar, kurse pastaj në procesverbalin e terrenit formulari trigonometrik nr. 1 (shtesa 2), shkruhen numrat dhe shenjat e pikave, si dhe të dhënat e tjera (data, koha, instrumenti etj.). Për vizurë fillestare zgjidhet pika e cila gjatë tërë kohës, deri sa bëhen matjet

e kahjeve, do të qartë e dukshme, respektivisht pika e cila është në anën e kundërt të Diellit dhe e cila është larg stacionit.

Matja e kahjeve fillon me vijëzim të pikës fillestare në pozitën e parë të dylbisë. Ngase sinjali i pikës fillestare është vijëzuar, lexohet ndarja e limbës dhe shkruhet rezultati për lexim në procesverbal. Nëse ndarja e limbës në të dy anët e kundërta diametrale, atëherë së pari do të lexohet vlera e skajit të majtë dhe do të shkruhet në procesverbal, kurse pastaj do të lexohet skaji i djathtë i limbës. Këto dy vlera duhet të dallohen për 180° . (Nëse lexohen vlerat, për shembull ato të djathtat për minutë, e jo për sekondë, duhet të shkruhen pjesët e dhjeta të minutës, respektivisht ajo që është lexuar, pa i shndërruan në sekonda). Pastaj, duke shkuar nëpër kahjen fillestare në kahjen e lëvizjes së akrepave të orës, matjet vazhdojnë deri në kahjen e fundit. Pastaj maten kahjet të cilat hasen me radhë, kurse leximet futen në procesverbalin trigonometrik sipas mënyrës së përshkruar.

Kur nga stacioni maten tri ose më tepër kahje në rrjetën trigonometrike, merret vizura përfundimtare. Gjatë matjes së kahjeve në rrjetën poligone nuk merret vizura përfundimtare pa marrë parasysh numrin e kahjeve.

Pasi është matur edhe kahja e fundit, nëse është e nevojshme merret vizura përfundimtare. Për vizurën përfundimtare në fund sërish matet kahja fillestare. Leximi i vizurës përfundimtare shkruhet ë rreshtin përkatës edhe atë në ndërtesë. Ky lexim nuk hyn në përpunim të mëtejshëm të të dhënave të matjeve dhe shërben vetëm për kontroll të palëvizshmërisë së limbës gjatë kohës së matjeve të kahjeve. Leximi i vizurës përfundimtare, siç u theksua më parë, patjetër duhet të përputhet me vizurën fillestare në kufijtë e procedurës së lejuar.

Me marrjen e vizurës përfundimtare, atje ku është parashikuar, respektivisht me matjen e kahjes së fundit, ku nuk parashihet marrja e vizurës përfundimtare, matja e kahjeve ka përfunduar në pozitën e parë të dylbisë, respektivisht gjysmë gyresi i parë ka përfunduar. Pastaj dylbinë e rrotullojmë rreth boshtit të saj të rrotullimit në pozitën e dytë, ashtu që

limba vertikale t'i gjendet nga ana e djathtë, dhe fillon matja e kahjes së pozitës së dyte të dylbisë. Nëse merret vizura përfundimtare, së pari matet kahja përfundimtare dhe të dhënat nga matja shkruhen në kllapa, në rreshtin përkatës. Pastaj matja e kahjeve vazhdon duke shkuar në kahje të kundërt nga kahja e lëvizjes së akrepave të orës. Kur limba lexohet në dy vende diametralisht të kundërta, së pari do të lexohet skaji i djathtë, kurse pastaj skaji i majtë e limbës.

Të dhënat e matjes së kahjeve në pozitën e parë të dylbisë në procesverbalin trigonometrik shkruhen prej lart poshtë, kurse, nga ana tjetër, të dhënat nga matjet në pozitën e dytë të dylbisë shkruhen prej poshtë lart, siç janë shkruar shenjat dhe numrat e pikave vizure.

Ndryshimi i cili në pozitën e parë të dylbisë maten kahjet në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës, kurse ë pozitën e dytë të dylbisë në kahje të kundërt, mund të shpjegohet në këtë mënyrë. Është e njohur se para fillimit të matjes së kahjeve boshti alkidad sillet në pozitën vertikale me sjelljen e fluskave në libelën gypore që të lëvizë. Nën ndikimin e kohëzgjatjes, Diellit, erës dhe lëvizjes së operatorit rreth teodolitit, bëhet zbritja e këmbëzave të stativit, për ç'arsye zmbropset fluska e libelës. Zmbropsja e fluskës në libelë rritet me kohëzgjatjen e matjes, në një farë mënyre është ë funksion të kohës t . Kjo zmbropsje rritet me kohën e cila kalon nga fillimi i matjes. Nga kjo pikëpamje për kahjet e fluskave afërsisht mund t'i shkruajmë gabimet vijuese të cilat janë bërë për shkaqet e përmendura.

Pozita II		Pozita II
për kahjen 1	δ	$2n\delta$
për kahjen 2	2δ	$(2n - 1)\delta$
.
për kahjen n	$n\delta$	$(n + 1)\delta$

Ngase si vlera përfundimtare të kahjeve matëse merren vlerat mesatare, prandaj çdo vlerë mesatare do të jetë e ngarkuar me gabimin e

njëjtë $\left(\frac{2n+1}{2}\right)\delta$. Gjatë reduktimit të kahjeve ai gabim në pjesën më të madhe do të anulohet.

Ngase është shkruar matja në një gyruse, kalohet kah rregullimi i procesverbalit:

Nëse ndarja e limbës lexohet në dy vende diametrikisht të kundërta, respektivisht nëse ë procesverbalin T.O.1. janë plotësuar kolonat 3 dhe 4, së pari llogaritet vlera e gabimit të dyfishtë kolimatik $2c = II - I$ dhe kjo shkruhet në kolonën 7. Vlerat e gabimeve të dyfishta kolimatike llogariten nga dy shkaqe: me ndihmën e tyre përcaktohet cilësia e matjeve të kryera dhe mundësia që të shërbejnë për llogaritje të vlerave mesatare të kahjeve të matura në dy pozita të dylbisë. Ndryshimi i vlerës të gabimit të dyfishtë kolimatik ndodh si pasojë e gabimeve në vizimin e leximit. Varësisht nga saktësia e leximit të ndarjes së limbës dhe llojit të sinjalit, Rregullorja e përshkruan ndryshimin më të madh të lejuar midis vlerës më të madhe dhe më të vogël të gabimit të dyfishtë kolimatik në një virus. Nëse ky ndryshim është më i madh nga kufiri i lejuar, matjet patjetër duhet të përsëriten.

Kur ndryshimi i vlerës së gabimit të dyfishtë kolimatik është në kufirin e gabimit të lejuar, llogariten vlerat mesatare të leximeve të pozitës së parë dhe të dytë të dylbisë dhe shkruhen në kolonën 5. Vlera mesatare mund të llogaritet kur gabimi kolimatik c do të zbritet nga leximi, vlera e të cilit është më e madhe ose do të shtohet në leximin i cili është më i vogël. Me këtë rast ruhet shkallët të cilat janë lexuar në pozitën e parë të dylbisë, kurse mesi caktohet vetëm për minutat dhe sekondat.

Kontrolli i llogaritjes së vlerave mesatare krahasohen me ndihmë të shumave të vlerave të drejtimeve matëse sipas kolonave të veçanta. Kontrollin e zbatojmë në këtë mënyrë:

$$([3] + [4]) : 2 = [5]$$

ku kllapat e mesme ($[]$) paraqesin shumatat të kolonave të veçanta edhe atë vetëm minutat dhe sekondat. Që të tregohet se kolonat e tilla janë bërë, shumatat dyfish tërhiqen.

Pastaj vazhdojmë që t'i llogaritim meset e reduktuara. Gjatë matjes së kahjeve leximi i vizurës fillestare nuk vendoset në $0^{\circ}00'00''$, por kjo arrihet me ndihmën e zhvendosjes. Kur nga të gjitha kahjet matëse të një stacioni do të zbritet fillimi i kahjes të asaj faqeje, përfitohen kahjet e reduktuara, vlera e të cilave do të jetë më e vogël nga vlera e kahjes fillestare. Pas reduktimit të kahjeve kahja fillestare do ta ketë vlerën $0^{\circ}00'00''$. Me reduktimin e kahjeve gjithmonë arrihet kahja fillestare që ta ketë vlerën $0^{\circ}00'00''$, kurse kahjet e tjera zvogëlohen për vlerën e kahjes fillestare. Me reduktimin e kahjeve nuk ndryshon vlera e këndeve. Këndet kanë vlerë të njëjtë pa dallim të asaj vallë fitohen nga kahjet e reduktuara ose, në anën tjetër, nga kahjet jo të reduktuara.

Kontrolli i kahjeve të reduktuara, gjithashtu, zbatohet me ndihmën e shumave. Vlerat e kahjeve të reduktuara fitohen si:

$$\begin{aligned} (a_0) &= a_0 - a_0 \\ (a_1) &= a_1 - a_0 \\ (a_2) &= a_2 - a_0 \\ &\dots \dots \dots \\ (a_n) &= a_n - a_0 \end{aligned}$$

ose me mbledhjen

$$[(a)] = [a] - na_0$$

respektivisht:

$$\begin{aligned} [10] &= [9] - na_0 \\ [9] &= [10] + na_0. \end{aligned}$$

Nëse nga stacioni maten vetëm dy kahje, reduktimi bëhet edhe në të dy kahjet. Në këtë mënyrë fitohen dy kënde, mbledhja e të cilave për kontroll patjetër duhet të jetë 360° (fig. 3.).




Fig. 8.3. Reduktimi i kahjeve.

Për shkak të sigurimit të saktësisë më të madhe të matjes, këndet maten në dy ose më tepër gyruse. Midis gyruseve të caktuara limba zhvendoset për $180^\circ/n$ (n është numri i gyruseve). Me zhvendosje të limbës shmangen gabimet sugjestive (të cilat do të ndodheshin nëse limba nuk zhvendoset midis gyruseve) dhe do të zvogëlohet ndikimi i gabimeve të ndarjes së limbës.

Vlerat e kahjeve të reduktuara në disa gyruse duhet të sillen në kufijtë e saktësisë, që përcaktohet prej përpara (analiza apriori). Për shkak të gabimeve të cilat bëhen gjatë matjes, vlerat e kahjeve midis veti nuk do të përputhen. Me rregulloren është rregulluar ndryshimi midis kahjeve të reduktuara në disa gyruse që të mos mund ta kalojë kufirin e lejuar. Kufiri i shmangies së lejuar është caktuar varësisht nga lloji i punëve, saktësia e leximit dhe ndarja e limbës dhe nga lloji i sinjalit që janë përdorur gjatë matjeve të këndeve.

Sqarim: Rregullorja për paramasë shtetërore dhe kadastër të tokës e rregullon mënyrën e shkrimit të të dhënave, llogarive dhe kontrolleve të cilat bëhen në formularin trigonometrik nr. 1. Ko patjetër duhet të respektohet deri në fund. Mënyra e unifikuar e prezantimit të të dhënave mundëson përdorimin e tyre efikase. Atëherë personat profesionalë gjeodezik pa kurrfarë probleme mund të shfrytëzojnë të dhëna të cilido qoftë të matjes së këndeve.

Me metodën gyruse të matjes së këndeve mënjanohet grupi i madh i gabimeve, posaçërisht të gabimeve të cilat bëhen për shkak të rektifikimit të palejuar të teodoliteve dhe përpunimit të papërsosur të pjesëve të caktuara.

8.3. GABIMET GJATË MATJEVE

8.3.1. Gabimet në kushtet e punës

Nën gabime të kushteve të punës (të jashtme) nënkuptohet i tërë grupi i gabimeve të cilat dalin nga kushtet reale në të cilat bëhen matjet e këndeve. Të gjitha matjet bëhen në sipërfaqe fizike të Tokës e cila është e rrethuar me atmosferën, karakteristikat optike të së cilës janë në ndryshim të përhershëm. Prandaj vizura (rrezja) nuk do të lëvizë në pozitën kënddrejtë prej instrumentit deri te sinjali, por do të lëvizë nëpër një lakore hapësinore, lakorja e vijës refrakcione. Komponenti i saj vertikal ka ndikim në matjet e këndeve horizontale, kurse komponenti horizontal ka ndikim të matjeve të këndeve horizontale dhe quhet *refrakcion*.

Asnjëherë nuk kemi mundësi që të mbledhim të dhëna të mjaftueshme të cilat në mënyrë objektive do të karakterizojnë detalin nga atmosfera nëpër të cilën kalon vizura. Prandaj trajektoren e lakores refrakcione nuk mund ta definojmë në mënyrë analitike dhe ta marrim ndikimin e saj negativ, që ë masë të madhe e zvogëlon saktësinë e matjes së këndeve. Sjellja e lakores refrakcionuese gjatë ditës ndryshohet varësisht nga kushtet meteorologjike. Me zgjedhje të volitshme të kohës për matje të këndeve ndikimi i saj mund të zvogëlohet, por asnjëherë absolutisht nuk mund të mënjanohet nga rezultatet e matjes. Shtresat e tokës në atmosferë janë në luhatje të përhershme (ndryshime). Me atë ndryshohet karakteristika fizike e atmosferës, respektivisht ndikimi i refrakcionit nuk është i përhershëm gjatë ditës, por gjithmonë ndryshohet. Ndryshimet e tilla posaçërisht janë të mëdha gjatë ndryshimit të përnjëhershëm të temperaturës, shtypjes dhe lagështisë së ajrit.

Periudha e imazheve të qeta (të volitshme për matje) në ditët me diell, të nxehta dhe verore, është mjaft e shkurtë. Atëherë këndet maten prej orës 10 paradite dhe pas orës 16 padite, e nëse nuk kërkohet ndonjë saktësi më e madhe, matjet mund të bëhen edhe gjatë tërë ditës. Rezultate më të mira të matjes së këndeve arrihen gjatë lindjes së diellit, respe-

ktivisht gjysmë orë pas lindjes dhe pas perëndimit të diellit. Në kohën e vranët matjet mund të bëhen gjatë tërë ditës.

Periudha kohore e cila gjatë ditës mund të shfrytëzohet për matje të këndeve horizontale, më tepër varet nga kushtet meteorologjike, konfiguracioni i terrenit dhe vegetacioni.

Periudha e imazheve të qeta është më e gjatë në terrenet kodrinore ku vegetacioni nuk është i dendur. Ndikimi i dëmshëm të refrakcionit anësor posaçërisht vjen në shprehje kur vizura kalon mbi objektet e nxehura të ndërtuara në mënyrë artificiale, drejtpërdrejt mbi sipërfaqen ujore (liqene, moçale etj.) dhe në territoret pyjore, e posaçërisht në pyll dhe bimë të tjera (fig. 4.).




Fig. 8.4. Refrakcioni.

8.3.2. Gabimet personale të operatorit

Shumë është e rëndësishme përvoja në operator (posaçërisht kur leximet bëhen me ndihmë të koincidimit) në zvogëlimin e gabimeve të leximit dhe vijëzimit, e me vetë këtë edhe rritja e saktësisë së matjes së këndeve. Operatori me përvojë më të madhe dhe me profesionalitet më të madh ka ndjenjë më të madhe për saktësi, prandaj me kujdes më të madh sillet ndaj gabimeve të cilat mund të paraqiten në procesin e matjeve. Por, përkundër kujdesit më të madh, disa gabime mbeten të fshehura dhe nuk kemi mundësi të ndikojmë tek ato.

Veçoritë fiziologjike të syve, gjithashtu, vinë në shprehje te matjet me precizitet të lartë të këndeve. Ndjeshmëria e organit për pamje, disponimi dhe përqendrimi i operatorit ndikojnë ndaj saktësisë së rezultateve të matjeve. Ky ndikim individual i operatorit të vlefshmërisë

së këndeve matëse quhet gabim individual i operatorit. Ai ka karakter të rastit dhe sistematik, d.m.th. operatori A gjithmonë fiton vlera më të mëdha ose më të vogla sesa operatori B. Përvoja e operatorit dhe veçoria e të pamurit të tij janë me rëndësi të veçantë gjatë matjes së këndeve. Operatori i mirë do të matë vetëm kur do të jetë i bindur se kushtet për matje janë të mira dhe se mund ta kënaqë pre përpara saktësinë e definuar. Në të kundërtën, do të heqë dorë nga matja dhe do të vazhdojë kur do të jetë të volitshme kushtet për matje.

9. MATJA E KËNDEVE VERTIKALE

9.1. KËNDET VERTIKALE DHE DISTANCA E ZENITIT

Kahja e vertikales, siç u theksua, mund të materializohet me ndihmë të perit në të cilën është varur lavjerrësi. Kahja e perit në një lavjerrës të qetë ideal e prek sferën qiellore* mbi rrafshin horizontal në pikën të cilën e quajmë *zenit*. Pika e prekjës së vertikales nëpër sferën qiellore nën horizont, quhet *prekje*. Rrafshi i cili është normale e kahjes së vertikales quhet *rrafsh horizontal (horizont)*. Prerjet e rrafshit vertikal me rrafshet horizontale japin drejtëza horizontale. Drejtëzat të cilat nuk shtrihen në rrafshet horizontale nuk janë horizontale, por me atë zënë ndonjë kënd. Këndi ndërmjet ndonjë drejtëze dhe rrafshit horizontal quhet *kë vertikal (a)*. Këndi vertikal matet në rrafshin vertikal i cili e përmban atë drejtëz. Këndet vertikale (do të shihet më vonë) maten me ndihmë të teodolitit i cili ka limbë vertikale. Këndi vertikal është kënd i cili e zë kahjen e vizurës me rrafshin horizontal. Nëse stacioni dhe pika vizure janë në rrafshin e njëjtë horizontal, d.m.th. në lartësi të një, vlera e këndit vertikal është zero. Nëse pika vertikale është mbi horizontalen e stacionit, këndi vertikal është pozitiv dhe mund t'i ketë vlerat prej 0° deri 90° , e në rastin e vizurës pika është nën horizontin e stacionit, këndi vertikal ka shenjë negative, por mund t'i ketë vertikale prej -90° deri 0° . Këndet pozitive vertikale (të lartësisë) i quajmë edhe kënde elevacione, kurse këndet negative i quajmë edhe kënde depresive.

* Sfera qiellore është sferë me rreze të pafund. Qendra e sferës përputhet me syrin e vrojtuesit. Horizonti është rreth i prerjes së rrafshit horizontal, i cili kalon nëpër syrin e vrojtuesit, me sferën qiellore.

Afër këndeve vertikale përdoret edhe vlera e distancës së zenitit Z . Distanca e zenitit është vlera e këndit i cili fitohet me rrotullim të kahjes së vertikales në kahjen e lëvizjes së akrepave të orës derisa nuk përputhet me kahjen e dhënë. Distanca e zenitit mund t'i ketë vlerat prej 0° deri 180° . Distanca e zenitit të horizontales është 90° , kurse, në anën tjetër, për pikat të cilat gjenden nën horizont është 90° . Në fig. 9.1. shihet se gjithmonë është i kënaqur kushti:




Fig. 9.1. Distanca e zenitit dhe këndi vertikal.

$$\alpha + Z = 90^\circ .$$

Shembulli 9.1: Të caktohet distanca e zenitit Z nëse janë dhënë këndet vertikale:

$$\alpha_1 = +18^\circ 26' 30'' \quad \text{dhe} \quad \alpha_2 = -17^\circ 43' 18'' .$$

Zgjidhje:

$$Z_1 = 90 - \alpha_1 = 71^\circ 33' 30''$$

$$Z_2 = 90 - \alpha_2 = 107^\circ 43' 18'' .$$

Shembulli 9.2: Të caktohen këndet vertikale nëse janë dhënë distancat e zenitit Z :

$$Z_1 = 82^\circ 40' 25'' \quad \text{dhe} \quad Z_2 = 96^\circ 11' 42'' .$$

Zgjidhje:

$$\alpha_1 = 90 - Z_1 = +7^\circ 19' 35''$$

$$\alpha_2 = 90 - Z_2 = -6^\circ 11' 42'' .$$

9.2. INSTRUMENTET PËR MATJE TË KËNDEVE VERTIKALE (DISTANCAT E ZENITIT)

Teodolitet të cilat janë dedikuar për matje të këndeve vertikale, respektivisht distancat e zenitit patjetër duhet të kenë limbën vertikale. Te të gjitha teodolitet limba vertikale*, bashkë me dylbinë, është lidhur fort për boshtin rrotullues të dylbisë, prandaj bashkë rrotullohen rreth boshtit të rrotullimit të dylbisë. Boshti i rrotullimit dhe vrima rrotulluese i limbës vertikale, nëpër të cilën kalon boshti i rrotullimit, patjetër duhet të jenë të përpunuara ashtu që qendra e ndarjes së limbës të gjendet saktë në boshtin e rrotullimit të dylbisë. Nëse qendra e ndarjes nuk përputhet me boshtin e rrotullimit, thuhet se ekziston ekscentriciteti të limbës vertikale. Mënjanimi i ndikimit të ekscentricitetit të limbës vertikale në rezultatet e leximeve të ndarjes së tyre arrihet, si edhe te limba horizontale, me lexim të ndarjes në dy vende diametralisht të kundërta dhe marrjes së vlerës mesatare të leximeve.




Fig. 9.2. Libela e limbës vertikale.

Në anën e kundërt të limbës horizontale, e cila i pranon matjet, patjetër duhet të jetë e palëvizshme, limba vertikale lëviz, por prandaj te limba vertikale indeksat e leximit të ndarjes së limbës, respektivisht

* Në vend të emërimit limba vertikale shpesh përdoret rrethi vertikal ose vetëm rrethi.

mbajtja e indekseve për lexim gjithmonë në vendin e njëjtë, arrihet me ndihmën e limbës gypore e cila është vendosur në mbajtësin e indekseve (fig. 9.2.). Që të zhvendoset flluska e kësaj libele që të lëvizë shfrytëzohet vida gjegjëse mikrometrike. Gjatë leximit të ndarjes së limbës vertikale, për shkaqe të përmendura, patjetër në gjatësi ta vendosim flluskën e limbës që të lëvizë.

Te teodolitet me konstruksion të ri, limba vertikale është mbrojtur nga dëmtimet me alkidadën e limbës vertikale dhe libelën për mbajtje të indeksit në vendin e njëjtë. Është e qartë se saktësia e mbajtjes të indeksit varet nga ndjeshmëria e limbës, prandaj edhe saktësia e matjes të këndeve vertikale varet nga ndjeshmëria e limbës të limbës vertikale.

Disa konstruksione të reja të teodoliteve, në vend të libelave të limbës vertikale, kanë edhe pajisje kompensuese, *kompensator* i cili vetë automatikisht e mban indeksin për lexim të ndarjes të limbës vertikale në pozitë të njëjtë. Kompensatori mund të veprojë vetëm nëse boshti alkidad është sjellë në pozitë të përafërt vertikale. Saktësia e sjelljes së boshtit alkidadid në pozitën vertikale, kur kompensatori vepron sillet disa minuta ($3' - 5'$) dhe quhet fusha e kompensimit.

Limba vertikale bëhet nga materiali i njëjtë dhe me procedurë të njëjtë si edhe limbat horizontale, por me pak diametër më të vogël nga ato horizontale. Megjithatë, te limba vertikale ndarja nuk është gjithmonë në kahje të njëjtë. Ndarja e limbës mund të sillet në kahjen e lëvizjes së akrepave të orës, kur me atë maten distancat e zenitit (fig. 9.3a.) ose, në anën tjetër, në kahjen e kundërt nga kahja e lëvizjes së akrepave të orës kur maten këndet vertikale (fig. 9.3b.)




Fig. 9.3. Ndarja e limbës vertikale.

Në rastin e parë (fig. 9.4a.), kur vizura është horizontale, në limbën vertikale lexohet 90° , nëse dylbia ngritet mbi horizont të indeksit lëvizës gjenden leximet ($89^\circ, 88^\circ, \dots$) prej 90° kah 0° (fig. 9.4a.), kurse, në anën tjetër, me lëshimin e dylbisë nën horizont (fig. 9.4b.) në indeksin për lexim gjenden vlerat e ndarjeve më të mëdha se 90° ($91^\circ, 92^\circ, \dots$), respektivisht me atë instrument maten distancat e zenitit.




Fig. 9.4. Pozita e indeksit për lexim të distancës së zenitit.

Në rastin e dytë (fig. 9.5b.), kur vizura është horizontale, në limbën vertikale lexohet 0° , nëse dylbia ngritet mbi horizont të indeksit (fig. 9.5a.), përveç indeksit lëvizës për lexim gjenden vlerat ($1^\circ, 2^\circ, \dots$) prej 0° deri 90° . Kur, në anën tjetër, dylbinë do ta lëshojmë nën horizont (fig. 9.5b), kur këndet vertikale janë negative, afër indeksit për lexim të ndarjes gjenden vlerat ($359^\circ, 358^\circ, \dots$) më pak se 360° . Vlerat e këndeve

negative do t'i fitojmë me plotësim deri 360°, megjithatë në vend të vlerave negative të këndeve, mund të shfrytëzohen drejtpërdrejt vlerat e lexuara të limbës vertikale.




Fig. 9.5. Pozita e indeksit për lexim të këndeve vertikale.

Leximet e kryera njëkohësisht do të jenë distancat e zenitit, respektivisht këndet vertikale vetëm në rast kur gjatë vizurës horizontale leximet e limbës vertikale janë 90°, respektivisht 0°. Kur dylbia është e pozitë të parë, limba vertikale gjendet pranë anës së saj të majtë, prandaj leximi i tillë quhet rreth i majtë dhe shënohet me *RM*, për dallim nga leximet gjatë rrethit të djathtë, kur limba vertikale është nga ana e djathtë e dylbisë, që shënohet me *RD*.




Fig. 9.6. Limba vertikale për mape të distancës së zenitit.

Te teodolitet të cilat në pjesën e jashtme të alkidadës së limbës vertikale kanë dy mikroskopë ose dy llupa, në pozitën e parë të dylbisë së pari lexohet mikroskopi i cili është më afër okularit, si mikroskop i parë, e pastaj më afër ai te objekti, si mikroskop i dytë. Në pozitën dytë të dylbisë së pari lexohet mikroskopi i cili është më afër objektit, e pastaj mikroskopi i cili është më afër okularit.

Është e nevojshme të shihet se çfarë arrihet kur këndet vertikale matem në dy pozita të dylbisë. Sqarimet janë instaluar në vizatime në të cilat do të paraqitet vetëm një indeks i ndarjes së limbës, sepse në indeksin tjetër leximet bëhen për shkak të mënjanimit të ndikimit të ekscentricitetit të limbës vertikale. Do të supozojmë se gjatë vizurës horizontale leximet janë 90° , respektivisht 0° .

a) Limba vertikale është ndarë në kahjen e lëvizjes së akrepave të orës, me ndihmën e të cilëve bëhet matja e distancave të zenitit.

Me *VV* shënohet leximi i cili do të fitohet në limbën vertikale nëse dylbinë e vendosim në kahjen e zenitit, respektivisht nëse vizura do të ishte vertikale. Në figurat është paraqitur limba e cila gjendet në pozitën parë. Le të jetë, si në fig. 9.6., indeksi i leximit të ndarjes nën horizont në qendër të pozitës së limbës. Nëse boshti alkidant është vertikal, atëherë drejtëza e cila e lidh indeksin për lexim dhe ndarjen e limbës, gjatë rrotullimit të alkidadës do të përshkruajë kon.

Dylbia është vendosur kah objekti, flluska e limbës së alkidadës është vendosur që të lëvizë, tek indeksi I, i cili është më afër okularit, bëhet leximi gjatë rrethit majta:

$$KL = Z + VV.$$

Pastaj dylbinë e rrotullojmë në pozitën e dytë dhe sërish vijëzohet pika e njëjtë. Indeksi i leximit të ndarjes do të jetë më afër thjerrës së objektivit. Për shkak të rrotullimit të dylbisë në pozitën dytë dhe rrotullimit të alkidadës për 180° , limba vertikale vjen nga ana e djathtë, kurse ndarja e limbës duket si në fig. 9.6c. Leximi i rrethit djathtas, sipas fig. 9.6c. do të jetë.

$$KD = 360^\circ - (Z - VV) = 360^\circ - Z + VV.$$

Kur do të mblidhen të dy barazimet e fundit, do të fitohet ky barazim:

$$KL + KD = 360^\circ + 2VV,$$

dhe fitojmë:

$$VV = \frac{KL + KD - 360^\circ}{2}$$

që paraqet lexim të ndarjes së limbës që përgjigjet gjatë vizurës horizontale. Nëse, në anën tjetër, i lidhim barazimet e njëjta, do të fitojmë:

$$KL - KD = Z - 360^\circ + Z = 2Z - 360^\circ$$

$$Z = \frac{KL + 360^\circ - KD}{2}$$

respektivisht mundësi që të zhvendoset leximi i ndrequr i distancës së zenitit, pa dallim të asaj se çfarë në horizont nuk lexohet 90° , respektivisht $VV \neq 0$.

Shembulli 9.3: Të njehsohet leximi i cili përgjigjet vizurës vertikale dhe distancës së zenitit nëse leximet janë:

a) $KL = 86^\circ 26' 30''$, $KD = 273^\circ 35' 00''$

Zgjidhje:

$$KL + KD = 360^\circ 01' 30'' = 2VV + 360^\circ$$

$$2VV = 0^\circ 01' 30''$$

$$VV = 0^\circ 00' 45''$$

$$2Z = KL + 360^\circ - KD = 172^\circ 51' 30''$$

$$Z = 86^\circ 25' 45''.$$

b) $KL = 93^\circ 11' 40''$, $KD = 266^\circ 48' 00''$

Zgjidhje:

$$KL + KD = 359^\circ 59' 40'' = 2VV + 360^\circ$$

$$2VV = 0^\circ 00' 20''$$

$$VV = 0^\circ 00' 10''$$

$$2Z = KL + 360^\circ - KD = 188^\circ 23' 40''$$

$$Z = 93^\circ 11' 50''.$$

Pozita e parë e dylbisë:

Pozita e dytë e dylbisë:




Fig. 9.7. Limba vertikale për matje të këndeve vertikale.

b) Limba vertikale, ndarja e së cilës është në kahje të kundërt të kahjes së lëvizjes së akrepave të orës me çka maten këndet vertikale (fig. 9.7.).

Le të jetë, si në fig. 9.7., indeksi i leximit të ndarjes së limbës mbi horizont të qendrës së ndarjes së limbës. Ai do të mbetet në pozitë të njëjtë gjatë rrotullimit të alkidës rreth boshtit vertikal të alkidës.

Me HV është shënuar leximi i cili do të fitohet në limbën vertikale kur vizuar është horizontale. Limba vertikale gjendet ë anën e majtë të operatorit, respektivisht në pozitën e parë, prandaj sipas fig. 9.7a. do të jetë:

$$KL = \alpha + HV.$$

Pastaj dylbinë e vendosim në pozitën dytë dhe sërish e vijëzojmë pikën e njëjtë. Indeksi për lexim të ndarjes së limbës do të jetë më afër thjerrëzës së objektivit, por përsëri mbi horizont. Zeroja e limbës do të jetë tek okulari i dylbisë, por vijëza e cila tregon 90° do të jetë nën horizont në qendër të ndarjes së limbës (fig. 9.7b.). Leximi i ndarjes së limbës gjatë rrethit djathtas do të jetë:

$$KD = 180^\circ - (\alpha - HV) = 180^\circ - \alpha + HV.$$

Kur do të mblidhen të dy barazimet e fundit, do të fitojmë:

$$KL + KD = 180^\circ + 2HV,$$

respektivisht:

$$HV = \frac{KL + KD - 180^\circ}{2},$$

lexim të ndarjes së limbës vertikale, e cila i përgjigjet pozitës horizontale të vizurës. Nëse barazimet i zbresim, do të fitojmë:

$$KL - KD = 180^\circ + 2\alpha$$

ose

$$\alpha = \frac{KL - KD + 180^\circ}{2}.$$

Vlerën e saktë të këndit vertikal e fitojmë nga barazimi i fundit, pa dallim të asaj se gjatë vizurës horizontale leximi nuk ka qenë 0° .

Shembulli 9.4: Në bazë të leximit të ndarjes ε limbës vertikale, gjatë rrethit majtas dhe djathtas, të njehsohet leximi i cili përgjigjet në këndin vertikal α .

a) $KL=6^\circ 26' 10''$, $KD=173^\circ 35' 50''$

Zgjidhje:

$$\begin{aligned} KL + KD &= 180^\circ 02' 00'' = 180^\circ + 2HV \\ 2HV &= -0^\circ 02' 00'' & HV &= -0^\circ 01' 00'' \\ 2\alpha &= KL - (KD - 180^\circ) = +12^\circ 50' 20'' & \alpha &= +6^\circ 25' 10''. \end{aligned}$$

b) $KL=354^\circ 20' 40''$, $KD=185^\circ 38' 00''$

Zgjidhje:

$$\begin{aligned} KL + KD &= 539^\circ 58' 40'' = 540^\circ + 2HV \\ 2HV &= -0^\circ 01' 20'' & HV &= -0^\circ 00' 40'' = 359^\circ 59' 20'' \\ 2\alpha &= KL - (KD - 180^\circ) = 11^\circ 17' 20'' & \alpha &= +5^\circ 38' 40''. \end{aligned}$$

Shembulli i përmendur tregon se formulat e dhëna mund të përdoren gjithmonë me këtë vërejtje: nëse këndi vertikal është negativ, në vend të vlerës negative të këndit në të majtë lexohet plotësimi i tij deri 360° , respektivisht lexohet vlera e këndit të zmadhuar për 360° . Ngase

leximi KL ëshët zmadhuar për 360° , shuma $KL + KD$ do të zmadhohet për 360° dhe do të jetë afërsisht 540° .

9.3. KUSHTET E INSTRUMENTEVE ME LIBELË

Është e njohur se gjatë matjes së këndeve vertikale (distancave të zenitit) në të dy pozitat e dylbisë fitohen kënde të drejta vertikale pa dallim të asaj se vallë instrumenti i kënaq të gjitha kushtet ose nuk i kënaq. Megjithatë, gjatë matjes së këndeve vertikale vetëm në një pozitë të dylbisë, nuk do të fitohen rezultatet e sakta.

Kusht i vetëm i dhënë i cili duhet të plotësohet teodoliti, i cili është dedikuar edhe për matje të këndeve vertikale (distancave të zenitit) është që gjatë vizurës horizontale leximi i limbës vertikale të jetë 0° (90°). Mënyra e kontrollimit të këtij kushti varet nga lloji i teodolitit.

9.3.1. Teodolitet me libelë të thjeshtë gypore

Këto teodolite së pari patjetër duhet t'i këndin kushtet si edhe teodolitet për matje të këndeve horizontale, e pastaj edhe kushtet për matje të këndeve vertikale. Do t'i përsëritim kushtet të cilat patjetër t'i plotësojnë teodolitet e dedikuara për matje të këndeve horizontale.

Kushti i parë: Boshti i libelës gypore të jetë normal me boshtin alkidant, respektivisht boshti alkidant të jetë vertikal në hapësirë.

Kushti i dytë: Vizura të jetë normale me bishtin rrotullues të dylbisë.

Kushti i tretë: Vija vertikale e penjëzorit të jetë vertikale në lartësi.

Kushti i katërt: Boshti rrotullues i dylbisë të jetë normal me boshtin alkidant.

Meqë janë kontrolluar edhe kushtet e përmendura rektifikuese, kalohet në kontrollimin e kushteve të cilat duhet t'i plotësojnë teodolitet për matje të këndeve vertikale (distancave të zenitit).

Kushti i pestë: Boshti i libelës së dylbisë patjetër duhet të jetë paralel me vizurën.

Që të kontrollohet kushti i tillë është e nevojshme që në terren të rrafshët të shënohen dy pika në distancë reciproke prej 80 deri 100 m, kurse teodoliti të vendose në midis (fig. 9.8.).

Kur boshti alkidant është dhënë në pozitën vertikale, së pari vizohet hatulla e cila është vendosur vertikalisht në pikën A, vendoset fluska në libelë të dylbisë që ë lëvizë dhe bëhet leximi i hatullës l_A .




Fig. 9.8. Plotësimi i kushtit të pestë

Pastaj vizohet hatulla në pikën B, sillet fluska në libelë që të lëvizë dhe lexohet vlera l_B . Të supozojmë se kushti i përmendur për pozitë paralele nuk është plotësuar, prandaj kur fluska në libele të dylbisë do të lëvizë, vizura nuk është horizontale, por me horizontin zë këndin i . Për këtë shkak leximi i hatullës do të i gabueshëm për këto vlera:

$$\Delta_A = S \cdot i, \text{ dhe}$$

$$\Delta_B = S \cdot i.$$

Në bazë të leximeve në pozitën të ndarjeve të majta mund të gjenet ndryshimi i vërtetë midis pikave A dhe B:

$$\Delta H_A^B = (l_A - \Delta_A) - (l_B - \Delta_B),$$

$$\Delta H_A^B = (l_A - l_B) - (\Delta_A - \Delta_B).$$

Nga formulat e përmendura mund të shihet se gabimet e leximeve midis vete janë të barabarta:

$$\Delta_A - \Delta_B, \text{ prandaj është } \Delta H_A^B = l_A - l_B$$

respektivisht ndryshimi në lartësi ΔH_A^B do të jetë i saktë pa dallim të asaj se vizura nuk është paralele me boshtin e libelës së dylbisë, respektivisht nuk është horizontale.

Pastaj instrumentin e vendosim “nga fundi”, respektivisht e vendosim pas njëres nga pikat në 3 – 4 m, dhe nga ai vend, kur flluska në libelën e dylbisë do të lëvizë, lexohen vlerat e ndarjeve të hatullave në pikat A dhe B l_A dhe l_B). Pika A gjendet më afër instrumentit, prandaj gabimi i ndarjes ϵ hatullës, për shkak të pozitës jo horizontale të vizurës, është mjaft i vogël. Megjithatë, gabimi i leximit të ndarjes së hatullës në pikën B do të jetë mjaft i madh, prandaj ndryshimi në lartësi i caktuar deri në fund, si i gabueshëm, nuk do të përputhet me atë ndryshim në lartësi i cili është larguar nga mesi, që është i saktë. Nëse ndryshimet në lartësi, të fituara nga mesi dhe nga fundi midis veti përputhen, kjo do të jetë shenjë se kushti është kënaqur.

Që ta rektifikojmë instrumentin, është e nevojshme që:

- leximi i hatullës në pikën A, të fituar nga fundi, të merret si i drejtë (i saktë);
- në vlerën e tij të shtohet (të hiqet) ndryshimi në lartësi i caktuar nga mesi, dhe ky do të ishte leximi në pikën B i cili i përgjigjet vizurës horizontale;
- duke e zhvendosur dylbinë me vidë mikroskopike, vendoset leximi i njehsuar nga hatulla në pikën B, për ç’arsye flluska në libelë do të zmbrahet;
- me vidën korrigjuese të libelës së dylbisë të sillet flluska që të lëvizë.

Shembulli 9.5: Për shkak të kontrollit të kushteve të paralelitetit të boshtit të libelës të dylbisë dhe vizurës, është bërë leximi i ndarjeve të hatullës nga mesi

$$l_A = 1,898 \quad l_B = 1,266$$

dhe nga skaji

$$l'_A = 1,375 \quad l'_B = 1,216.$$

Të gjendet leximi i hatullës në pikën B, në të cilën duhet të vendoset që vizura ta gjejë pozitën horizontale, e pastaj bëhet rektifikimi i libelës së dylbisë.

Zgjidhje:

$$\Delta H_A^B = l_A - l_B = +0,632m$$

$$\Delta H_A'^B = l'_A - l''_B = +0,159m$$

$$l''_B = l_A - \Delta H_A^B = 1,375 - 0,632 = 0,743.$$

Kushti i gjashtë: Leximi i rrethit vertikal gjatë vizurës horizontale patjetër duhet të jetë 0° ose 90° .

Ngase është plotësuar kushti i mëparshëm, me zhvendosje të dylbisë me vidë mikroskopike, vendoset fluska në libelë të dylbisë që të lëvizë. Me atë vizura është sjellë në pozitë horizontale. Me vidën mikrometrike të alkidadës në limbën vertikale zhvendosen indekset për lexim në ndarjen e limbës vertikale deri sa nuk vendoset leximi i limbës vertikale të jetë 0° ose 90° . Pastaj me vidën korigjuese të libelës së alkidadës në limbën vertikale sillet fluska në libelë që të lëvizë, me çka është bërë rektifikimi.

9.3.2. Teodolitet me libelë reversione

Kur në dylbinë teodolite është vendosur libela reversione, teodoliti patjetër duhet t'i plotësojë tërësisht kushtet e njëjta si edhe teodoliti i cili në dylbinë e tij ka libelë të thjeshtë gypore. Ndryshimi i vetëm te këto dy lloje teodolite është ë mënyrën e kontrollimit të kushtit të pestë i cili thotë: boshti i libelës së dylbisë duhet të jetë paralel me vizurën.

Që të kontrollohet ky kusht, është e nevojshme që terrenin e afërt horizontal, por në distancë 50 – 60 m, vertikalisht të vihet hatulla. Viçezohet hatulla në këtë pozicion të dylbisë kur libela është nën dylbinë, sillet fluska e tij që të lëvizë (me ndihmën e vidës mikroskopike) dhe lexohet ndarja e hatullës l_1 . Pastaj dylbia vihet në pozitë ashtu që libela të

jetë nga ana e sipërme të dylbisë dhe me vidë mikroskopike sillen fluska në libelë që të lëvizë dhe lexohet hatull l_2 (fig. 9.9.).




Fig. 9.9. Kontrollimi i kushtit të pestë.

Leximet l_1 dhe l_2 bëhen me perin e mesëm të penjësorit. Nëse leximet e ndarjes së hatullës l_1 dhe l_2 nuk ndryshojnë më tepër prej 2 deri 3 mm, llogaritet se kushti i paraleles së boshtit të libelës dhe vizurës është plotësuar. Nëse, në anën tjetër, ndryshimi është më i madh, patjetër duhet të bëhet rektifikimi sipas këtij rendi:

- njehsohet vlera mesatare e leximit:

$$l = \frac{l_1 + l_2}{2};$$

- dylbia zhvendoset me vidë mikroskopike derisa vizura nuk sillen në vlerën mesatare të leximit l , për ç'arsye do të shmanget fluska në libelë të dylbisë
- shmangia e krijuar e fluskës në libelë asgjësohet me vidën korrigjuese të libelës.

Shembulli 9.6: Me çfarë saktësie mund të kontrollohet kushti i paraleles së boshtit reversione të libelës dhe vizurës nëse hatulla është larguar nga instrumenti 50 m, kurse ndryshimi i leximit të ndarjes së hatullës është më tepër se 1 mm?

Zgjidhje:

$$\varepsilon'' = \rho'' \frac{e}{S} = 206265'' \frac{1}{50000} = 4''.$$

9.3.3. Teodolitet pa libelë në dylbi

Teodolitet të cilat nuk kanë libelë në dylbi pas kontrollimit dhe rektifikimit të kushteve të cilat janë të nevojshme për matjen e këndeve horizontale, patjetër duhet të plotësojnë vetëm një kusht i cili thotë: leximi i limbës vertikale gjatë vizurës horizontale patjetër të jetë 0° ose 90° . Me fjalë të tjera, vlerat e VV dhe HV duhet të jenë zero. Ky kusht do të plotësohet kush shuma e leximeve do të jetë e barabartë me:

$$KL + KD = 360^\circ$$

te teodolitet të cilat janë dedikuar për matjen e distancës së zenitit, respektivisht:

$$KL + KD = 180^\circ,$$

te teodolitet të cilat janë dedikuar për matje të këndeve vertikale. Që të plotësohet ky kusht është e nevojshme:

– në pozitën parë të dylbisë, d.m.th. rrethi majtas të vijëzohet një pikë e mirë e dukshme dhe stabile me vijë horizontale të penjëzorit, të bëhet kontrolli dhe të sillet flluska në alkidadë të limbës vertikale që të lëvizë dhe të lexohet vlera e ndarjes së limbës KL ;

– të vihet dylbia në pozitën dytë (rrethi djathtas), të vijëzohet me pe horizontal e njëjta pikë, të bëhet kontrolli dhe të sillet flluska në alkidadës të limbës vertikale dhe të lexohet vlera e ndarjes së limbës KD ;

– të mblidhen leximet $KL + KD$ dhe të shihet a plotësohet kushti $KL + KD = 360^\circ$, respektivisht $KL + KD = 180^\circ$. Ndryshimi i shumave të leximeve prej 360° ose 180° duhet të pjesëtohen me dy, pra me këtë shumë edhe të dy leximet ose të zmadhohen ose të zvogëlohen, ashtu që të fitohet shuma 360° ose 180° . Vlerat e tilla të përmirësuara të lexohen që të fitohet kur kushti do të jetë i kënaqur;

– të rektifikohet ky kusht, më mirë është me vidën përkatëse mikroskopike pak të rrotullohet në limbën vertikale, e me atë edhe indeksi për lexim të ndarjes deri sa nuk vendoset leximi i ndrequr i zhvendosur. Pastaj flluska në libelë të limbës vertikale do të shmanget.

Shmangia e fluskës së libelës duhet të eliminohet me ndihmën e vidës korrigjuese të libelës, me çka rektifikimi ka përfunduar.

Shembulli 9.7: Për shkak të kontrollimit të kushtit se gjatë vizurës horizontale leximi i vidës vertikale duhet të jetë 90° ose 0° , është bërë leximi i ndarjes në limbën vertikale (KL dhe KD) me katër teodolite të ndryshme. Për çdo nga ato të llogariten leximet e ndrequra KL dhe KD , kurse shumat e tyre të jetë 360° ose 180° .

$$a) \quad KL = 88^\circ 50' 40'' \qquad KD = 271^\circ 08' 20''$$

Zgjidhje:

$$KL + KD = 359^\circ 59' 00'' \qquad 2VV = 1' 00''$$

$$VV = 0' 30''$$

$$KL' = 88^\circ 51' 10'' \qquad KD' = 271^\circ 08' 50''$$

$$KL' + KD' = 360^\circ 00' 00''.$$

$$b) \quad KL = 80^\circ 19' 30'' \qquad KD = 279^\circ 41' 40''$$

Zgjidhje:

$$KL + KD = 360^\circ 01' 10'' \qquad 2VV = -1' 10''$$

$$VV = -0' 35''$$

$$KL' = 80^\circ 18' 55'' \qquad KD' = 279^\circ 41' 05''$$

$$KL' + KD' = 360^\circ 00' 00''.$$

$$c) \quad KL = 17^\circ 23',8 \qquad KD = 162^\circ 38',4$$

Zgjidhje:

$$KL + KD = 180^\circ 02',2 \qquad 2HV = -2',2$$

$$HV = -1',1$$

$$KL' = 17^\circ 22',7 \qquad KD' = 162^\circ 37',3$$

$$KL' + KD' = 180^\circ 00' 00''.$$

$$d) \quad KL = 347^\circ 19',1 \qquad KD = 192^\circ 40',1$$

Zgjidhje:

$$KL + KD = 179^\circ 59',2 + 360^\circ \qquad 2HV = 0',8$$

$$HV = 0',4$$

$$KL' = 347^\circ 19',5 \qquad KD' = 192^\circ 40',5$$

$$KL' + KD' = 180^\circ 00' 00''.$$

Saktësia e kryerjes së rektifikimit është kufizuar me saktësinë e vizimit, leximit dhe ndjeshmërisë së libelës. Për shembull, nuk mund të arrihet rektifikimi i teodolitit njësekondar me saktësi prej disa sekondave nëse në atë do të ishte montuar libela, ndjeshmëria e së cilës është 20”.

Teodolitet të cilat kanë libelë në dylbi mund të përdoren edhe në punët nivelmane. Ndjeshmëria e libelës së dylbisë, me të drejtë, është më e madhe nga ndjeshmëria e libelës në alkidatën e limbës vertikale. Prandaj, te teodolitet e tillë kontrollimi dhe rektifikimi bëhen siç është shpjeguar këtu. Nëse ndjeshmëria e libelës në alkidës e limbës vertikale është e madhe nga ndjeshmëria e libelës së dylbisë, atëherë kontrollimi i kushteve, të cilat janë të nevojshme për matjen e këndeve vertikale, duhet të bëhen sipas kësaj renditjeje: së pari kontrollohet dhe kënaqet kushti që leximi i limbës vertikale gjatë vizurës horizontale të jetë 0° ose 90° , me atë që vijëzohet një pikë në të dy pozitat e instrumentit, e në bazë të kësaj vendoset dylbia në pozitën horizontale. Nëse ë atë pozitë flluska e libelës së dylbisë shmanget, e sjellim që të lëvizë me ndihmën e vidës korigjuese të libelës.

Kur këndet vertikale maten në të dy pozitat e dylbisë, nuk është e domosdoshme që tërësisht të plotësohet kushti gjatë vizurës horizontale që leximi i limbës vertikale të jetë 0° ose 90° , sepse me ndihmën e zhvendosjes bëhen vlera të sakta të këndeve vertikale. Megjithatë, gjatë matjes së këndeve vertikale në një pozitë të dylbisë, mosplotësimi i kushteve të përmendura me sasi të plotë do t'i ngarkojë të gjitha leximet në limbën vertikale. Prandaj ky kusht patjetër duhet të plotësohet mirë dhe në mënyrë logjike kur këndet vertikale maten vetëm në një pozitë të dylbisë.

Gabimi i ekscentricitetit të limbës vertikale, si edhe limbës horizontale, mënjanohet me leximin e pozitës së limbës në dy vende diametrikisht të kundërta.

Në mënyrë të njëjtë mund ta përcaktojmë ekzistimin e ekscentricitetin e limbës vertikale.

Në të dy pozitat e dylbisë duhet të lexohen vlerat e KL dhe KD për shumë pika të cilat gjende në lartësi të ndryshme (me këtë arrihet mënjanimi i vizurës të jetë i ndryshëm për çdo pikë). Nëse për të gjitha

pikat shuma e leximeve $KL + KD$ ëshët afërsisht e njëjtë, do të thotë se nuk ekziston ekscentriciteti i limbës vertikale. Nëse ajo shumë ndryshon varësisht nga këndet vertikale, sipas ligjshmërisë të ngjashme me funksionin e sinusitit, atëherë kjo është shenjë se ekziston ekscentriciteti i limbës vertikale. Instrumentet me ekscentricitet të limbës vertikale dhe me një indeks për lexim të limbës vertikale, nuk janë për përdorim. Ndikimi i ekscentricitetit të limbës vertikale mund të mënjanohet edhe me vijëzim të pikës në të dy pozitat e dylbisë.

9.4. TEODOLITET ME KOMPENSATORË

Mbajtja e indeksit për lexim të ndarjes së limbës vertikale në vendin e njëjtë, gjatë matjes së këndeve vertikale, tek instrumentet klasike (teodolitet) arrihet me ndihmën e libelës në limbën vertikale (libelës në lartësi). Kur boshti i alkidadës në hapësirë do të qëndronte plotësisht vertikalisht, flluska e libelës në lartësi gjithmonë do të lëvizë. Ngase boshtin e alkidadës mund ta sjellim në pozitën vertikale, gjatë vijëzimit të pikave të ndryshme flluska e libelës do të shmanget. Prandaj nevojitet që gjatë çdo leximi të ndarjes së limbës vertikale patjetër duhet të sillet flluska e limbës në lartësi që të lëvizë. Saktësia e mbajtjes së indeksit për lexim të ndarjes së limbës vertikale varet nga ndjeshmëria e limbës në lartësi, me çka njëkohësisht kufizohet edhe saktësia e matjes së këndeve vertikale. Nëse, në anën tjetër, për shkak të zmadhimit të saktësisë së matjes së këndeve vertikale vendosim libelën në lartësi me ndjeshmëri më të madhe, gjatë matjeve do të jetë e nevojshme një kohë më e madhe për sjelljen e flluskës në pikën më të lartë (të lëvizë). E tërë kjo kërkon përqendrim më të madh gjatë matjeve, që e vardon kohëzgjatjen e matjeve të kahjeve dhe e zmadhon lodhjen e operatorit. Të mos flasim për rastet kur operatori fillestar harron edhe të shikojë flluskën e libelës, me çka menjëherë bën gabime të ashpra në matjet e tyre.

Kohëve të fundit shumë fabrika të cilat merren me përpunimin e instrumenteve gjeodezike tentojnë që ë vend të libelave në lartësi të përdorin pajisje për mirëmbajtje automatike të indeksit për lexim të ndarjes së limbës vertikale në vend të njëjtë. Pajisjet e tilla quhen *kompensatorë*. Ato janë me lloje të ndryshme, kurse dallohen sipas konstruksionit varësisht nga fabrika e cila i prodhon. Me futjen e kompensatorëve janë shmangur mangësitë e libelave në lartësi.

9.4.1. Kompensatori me saktësi tek instrumentet e firmës Wild T1 – A

Kompensator i tillë është ndërtuar tek instrumenti Wild T1 – A. Në rrugën e rrezes, nga indeksi I deri te ndarja e limbës, së pari gjendet objekti, pastaj prizmi qelqit i mbushur me lëng, indeksi i thyerjes së të cilit është $n = 1,4$ (fig. 9.10a.).




Fig. 9.10. Kompensatori me lëng te Wild.

Anët e skajshme të prizmit janë përpunuar nga metali, kurse anë poshtme dhe e sipërme janë nga qelqi (pika planparalele), trashësitë e

të cilave mund të shmangen. I tërë kompensatori është lidhur fort për mbajtësin e dylbisë.

Kur boshti i alkidadës në hapësirë qëndron vertikalisht, rrezja e cila kalon nga indeksi do të kalojë nëpër objektivin dhe prizmin me saktësi duke mos e ndërruar kahjen, sepse bie normal në sipërfaqen horizontale të lëngut.

Të supozojmë se boshti i alkidadës nuk është vertikal, por me vertikalen zë këndin δ . Këndi δ është kënd midis kahjes së vertikales dhe boshtit të alkidadës në rrafshin e vizurës vertikale (kolimatike).

Ngase boshti i alkidadës nuk qëndron vertikalisht, i tërë instrumenti, bashkë me kompensatorin, do të lakohet. Prandaj do të formohet thumbi i lëngët optik. Tash rrezja, e cila bie nga indeksi dhe shkon në boshtin optik të objektit, do të kalojë nëpër objektivi duke mos e ndryshuar kahjen e vet, derisa nuk vjen deri te thumbi i lëngët optik i cili do t'ia ndryshojë kahjen për këndin ε (fig. 9.101b).

Këndi i rrotullimit të rrezes ε do të jetë në funksion të këndit δ dhe indeksit të përthyerjes:

$$\varepsilon = (n - 1) \cdot \delta.$$

Zhvendosja lineare e indeksit për lexim të ndarjes së limbës:

$$e = d - \varepsilon = d \cdot (n - 1) - \delta$$

duhet të përgjigjet distancës për të cilën ndarja e limbës është më e madhe me jovertikalitetin e alkidadës:

$$e = R \cdot \delta,$$

prej ku mund të gjendet:

$$d \cdot (n - 1) \cdot \delta = R \cdot \delta,$$

$$d = \frac{R}{n - 1},$$

largësia e kunjit të lëngët nga ndarja: Në këtë mënyrë do të arrihet figura e ndarjes, edhe përkaj jovertikalitetit të boshtit të alkidadës, të bjerë në limbën në kahjen e vertikales në qendër të ndarjes së limbës.

Kompensatori kontrollohet në këtë mënyrë:

- nëse boshti i alkidadës është sjellë në pozitën vertikale, rregullohet leximi i limbës vertikale të jetë 90° ;
- në kahjen e njërës vidë apozicionale vendosim hatull vertikalisht të distancës prej 80 deri 100 m;
- me perin e mesëm të penjëzorit do të lexohet ndarja e hatullës;
- ndikohet në vidën pozicionuese, e cila është ën kahje të hatullës, derisa fluska e libelës së qendërzuar nuk shmanget deri te skaji i rrethit të caktuar të limbës;
- përsëri rregullohet dylbia ashtu që në limbën vertikale lexohet 90° ;
- në fund lexohet ndarja e hatullës 1_2 . Nëse leximet 1_1 dhe 1_2 nuk dallohen më tepër se 2 deri 3mm, kompensatori funksionon mirë. Në të kundërtën duhet të ndryshohet distanca d , që e bën vetëm serviseri i autorizuar. Në këtë rast, ngufatësi i oscilimeve nuk nevojitet sepse saktësia, për shkak viskozitetit të vet, qetësohet shpejt.

9.4.2. Kompensatori me lëng tek instrumentet e firmës Kern

Si kompensator tek instrumenti Kern DKM – 2a është përdorur lëngu (vaji special) i cili ndikon në parimin e refleksionit total. Lëngu është vendosur në një enë të mbyllur hermetikisht. Ena me lëng është vendosur në prizmin kënddrejtë të qelqit, indeksi i përthyerjes i të cilit është i njëjtë si indeksi i përthyerjes së lëngut.

Kur boshti alkidadid është vertikal, niveli i lëngut në enë qëndron horizontalisht, respektivisht normal me boshtin alkidadid. Rrezja e dritës, e cila e bart shëmbëlltyrën e ndarjes së limbës, kalon nëpër tërë prizmin. Pas kalimit të rrezes nëpër thjerrëz, rrezja vjen deri te prizmi nën enën me kënd të drejtë i , duke mos e kaluar kahjen, vjen deri te sipërfaqja e lëngut nën kënd prej 45° . Këtu rrezja dëbohet nën kënd të drejtë nëpër prizëm dhe thjerrëzën dhe në fund, pas përthyerjes nëpër

prizmin e djathtë vjen në rrafshin horizontal prej ku rrezja është nisur dhe në të cilin është qendra e ndarjes së limbës. Sipas kësaj, në fushën e dukshme të mikroskopit vijnë të dy skajet diametrikisht të kundërta të ndarjes së limbës, të cilat janë në horizont me qendrën ndarjes së limbës. Nëse është kënaqur kushti gjatë vizurës horizontale leximi të jetë 90° , atëherë leximi i limbës vertikale njëkohësisht do të jetë edhe në distancë të zenitit. Ngase ën fushën dukshme të okularit – mikroskopit sillen të dy skajet e diametrikisht të kundërta të ndarjes së limbës, leximi i kryer do të lirohet nga ndikimi i ekscentricitetit të alkidadës.(fig. 9. 11a.).




Fig. 9.11. Kompensatori me lëng i Kernit.

Të supozojmë se boshti alkidad është lakuar në raport me vertikalen pas këndit δ . Niveli i lëngut në enë do të marrë pozitën horizontale, kurse në raport të kahjes së boshtit alkidad normalja e tij do të shmanget për këndin δ . Prizmi i majtë do të jetë në fund të rrezes, i cili me horizontalen zë këndin δ , prandaj rrezja do ta bartë shëmbëlltyrën e ndarjes së limbës,, i cili është nën këndin horizontal. Rruga e rrezet nga ana e majtë deri në nivelin e lëngut në raport me sistemin optik është e njëjtë si edhe kur boshti alkidad është vertikal, por është kah vertikallja, në raport me pozitën e drejtë, do të shmanget për këndin δ .

Kur niveli i lëngut do të mbetet normal në boshtin alkidad, fundi i rrezes do të ishte në diametër të njëjtë si edhe në pozitën fillestare, e ai do të ishte fig. 9.11., i rrotulluar për këndin δ . Ngase niveli i lëngut ndaj boshtit alkidad është i lakuar për këndin δ , prandaj këndi ndërmjet rrezes dalëse dhe hyrëse nuk do të mbetet 90° , por do të zvogëlohet për këndin 2δ respektivisht do të jetë $90^\circ - 2\delta$. Prandaj, rezja e cila e mban shëmbëlltyrën e ndarjes së limbës do të bjerë në prizmin e djathtë nën horizont në qendër të ndarjes së limbës, respektivisht do të jetë në horizont me rrezen qetësuese. Në fushën dukshmet dylbisë së okularit - mikroskopit do të paraqiten dy skaje të ndarjes së limbës, të cilat nuk janë në diametër të njëjtë, por janë në skajet e dy rrezeve, të cilat me horizontin zënë këndin δ . Kjo në leximin e ndarjes manifestohet si ndikim i ekscentricitetit të boshtit alkidad. Me heqjen e mesit të leximeve në të dy skajet e ndarjes së limbës, gabimi anulohet (fig. 9.11c.).

Sfera e kompensatorit është $\pm 5'$, kurse saktësia të cilën pajisja e jep, sillet rreth $\pm 0''{,}3$. Nëse ndodh që boshti alkidad në hapësirë të shmanget më tepër se $5'$, rrezja zhduket në prizmat, prandaj nuk mund të lexohet ndarja e limbës vertikale.

9.4.3. Kompensatori me spirale tek instrumentet e firmës Zeiss nga Jena

Në fig. 9.12. është dhënë skema optike e mikroskopit për lexim të ndarjes së limbës vertikale, kur është:

- 1 – limba vertikale;
- 2 dhe 5 – prizmat kënddrejtë;
- 3 dhe 4 – thjerrëza e objektivit të kompensatorit;
- 6 – pllaka qelqore me indeks;
- 7 – prizmi pesëbrinjësh;
- 8 dhe 9 – objektivi dhe okulari i mikroskopit;
- 10 – trupi i lavjerrësit;
- 11 – spiralja,
- 12 – ngufatësi i oscilimeve;
- H – H – horizonti i qendrës së limbës.




Fig. 9.12. Kompensatori me spirale te Zeiss.

Rrezja e cila kalon nëpër syrin e operatorit, kalon nëpër indeksin, prizmin 5, i cili e orienton rrezën kah qendra optike të objektivit (3, 4) të kompresorit, prej ku nga prizmi 2 orientohet kah ndarja limbës. Objektivi 3 dhe 4 krijojnë shëmbëlltjrë reale të indeksit të leximit në rrafshi e ndarjes të limbës vertikale. Kompresorin e përbën lavjerrësi (10) i varur në spiralen (11). Kur boshti alkidad është vertikal edhe trupi i lavjerrësit qëndron vertikalisht, prandaj edhe rrezja e cila e bart shëmbëlltjrën e

indeksit do të jetë vertikale, respektivisht leximi i ndarjes në limbës do të bëhet në vertikalen e qendrës së ndarjes së limbës.(fig. 9.12a, b.).

Do ta shqyrtojmë rastin kur boshti alkidad nuk është vertikal, por me vertikalen zë këndin δ (fig. 9.12c.). Për shkak të kësaj, pika në të cilën është përforcuar spiralja do të hyjë nga rrafshi vertikal i cili kalon në kahjen e boshtit H – H. Kur nuk do të ishte veprimi i spirales, trupi i lavjerrësit do ta merrte kahjen e vertikales, qendra optike e objektivit të kompensatorit do të vinte në pikën O”, kurse shëmbëlltyra e indeksit do të binte në vend të gabuar në pikën O”, Për shkak të veprimit të spirales, trupi i lavjerrësit me kahjen e vertikales do ta merrte këndin β (e jo këndin δ) ashtu që qendra optike e objektivit të kompresorit përsëri do të vijë në rrafshi vertikal i cili kalon në boshtin rrotullues. Me vetë këtë rrezja, e cila kalon nëpër indeks, prizmin 5 dhe qendrën optike të thjerrëzave 3 dhe 4 do të qëndrojë vertikalisht. Kjo do të thotë se leximi i ndarjes së limbës do të bëhet në vend të drejtë (prerja e rrafshit vertikal H – H me normalen e limbës) pa dallim të lakimit të boshtit alkidad.

Nga trekëndëshi MHO rrjedh:

$$\frac{\overline{HO}}{\overline{MO}} = \frac{\sin \beta}{\sin(180^\circ - \delta)} \quad \sin \beta = \frac{\overline{HO}}{\overline{MO}} \sin \delta = f(\delta, \overline{MO}, \xi),$$

prej ku shihet se këndi β shtënë funksion të:

δ – lakimi i boshtit alkidad;

\overline{MO} – distanca nga pika e varjes deri te qendra optike e thjerrëzave të kompresorit

ξ – elasticiteti i spirales.

Sfera e kompresionit është $\pm 4'$, saktësia të cilën e jep kompresori është $\pm 1^{\circ},5$, koha e qetësimit është rreth 1 sekondë.

9.5. MATJA E KËNDEVE VERTIKALE

Këndet vertikale (distancat e zenitit) maten për nevojat të ndryshme, siç janë:

- caktimi i lartësive absolute të pikave detale të cilat e karakterizojnë terrenin në kuptimin e plotë të fjalës;
- caktimi i lartësive mbidetare të pikave poligone;
- caktimi i lartësive mbidetare të pikave trigonometrike;
- përcjellja e zbritjes së objekteve;
- caktimi i lartësive të objekteve, etj.

Saktësia e caktimit të pikave të përmendura është e kufirimit të disa milimetrave deri në decimetra. Saktësia e caktimit të ndryshimeve në lartësi më tepër varet nga saktësia e matjes së këndeve vertikale. Te punët precize, ku kërkohet saktësia e caktimit të ndryshimeve në lartësi, këndet vertikale lexohen deri në sekondë, kurse gjatë punëve me saktësi më të vogël, deri në një minutë. Distanca e saktësisë është e madhe, prandaj për çdo punë konkrete është e njohur saktësime të cilën duhet të maten këndet vertikale. Në varësi nga kjo, bëhet zgjedhja e instrumenteve përkatëse dhe metodat për matje. Këndet vertikale maten sipas metodës së thjeshtë ose metodës gyruse. Këndet vertikale në rrjetën poligonometrike maten në një gyruse, kurse në rrjetën trigonometrike në tre gyruse.

9.5.1. Metoda e thjeshtë për matjen e këndeve vertikale

Metoda e thjeshtë për matjen e këndeve vertikale (e cila përdoret edhe për matje të këndeve horizontale) është matja e këndeve vetëm në një pozicion të dylbisë. Në pozicionin e parë të dylbisë vijëzohet një pikë me vijë horizontale të penjësorit, fluska në libelën për lartësi rregullohet që të lëvizë dhe lexohet vlera e ndarjes së limbës vertikale. Kjo vlerë paraqet distancën e zenitit, respektivisht këndin vertikal. Nëse kushti nuk është plotësuar, respektivisht gjatë vizurës horizontale, leximi i limbës vertikale duhet të jetë 90° ose 0° , prandaj me këtë gabim do të ngar-

kohet çdo distancë e matur e zenitit, respektivisht këndi vertikal. Përveç kësaj, në saktësinë e matjes së distancës së zenitit ndikon edhe sjellja e pasaktë e flluskës në libelën për lartësi që të lëvizë, gabimi i vijëzimit, gabimi i leximit të ndarjes së libelës etj. Kjo mënyrë e matjes së këndeve vertikale përdoret kur nuk nevojitet lëng i tepërt se një minutë (incizimi takimetrik i detalit). Të dhënat nga matjes e këndeve vertikale sipas metodës së thjeshtë shkruhen në procesverbalin takimetrik dhe pastaj rumbullakohen në minuta të plota.

9.5.2. Metoda gyruse për matjen e këndeve vertikale

Metoda gyruse për matjen e këndeve vertikale është metodë për matje të këndeve në të dy pozitat e dylbisë. Kryesisht, këndet vertikale maten sipas metodës gyruse, përveç në ato raste kur nuk kërkohet saktësi më e madhe se sa mund të realizohet me metodën thjeshtë të matjes.

Matja e këndeve vertikale në një ose më tepër gyruse kontrollohet me ndihmën e vlerës $2HV = KL + KD$, respektivisht $2VV = KL + KD$. Këto vlera për të gjitha matjet duhet të jenë afërsisht të njëjta (konstante). Me Rregulloren për paramasë shtetërore është paraparë vlera më e madhe $2HV$, respektivisht $2VV$ që të mos guxojë ta tejkalojë kufirin e lejuar.

Shembulli 9.8: Të llogaritet këndi vertikal dhe distanca e zenitit në bazë të leximeve të këndeve vertikale, të matura në dy pozita të dylbisë:

$$a) KL = 92^{\circ}36'48'', KD = 267^{\circ}25'10''$$

Zgjidhje:

$$2Z = KL, + 360^{\circ} - KD = 185^{\circ}11'38'',$$

$$Z = 92^{\circ}35'49''.$$

$$b) KL = 6^{\circ}26'10'', KD = 173^{\circ}34'50''$$

Zgjidhje:

$$2\alpha = KL + 180^{\circ} - KD = 12^{\circ}51'20'',$$

$$\alpha = 6^{\circ}26'40''.$$

Kur këndet vertikale duhet të maten në tre gyruse, kurse penjëzori i teodolitit ka vetëm një vijë horizontale, midis gyruseve të veçanta patjetër duhet të ndryshohet lartësia e instrumentit ose, në anën tjetër, të vijëzohet nga e njëjta lartësi e instrumentit, por në lartësi të ndryshme të sinjalit. Më tepër teodolite kanë penjëzor me tri vijëza horizontale. Me matjen në një pikë me tri vijëza horizontale në dy pozita të dylbisë fitohen tri vlera të këndit (në tre gyruse). Nëpërmjet çdo peri përfitohet nga një vlerë të këndit vertikal.

Të dhënat nga matjet e këndeve vertikale në tre gyruse shkruhen në formularin trigonometrik IV.

Kur do të qendëzohet instrumenti, matet lartësia e instrumentit (*i*) prej sipërfaqes së sipërme të shenjës deri te boshti rrotullues i dylbisë. Lartësia e instrumentit matet me ndihmën e dorëzës ose, në anën tjetër, me hatull.

Pikat vizure mund të jenë sinjalizuar me ndihmën e sinjalit i cili është vendosur mbi qendrën e pikës ose me hatull. Gjatë vijëzimit të sinjaleve të fiksuara vijëzohet majat e sinjalit dhe matet lartësia e tij. Kur për sinjal përdorim hatull, me ndihmën e vijëzës horizontale të penjëzorit vijëzohet veçmas leximit i hatullës dhe vlera e saj shkruhet si lartësi e sinjalit.

Procedura e matjes së këndeve vertikale në një gyruse përbëhet me sa vijon:

- vijëzohet sinjali ose hatulla në pozitën e parë me ndihmën e vijëzës së mesme horizontale të penjëzorit.

- me vidë mikrometrike të alkidadës në limbën vertikale sillet fluska në libelë që të lëvizë, e pastaj lexohet vlera e ndarjes së limës *KL*. Nëse limba vertikale është e pastër, me ndihmën e dy mikroskopëve të veçuar në dy vende të kundërta diametrale të ndarjes së limbës, atëherë së pari lexohet mikroskopi tek okulari i dylbisë, e pastaj mikroskopi i cili

është më afër objektit, dhe i dyti edhe të dy leximet shkruhen në procesverbal;

- dylbinë e vendosim në pozitën e dytë dhe me vijëzën e mesme deri te penjzori e vijëzojmë pikën e njëjtë;

- sillet fluska në libelën për lartësi që të lëvizë dhe lexohet vlera e ndarjes së limbës *KD*. Nëse limba vertikale lexohet me ndihmën e dy mikroskopëve të ndarë në dy vende të kundërta diametrale të ndarjes së limbës, atëherë së pari lexohet mikroskopi tek objektivi i dylbisë, si e para, kurse pastaj mikroskopi i cili është më afër okularit, si e dyta, dhe të dy leximet shkruhen ë procesverbal.

Kur nja një stacion maten këndet vertikale kah më tepër pika vizure, nuk është e njëjtë renditja e vijëzimit si te matjet e këndeve vertikale. Gjatë matjes së këndeve vertikale matet pikë pas pike, në të dy pozicionet e dylbisë.

10. RRJETA POLIGONE

10.1. KONCEPTET THEMELORE

Shumica e profesionistëve gjeodezikë merren me paramasën detale, me përgatitjen e planeve dhe hartave dhe mirëmbajtjen e paramasës. Që të mund të kryhet paramasa detale nevojitet një rrjetë shumë e dendur gjeodezike, respektivisht në çdo 200-300 m të ketë të paktën një pikë. Rrjeta trigonometrike, në të cilën gjatësitë e anëve sillen 1 - 4 km, gati nuk mund t'i përmbushin nevojat e paramasës. Prandaj në mes pikave trigonometrike vendoset një varg i pikave (2, 3, 4,...) në distancë prej rreth 100 - 300 m, të cilat në njëra-tjetrën, si dhe me pikat trigonometrike lidhen me matjen e këndeve dhe gjatësisë (fig. 10.1).




Fig. 10.1. *Fibra poligone.*

Pikat 2, 3, 4, quhen pika poligone dhe shenja e tyre topografike është rrethi me pikë në qendër të rrethit (\odot). Vargun e tillë të pikave 2, 3, 4, e përbën fibra poligone. Nëse fibra poligone vendoset në mes dy pikave* të dhëna (të supozojmë 1 dhe N) e quajmë *fibër e imponuar poligone* (fig. 10.1.). Fibra poligone, e cila fillon dhe mbaron në të njëjtën pikë, quhet *fibër e mbyllur poligone* (fig. 10.2.), kurse fibra e cila fillon nga një pikë e caktuar dhe mbaron “verbërisht”, quhet *fibër e verbër poligone* (fig. 10.3.).

* Pikat e dhëna kanë koordinata.




Fig. 10.2. Fibra e mbyllur poligone.




Fig. 10.3. Fibra e verbër poligone.

Para llogaritjes së koordinatave në pikat poligone përcaktohet rendi sipas të cilit do të kryhen llogaritjet e koordinatave të pikave poligone. Mënyra e llogaritjes së koordinatave caktohet në skicë të fibrës poligone me drejtim të llogaritjes. Kjo është vijë e kuqe e tërhequr nga ana e majtë e fibrës nga fillimi deri në fund. Në fillim të kësaj vije vizatohet pikë dhe në fund shigjeta (fig. 10:24). Me këtë caktohen elementet e fibrës poligone:

- pika e fillimit të fibrës 1 dhe pika e fundit të fibrës N janë pikat e dhëna në të cilat mbështetet fibra;
- ana poligone është gjatësia në mes dy pikave poligone në fibër, apo gjatësia në mes pikës së poligonit dhe pikës fqinje trigonometrike;
- ana fillestare dhe përfunduarë janë dhënë anët me të cilat lidhet fibra (S_{A1}, S_{NB});

- këndi fillestar (β_1) dhe përfundimtar (β_N) të pikës së dhënë fill-estare dhe pikës përfundimtare të fibrës;

- këndet e përthyerja janë kënde të pikës poligone në fibër mes anëve fqinje poligone. Ngase midis dy gjatësive ekzistojnë gjithmonë dy kënde, shuma e të cilave është 360° , atëherë për kënde të përthyerja dhe të lidhura duhet të merren këndet, të cilat ndodhen në anën e majtë të fibrave, duke shkuar në drejtim të llogaritjes, përkatësisht në anën e njëjtë në të cilën kursori është i vendosur që të tregojë drejtimin e llogaritjes.

10.2. KLASIFIKIMI I RRJETËS POLIGONE

Kur fibrat poligone do të zhvillohen vetëm në mesin e pikave trigonometrike, atëherë drejtimi i shtrirjes së tyre afërsisht do të jetë në anët e trekëndëshave trigonometrik të rrjetës. Midis këtyre fibrave do të mbetet një hapësirë e pambuluar, kështu që edhe në atë pjesë duhet të vendosen fibrat poligone. Ato me skajet e tyre do të mbështeten në pikat poligone të cilat i përkasin fibrave poligone të cilat janë futur në mes pikave trigonometrike. Me vendosjen sukcesive të fibrave të reja që mbështeten në ato të parat, do të fitohet dendësi e mjaftueshme e pikave poligone nga të cilat mund të regjistrohen të gjitha detajet. Pra, fibrat poligone të lidhura mes vete, të cilat përfaqësojnë një tërësi, e përbëjnë rrjetën poligone (fig. 10.4.).

Për shkak të përbërjes së formës së drejtë të rrjetës poligone dhe llogaritjes së gjatësisë së fibrës poligone shfrytëzohen edhe pikat *nyjore* kryesore. Pika nyjore është pika në të cilën sjell së bashku tri ose më shumë fibra poligone duke filluar në pikat trigonometrike ose në disa pika të tjera nyjore kryesore. Konsiderohet se pikat nyjore kanë rend të pikave trigonometrike nga rendi i katërt, prandaj fibrat të cilat mbështeten të to, gjithashtu janë fibra kryesore.

Rrjeta poligone ndahet në rrjetë kryesore dhe plotësuese poligone. Rrjetën kryesore poligone e përbëjnë fibrat kryesore poligone (fibrat mes pikave trigonometrike ose pikave kryesore, apo pikave kryesore dhe trig-

onometrike të fibrave). Rrjeta plotësuese poligone zhvillohet në kuadër të rrjetës kryesore poligone.




Fig. 10.4. Rrjeta poligone.

10.3. PROJEKTI DHE REKOGNOSCIMI I RRJETËS POLIGONE

Nën rekognoscim të rrjetës poligone nënkuptohet përzgjedhja e vendeve në terren për vendosjen e pikave poligone. Pikat vendosen sipas fibrave në të cilat së bashku përbëjnë rrjetën poligone. Rrjeta poligone shfrytëzohet si bazë për regjistrim të detalit.

Detajet regjistrohen në komunën kadastrale. Komunën kadastrale e përbën një vendbanim i popullzuar me mezhdën rajonale. Komuna kadastrale (shkurtimisht shkruhet KK) patjetër duhet të paraqesë një tërësi topografike. Mund të ndodhë që një pjesë e tokës së popullsisë nga një KK të jetë ndarë nga mezhda e ndonjë vendi tjetër nga KK e tij. Në këtë rast pjesa e ndarë e tokës së popullsisë së një vendi do të vendosen në një KK më mezhdën e së cilës është përfshirë toka (fig. 10.5.). Qytetet më të mëdha mund të ndahen në më shumë KK.




Fig. 10.5. Komunat kadastrale.

Prandaj, rrjeta poligone zhvillohet sipas KK, respektivisht rrjeta poligone e një KK patjetër duhet të paraqesë një tërësi. Për qytetet e mëdha, të cilat janë ndarë në një numër të vetëm të KK përcaktohet rrjeta poligone pavarësisht nga kufijtë e komunave kadastrale. Karakter të tillë ka edhe rrjeta poligone që shfrytëzohet për të regjistruar: rrugë, lumë, kanal etj.

Para vendosjes së pikës poligone në terren, patjetër duhet të gjenden dhe të sinjalizohen pikave trigonometrike. Kur bëhet rikognoscirimi është e dëshirueshme që të ketë një hartë për zonën e cila përcakton rrjetën poligone. Me këtë do të lehtësohet zgjedhja e drejtimeve të shtrirjes së fibrave, kurse vetë rrjeta do të ketë formë të mirë. Vendbanimet dhe qytetet më të mëdha, para rikognoscirimit përpunojnë projekt të rrjetës poligone të cilin e verifikon institucioni kompetent (në këtë moment ai është Agjencioni i pasurive të patundshme kadastrale). Gjatë projektimit dhe rikognoscirimit rrjeta i përmbahet parimit “*nga më e madhja kah më e vogla*” Së pari vendosen fibrat kryesore në mes pikave trigonometrike. Kështu, terreni do të ndahet me fibra nga pjesët në formën e trekëndëshit. Pastaj brenda trekëndëshave vendosen fibra me vëllim të vogël dhe gjatësi të vogël derisa të arrihet dendësi e mjaftueshme e pikave. Në vendbanimet dhe qytetet fibrat kryesore poligone vendosen përgjatë udhës, rrugëve kryesore, hekurudhave dhe komunikimeve të tjera.

Për shkak të shmangies së fibrave të gjata dhe paralele, si dhe për vendosjen e drejtë të gabimeve të pashmangshme gjatë matjeve, duhet

të shfrytëzohen pika nyjore. Nuk lejohet kryqëzimi i fibrave në të njëjtin nivel. Me fjalë të tjera, dy anët poligone nuk duhet të priten në të njëjtin nivel. Posaçërisht lejohet që dy fibra të kryqëzohen nëse, p.sh. një fibër shkon përgjatë rrugës në prerje të thellë, kurse fibra tjetër e pret në breg ose në mbikalim.

Fibrat e tjera poligone duhet të shmangen. Ato vendosen vetëm nëse ato janë të pashmangshme, kurse mund të kenë vetëm dy anë.

Gjatë zhvillimit të rrjetës poligone duhet të merren parasysh fibrat poligone të cilat mbështeten në pikat trigonometrike, si dhe pikat poligone të cilat janë përcaktuar në bazë të matjeve të saktësisë së njëjtë ose më të madhe se ajo që do të matet në rrjetën që e përcakton.

Rrjeta poligone, në të cilën gjatësitë maten me metra elektronik në largësi, kurse këndet me teodolite njësekondare, shpesh quhet *rrjetë poligonometrike*. Pikat në atë rrjetë quhen *pika poligonometrike* dhe shënohet me shenjën topografike \odot . Ato fibra, si dhe anët në to, mund të jetë më të gjata.

Në rikognoscirimin e rrjetës poligone duhet të respektohen rregullat themelore që duhet të garantojnë cilësi dhe qëndrueshmëri të rrjetës:

- Fibra duhet të jetë e tërhequr, respektivisht këndet e përthyera të fibrës, sipas mundësisë, të jenë sa më afër se 180° . Kjo kërkesë është i justifikuar, sepse metoda e njëjtë, koha e punës dhe mjetet e punës, pozita e pikave poligone në fibrën e shtrirë do të përcaktohen më saktë në drejtim të fibrës së përthyer. Llogaritja e koordinatave gjithashtu është e thjeshtë.

- Gjatësia e anëve poligone duhet të jetë 50-250 m, por me përjashtim të deri në 500 m. Kur gjatësitë maten me metër elektronik për gjatësi, anët mund të jenë më të gjata. Përveç kësaj, duhet të kërkohet që anët fqinje në fibër të jetë afërsisht me gjatësi të njëjtë. Nuk duhet që raporti i anëve fqinje të jetë nën 1 : 2, kurse në raste të veçanta mund të lejohet: 1 : 3. Për shembull, nëse një gjatësi është 100 m, tjera (fqinje) nuk duhet të jetë më pak se 50 m ose më shumë se 200 m.

- Kur anët janë matur me shirit, fibra nuk duhet të jetë më e gjatë se 2,5 km në terren që është i favorshëm për matje, deri në 2,0 km në terren të favorshëm të mesëm dhe 1,0-1,5 km në terren të pafavorshëm për matje. Kur gjatësitë maten me matës elektronik në largësi, fibrat mund të jenë më e gjata. Me vendosjen e një ose më shumë nga pikat e nyjeve mund të arrihet që fibrat të mos i kalojnë gjatësitë e lejuara maksimale.

Fibrat poligone të cilat hasen në pikat kryesore primare, duhet të kenë afërsisht të njëjtën gjatësi dhe të jenë të shpërndara në mënyrë të drejtë përreth pikës nyjore. Pika nyjore duhet të përcaktohet nga tri ose më shumë fibra.

Gjatë zgjidhjes së vendeve, në të cilat duhet të vendoset (stabilizohet) pika poligone, duhet të merret parasysh me sa vijon:

- Shenjat e pikave poligone nuk duhet të jenë dëmtuar ose shkatërruar - sepse pika poligone duhet të paraqitet jashtë kufirit të lëvrimit, respektivisht kufirit të parcelës, pranë rrugës në bankinë, larg nga rrëshqitjet e tokës dhe kështu me radhë.

- Këndet dhe gjatësitë të maten sa më saktë që të jetë e mundur, respektivisht shenja para matjes mund të jetë sa më afër qendrës së shenjës, kurse gjatësitë mund të maten pa përthyerje dhe pa ngritje të shiritit (fig. 10.6). Në një anë poligoni mund të lejohet të ketë së paku dy dhe jashtëzakonisht tre përthyerje. Kur profili i tokës është i tillë që duhet të vendosen më shumë përthyerje, ana e tillë do të përcaktohet në mënyrë të tërthortë.




Fig. 10.6. Matja e gjatësisë me pikë të përthyer.

- Nga pika poligone mund të regjistrohen më shumë detaje. Prandaj duhet të zgjidhen vende të cilat dominojnë në terren dhe në të cilat nuk janë rritur bimë.

- Të mund të lidhen fibrat e tërthorta për pikën poligone.
- Në qytetet dhe vendbanimet pikat poligone duhet të vendosen në trotuare larg kanalizimeve, ndërsa pastaj duhet mbajtur llogari që fibra të shkojë në të njëjtën anë të rrugës, sidomos nëse rruga është e drejtë.

Forma e fibrave, pamja e rrjetës poligone dhe pjesa tjetër është e lidhur me rikognoscirimin e rrjetës poligone që kryesisht varet nga terreni dhe përvoja e ekspertit gjeodezik që e kryen rrjetën e rikognosciruar. Ekzistojnë zgjidhje të panumërta për zgjidhje të pikave të mundshme poligone, kurse disa prej tyre do të plotësojnë kushtet e kërkuara më lart. Zgjedhja e vendit më të mirë nga të gjitha zgjidhjet e mundshme varet vetëm nga përvoja dhe ekspertiza e ekspertit gjeodezik dhe kushtet objektive në terren.

Kur sinjalizimi i pikave të terrenit do të jetë i plotë dhe do të njihen kushtet e terrenit, rikognoscirimi i pikave poligone mund të fillojë. Së pari vendosen fibrat poligone mes pikave trigonometrike ose pikave nyjore, respektivisht edhe pikat trigonometrike dhe nyjore. Duke marrë parasysh këto kushte, fillohet nga një pikë trigonometrike dhe shkohet afërsisht në drejtim të pozitës tjetër të zgjedhur në vendosjen saktësisht të pikave poligone. Midis pikave poligone bëjnë pjesë fibrat kryesore (tashmë të rikognosciruara), vendosen fibrat tërthore poligone derisa në një zonë të caktuar nuk e mbulon me pika të mjaftueshme të dendura poligone. Me atë rast, në globale bëhet edhe plani për llogaritje të rrjetës poligone, respektivisht përcaktohet rendi në të cilin ato do të bëhet nivelizimi i fibrave poligone. Së pari llogariten koordinatat e pikave në fibra më të mëdha, pastaj fibra sekondare, sipas një rendi të paracaktuar.

Nëse projekti i rrjetës poligone përvetësohet, duhet të kërkohet që plotësisht të realizohet gjatë rikognoscirimit të rrjetës poligone.

10.4. LLOJET DHE TIPAT E SHENJAVE PËR PIKAT POLIGONE

Pikat poligone vendosen zakonisht në kryerjen e paramasës së tokës, prandaj duhet të përgatiten plane gjeodezike apo të kryhet një detyrë e veçantë në fushën e gjeodezisë inxhinierike. Megjithatë, qëllimi i tyre është i shumanshëm. Ato përdoren për mirëmbajtjen e studimit dhe që të kryhet një shumëllojshmëri të punimeve në fushën e gjeodezisë. Është i madh numri i shfrytëzuesve për të cilët rrjeta poligone është e nevojshme kur ndjekin një detyrë të veçantë ekonomike në fushën e gjenërimit të gjeodezisë dhe në të shkencat simotra. Për shfrytëzim të suksesshëm, rrjeta poligone duhet të ketë karakter të përhershëm, kurse me rëndësi të madhe do të stabilizohet pika poligone. Mënyra e vendosjes së shenjës varet nga lloji i terrenit kryesor ku shenja do të përcaktojë: arën, livadhin, kullotën, tokën e papërpunuar, shkëmbinjtë, asfaltin, betonin, etj. Pra, ekzistojnë disa lloje të shenjave të cilat mund të vendosen në disa grupe:

a) Sipas materialit nga i cili mund të përpunohen, mund t'i ndajmë në:

- të qëndrueshme, të cilat bëhen nga qeramika, guri, betoni dhe hekuri;

- të përkohshme, të cilat bëhen nga druri (kunjat).

b) Sipas numrit të pjesëve përbërëse:

- të thjeshta apo të vetme, të cilat kanë vetëm një shenjë;

- komplekse, me dy ose tri pjesë, por mund të ketë disa pjesë mbrojtëse.

c) Shenjat e kombinuara mund të shfrytëzohen si pikë reperi për repera mbrojtës.

d) Sipas pozicionit në tokë, shenjat mund t'i ndajmë në:

- të dukshme ose mbitokësore, në të cilat shenja e sipërme lart është mbi tokë;

- nëntokësore të cilat janë të mbuluara plotësisht me tokën.

Saktësia e qendrës së shenjës varet nga saktësia me të cilën matjet janë kryer në rrjetë. Kur matjet në rrjetën poligone bëhen në mënyrë të

thjeshtë, qendra e shenjës përfaqëson kryqin apo mesin e hapjes të gypit të qeramiks. Kur matjet bëhen me saktësi të rritur apo me matës elektronik në largësi qendra e shenjës shënohet me kryq të gdhendur, apo me vrimë në mesin e shenjës. Qendra e ulët nëntokësore duhet të jetë e vendosur në vertikalen e qendrës së shenjave të mësipërme, por mund të shërbejë në bazë të saj, për të rivendosur shenjat e dëmtuara të sipërme. Shenja e sipërme dhe qendra e përshtatshme nëntokësore komplekse bëhen nga materiale të ndryshme dhe me dimensione caktuara:

- Shenja e gurit natyror me kokë të përpunuar, apo me kryq të gdhendur si qendër e shenjës (fig. 10.7.); futet në vendin e butë, rrafsh me tokën ose mbi tokë 2-3 cm. Qendra nëntokësore përpunohet nga qeramika apo nga gjysma e një tulle të pjekur mirë.

- Shenja e betonit të armuar (fig. 10.8.) me qendër të caktuar në formën e reperit me vrimë, me kryq të shpuar, apo të gdhendur. Kjo shenjë futet në tokë si edhe shenja e gurit.

- Gypi i betonit ose qeramiks me formë të konit të prerë (fig. 10.9.). Qendra e shenjës paraqet mjedis të tubit bosh. Shenja e poshtme bëhet nga qeramika. Shenja futet nën tokë. Shenja e sipërme duhet të futet nën thellësi të lëvrimin, në kushtet e sotme, 50 -60 cm.




Fig. 10.8. Shenja e betonit.

Fig. 10.7. Shenja e gurit.




Fig. 10.9. Gypi i betonit ose qeramikës.




Fig. 10.10. Gypat e qeramikës ose të plastikës.

- Gypi i qeramikës ose plastikës në formë të cilindrit (fig. 10.10.), me qendër nëntokësore në formën e kapakut të gypit, futet në tokën e punueshme në një thellësi prej 50-60 cm. Në thellësi të njëjtë duhet të futen edhe shenjat e gurit natyror ose betonit të përforcuar, nëse vendoset në tokë të punueshme.




Fig. 10.11. Shenja metalike.

- Në qytetet, rrugët e asfaltuara dhe trotuaret vendosën shenja metalike (kapela), në të njëjtin rrafsh me asfaltin (fig. 10.11).




Fig. 10.12 Shenja e përkohshme (kunji i drurit).

Si shenja të përkohshme të pikave poligone shfrytëzohen kunj druri me prerje të rumbullakët apo katrore dhe me dimensione si në figurën 10.12. Qendra e shenjës shënohet me gozhdë të mbërthyer në mes kunjit.

10.5. FUTJA (VENDOSJA) E SHENJAVE

Kur patjetër do të zgjidhet vendi ku duhet të jenë të vendosura pikat poligone, ai vend shënohet me shenjë që përcakton pozitën e saj në sipërfaqen fizike të tokës. Mënyra e vendosjes së shenjës varet nga lloji i shenjës.

Shenja e thjeshtë për pikat poligone – kunji i drurit duhet të ngulet në tokë vertikalisht me ndihmën e çekiçit të drurit, sepse në këtë mënyrë nuk do të bëhet copëtimi i kunjit. Kunji i ngulur duhet të jetë mbi tokë 2-3 cm, kurse në sipërfaqe e tij të sipërme duhet të mbërthehet një gozhdë.

Gjatë futjes së shenjave komplekse është me rëndësi që qendra e shenjës së poshtme (qendra nëntokësore) dhe qendra e shenjës së sipërme të vendoset në vertikale të njëjtë. Procedura për gjurmim të shenjës komplekse është si vijon (fig. 10.13.):

- Në vendi e zgjedhur për vendosjen e pikës poligone hapet, sipas mundësisë, një vrimë sa më e ngushtë me thellësi të mjaftueshme.




Fig. 10.13. Gërmimi i shenjës.

- Shenja e poshtme vendoset në pjesën e poshtme të vrimës, por atëherë rreth saj vendohet tokë e imtësuar dhe mirë ngjishet me ndonjë objekt.

- Për shkak të fiksimit të vertikales në qendër të shenjës ngulet një hu në rreth 0.5 m të vrimës së hapur dhe për të, nga lart, gozhdohet një hatull me gjatësi prej 1,5-2,0 m, kështu që rreth gozhdës horizontalisht të mund të rrotullohet. Lart mbahet saktësisht mbi qendrën e shenjës së poshtme, kurse hatulla me kujdes rrotullohet derisa ajo e prek perin e lavjerrësit. Që të rregullohet hatulla në këtë pozicion, afër saj vendoset gozhdë - numëror, apo një tjetër kunj, i cili është ngulur nën hatull, tërhiqet një vijë. Vendi i prekjes së perit të lavjerrësit në shiritin horizontal shënohet me vijë.

- Mbi shenjën e poshtme derdhet tokë prej rreth 10 cm trashësi.

- Vendoset shenja e sipërme dhe qendra e saj duke përdorur lavjerrësin në drejtim të qendrës vertikale të shenjës së poshtme. Shenja e sipërme mbulohet gradualisht me tokë dhe ngjishet derisa nuk ngjishet forcohet deri në fund. Gjatë ngjeshjes në shenjën e sipërme, herë pas here me ndihmën e lavjerrësit kontrollohet saktësia e saj. Nëse qendra e shenjës devijon nga vertikalia, drejtohet me ndihmën e ngjeshjes më të

fortë të tokës në anën tjetër ku shenja është tërhequr. Në fund, kur shenja do të ngjishet dhe stabilizohet plotësisht, kontrollohet pozita e qendrës dhe korrigjohet edhe njëherë përfundimisht. Nëse shenja futet në sipërfaqe të vështirë, ku nuk mund të ngulen kunj, për shkak të fiksimit të vertikales në qendër të shenjës së poshtme, në vend me hatull, shënohet me shkumës apo gozhdë.

Gjatë futjes të shenjës me qendër të saktë, drejtimi i vertikales nuk mund të shënohen me lavjerrës të thjeshtë, por me ndihmën e lavjerrësit optik. Kur do të përforcohet shenjën e poshtme, drejtohet stativi me lavjerrës optik, atëherë qendra e shenjës së sipërme rregullohet me lavjerrës optik. Stativi mund të zhvendoset vetëm kur plotësisht të kryhet futja e shenjës së lartë.

Gypat qeramike janë të pozicionuar, prandaj përmes gypit tërhiqet shenja, maja e së cilës shpohet në qendrën e shenjës së poshtme. Kështu, shenja e caktuar mbahet vertikalisht, kurse rreth gypit derdhet tokë dhe ngjishet. Kur mbushet pothuajse deri në fund, gypi tërhiqet pak lart, për t'u ndarë nga shenja e poshtme, atëherë derdhet toka dhe ngjishet deri në majë të gypit.




Fig. 10.14. Futja e gypit të qeramikës.



Fig. 10.15. Fëndyelli.

Në fund, gypi mbushet me tokë të imët, kurse mbi të vihet një gur apo copë e tullave dhe gërmohet. Në vend të shenjës, nëpër vrimën e shenjës së poshtme dhe të sipërme tërhiqet një teli i butë, kështu që kur gypi është stabilizuar, teli me tërheqje të fortë nxirret nga gypi dhe nga qendra nëntokësore (fig. 10.14.). Që të hapen vrima të vogla, gjatë futjes të gypit përdoret një fëndyell i veçantë (fig. 10.15.) i cili rrotullohet me shkop tërheqës nëpërmjet tij, por ka diametër më të madh se diametri i gypit.

10.6. NUMRAT E PIKAVE POLIGONE

Pikat poligone numërohen ashtu sikurse veprohet me rrjetën poligone, respektivisht sipas komunave kadastrale, ose me numra që fillojnë nga një e këtej. Në qytetet e mëdha, të cilat kanë më shumë komuna kadastrale, zhvillohet rrjetë e vetme poligone për të gjithë zonën, kështu që pikat poligone numërohen nga një e tutje. E njëjta vlen edhe për pikat poligone në rrjetë e cila është zhvilluar me qëllim të regjistrimit të një zone të ngushtë, e cila përfshin më tepër komuna kadastrale.

Gjatë regjistrimit të lagjeve të cilat kanë rajon të veçuar ndërtimor, së pari numërohen pikat brenda zonës së ndërtimit, kurse pastaj pikat e numëruara të cilat janë jashtë zonës së ndërtimit.

Pika poligone, e cila përvetësohet si pikë nyjore, mban numrin që e keni marrë kur numërohet pika poligone.

Nëse nëpër pjesën e komunës kadastrale kalon ndonjë fibër, që vendoset për nevojat e incizimit të komunës fqinje kadastrale, pikat e asaj fibre merren dhe mbahen numrat e tyre nga komuna amë kadastrale. Për të shmangur dyfishimin e numrave të pikave poligone dhe të konfuzionit, në pikat e fituara poligone, përveç numrit, në emërues vihet shkronja fillestare e komunës së tyre amë kadastrale.

10.7. PËRSHKRIMI I VENDPOZITËS TË PIKAVE POLIGONE

Pas stabilizimit, për çdo pikë poligone duhet të vendoset përshkrim topografike i pozitës dhe të mblidhen të gjitha të dhënat të cilat do të mundësojnë që pikat të gjenden lehtë, kur për këtë do të jetë e nevojshme.

Pozicioni i pikave poligone përshkruhet në formularin trigonometrik nr. 27 (Shtojca 3), në titullin e të cilit regjistrohen të dhëna si në shembullin e dhënë. Në këtë formë, në mesin e të dhënave të tjera duhet të vizatohet skicë orientuese në vendndodhjen e pikës. Skica e vendndodhjes së pikës vizatohet në shkallë të përafërt, me çka lejohet karikim i disa detajeve të vogla të rëndësishme në llogari të detajeve më pak të rëndësishme. Në skica vizatohen edhe objekte të transportit dhe regjistrohen emrat përkatës, kufijtë e parcelave me të dhënat e pronarëve dhe shfrytëzuesve, si dhe kultura e tokës, drurët karakteristik nga të cilët bëhet matja, lloji i drurit, shtyllat telefonike dhe të energjisë me numrat, kanali e të tjera. Të dhënat nga pronarët shkruhen afërsisht në mes parcelës, si në shembujt në formularin trigonometrik nr. 27. Matjet merren pjerrtazi në terren prej 1 cm të objekteve të afërta të përhershme, të cilat më vonë mund të identifikohen me lehtësi kur është e nevojshme (gjatë zbulimit të pikës). Numri i matjeve nuk duhet të jetë më pak se 3 dhe duhet të vendosen rreth e rrotull pikës. Gjatësitë e matjeve duhet të jenë më të shkurta se gjatësia e një pantlike, nëse matet vetëm kufiri i parcelës.

Nëse terreni nuk ka objekte të mjaftueshme nga të cilat do të bëhet matja, në mes dy pikave në strukturë të përhershme mund të vendosni vijë abshise, kështu që në pikën poligone përcaktohet abshisa dhe koordinata dhe një matje diagonale.

Në rast se nuk ekzistojnë dy objekte të tilla, mund të vendosni vijë abshise duke filluar nga një objekt konstant (mezhdë, shtyllë, dru) përballë një objekt të largët, të dukshëm mirë (kishë, xhami, oxhak i fab-

rikës). Për pikën poligone maten abshisa dhe koordinata dhe matjet e pjerrëta në këtë vijë.

Në tokën shkëmbore, ku nuk ka objekte të përshtatshme, në vendin e dukshëm shkëmbor, të vendosur si duhet rreth pikës mund të gdhënden shenjat si shkronja e kthyer $T (\perp)$, e nga ato duhet të bëhet matja.

Kur pikat vendosen në parcela të mëdha të cilat nuk janë përpunuar (livadhe, etj.) në veri të pikës 2.5 m hapet një vrimë, kurse nga toka bëhet një grumbull në mes vrimës dhe pikës. Nëse pika vendoset në një parcelë të madhe të tokës e cila përpunohet, kështu që nuk ka asnjë mundësi të merret balancimi, kjo patjetër duhet të konstatohet në shënim.

Tregues i llojit të shenjës apo skicës së shenjës dhe thellësia e gërmimit në shenjën e sipërme dhe të poshtme do të hynë në shtyllat përkatëse të formularit trigonometrik nr. 27.

Matjet e pozitës duhet të ndërtohen në mënyrë solide për të shmanhur konfuzionin në zbulimin e pikës.

10.8. MATJET NË RREJËN POLIGONE

Kur u shpjegua për fibrat poligone u tha se pikat poligone janë të ndërlidhura me kënde dhe gjatësi të matura. Prandaj, në rrjetën poligone maten këndet dhe gjatësitë. Saktësia e matjeve varet nga pajisjet e rrjetës poligone me qëllim që të kryhen matjet dhe matja e terrenit të favorshëm (kur gjatësitë maten me shirit).

10.8.1. Matja e anëve poligone

Gjatësitë e anëve poligone mund të përcaktohet me matje direkte ose të drejtpërdrejta dhe matje tërthortë apo indirekte.

Përcaktimi i tërthortë i gjatësisë mund të kryhet në shumë mënyra:

- me metër të thjeshtë në largësi (tahimetër) te fibrat takimetrike;
- me metër të saktë në largësi me pykë dhe hatull horizontale në fibrat poligone nga radhët e B dhe V;
- me matës elektronik në largësi në fibrat në të gjitha rrjetat;
- me zbatim të teoremës sinusoidale, kosinusoidale dhe tangjente.

Gjatësitë e anëve poligone mund të maten drejtpërdrejt, si në vijim:

- Me saktësi në rritje, duke përdorur shirit të saktë çeliku. Kjo metodë e matjes kërkon përgatitje të madhe, matja është shumë e ngadalshme dhe joekonomike, kurse nuk përdoret pas paraqitjes së metrit elektronik në largësi.

- Në mënyrë të zakonshme, me ndihmën e shiritit të fushës (i cili është trajtuar me hollësi në Kapitullin 6 dhe që sot nuk përdoret në praktikë). Përveç përshkrimit të aparatit dhe metodave të matjes, janë dhënë shpjegimet për kategoritë e tokës dhe devijimet e lejuara për ndryshimet gjatë matjes përpara-prapa. Në këtë mënyrë maten gjatësitë e anëve në numër më të madh të fibrave poligone nga radhët H, V dhe G.

Anët poligone në rendin e tokës A maten me matës elektronik në largësi.

Me paraqitjen e instrumenteve elektronike fillon të aplikohet parimi i fazës matëse të madhësive lineare. Kjo mënyrë e matjes së gjatësisë edhe në ditët e sotme përdoret me ndihmën e stacioneve totale, por edhe mënyra e matjes me fazë zbatohet me teknologjitë e reja të futura në gjeodezi, si për shembull përdorimi i sistemeve të pozicionimit global (SPG).

Sigurisht, si rezultat i të gjitha këtyre parimeve për gjatësitë matëse fitohet distanca midis dy pikave fqinje në rrjetën poligone, por ky rezultat dallohen nga saktësia e matjes dhe varet nga mënyra në të cilën bëhet matja. Gjatësia e specifikuar nga shiriti i fushës ka saktësi më të ulët, pastaj vijon pikërisht gjatësia e caktuar duke përdorur tel invar optik apo

mënyrë optike të matjes si metodë më të saktë të matjes së gjatësisë në rrjetën poligone është mënyra e matjes së gjatësive elektrooptike.

Në fillim pamë se si maten gjatësitë duke përdorur shiritin e fushës, kurse në këtë pjesë do të shpjegohet parimi i matjes në anët poligone me instrumente gjeodezike (optike dhe elektrooptike).

Tek instrumentet elektrooptike dallohen tri parimet e matjes së gjatësisë, edhe atë: parimi *impulsiv*, *frekuent* dhe *fazor*. Këtu do të shpjegohet vetëm parimi fazor i matjes për arsye se ai është një parim që gjithnjë aplikohet në zhvillimin e teknologjive të reja, si për shembull metodat e matjeve satelitore.

10.8.1.1. Takimetri i thjeshtë

Takimetri i thjeshtë apo metri në largësi i Reichenbahut është teodolit, penjëzori i të cilit ka një vijë vertikale dhe tri vija horizontale (fig. 10:16). Me këtë formë të penjëzorit të këtij instrumenti në thelb ka tri pamje të cilat kalojnë nëpër qendrën optike të thjerrëzës së objektivit dhe prerjen e penjëzorit vertikal dhe horizontal. Vizurat e jashtme formojnë këndin parataktik $\gamma = 34''.38 = 34'22''$, ndërkohë në vizurën e mesme (kryesore) zë këndin $\gamma/2 = 17'11''.24$.




Fig. 10:16. Pamja e penjëzorit me tre penjë.

Penjëzori i tillë mundëson që të fitohet distancë nga instrumenti deri në hatull, ndarja e së cilës është normale me vizurën, në bazë të

segmentit i cili përfitohet si ndryshimi ($l = g - d$) nga leximi me fije e sipërme dhe të poshtme të penjëzorit sipas formulës:

$$S = K \cdot l, \quad (10.1)$$

tek instrumentet me gjatësi fikse të dylbisë edhe

$$S = K \cdot l + c \quad (10.2)$$

te instrumentet me gjatësi variable të dylbisë, ku janë:

$$K = \frac{f}{n} - \text{konstanta multifikuese e metrit në largësi;}$$

$$c = f + \delta - \text{konstanta adicione.}$$

Instrumentet me gjatësi variable të dylbisë janë nga kohët e vjetra, prandaj për ta nuk do të flasim.

Formula (10.1) për përcaktimin e gjatësisë vlen vetëm kur vizura është horizontale, kurse hatulla qëndron vertikalisht. Kur vizura me rrafsh horizontal zë këndin α (ose me rrafshin vertikal Z), distanca horizontale është llogaritur në bazë të formulës:

$$S_r = K \cdot l \cdot \cos^2 \alpha = K \cdot l \cdot \sin^2 Z, \quad (10.3)$$

kurse ndryshimi në lartësi sipas formulës:

$$\begin{aligned} \Delta H &= \frac{1}{2} \cdot K \cdot l \cdot \sin 2\alpha + i - h = S_r \cdot \operatorname{tg} \alpha + i - h, \\ \Delta H &= \frac{1}{2} \cdot K \cdot l \cdot \sin 2Z + i - h = S_r \cdot \operatorname{ctg} Z + i - h. \end{aligned} \quad (10.4)$$

ku është:

